



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Fizioterapi”

ofruar nga

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Fatjona KAMBERI

Prof. Asoc. Enkelejd MËHILLI

Tetor / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në “Fizioterapi”**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Fizioterapi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 1184, Datë 3.12.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 51, datë 06.02.2017
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditohet për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 Kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	15 PAE / 12 PAK
18	Numri i studentëve:	2021-2022 21 studentë 2022-2023 30 studentë 2023-2024 24 studentë
19	Komente / të tjera:	



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë është një Institucion publik i Arsimit të Lartë. Universiteti i Mjekësisë në Tiranë funksionon që prej vitit 2013 si Institucion i pavarur duke ofruar programe studimi në fushat mjekësore. Institucioni ka operuar që prej vitit 1952 si Instituti i Lartë Mjekësor dhe më pas në vitin 1957 si Fakulteti i Mjekësisë. UMT është hapur me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 23.01.2013 ndërsa akti zyrtar i hapjes është Urdhëri i MAS Nr. 151, datë 30.03.2016. UMT është akredituar për herë të parë me VBA Nr. 69, datë 21.09.2017 dhe më pas me VBA Nr. 03, datë 27.01.2023. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë ka në përbërjen e vetë katër (4) Njësi Kryesore dhe njëzet e dy (22) Njësi Bazë. Këto Njësi ofrojnë në total 94 programe studimi në të tre ciklet.

Njësitë Kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, janë:

- Fakulteti i Mjekësisë;
- Fakulteti Mjekësisë Dentare;
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;
- Strukturat Shëndetësore Universitare - UMT.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ku ofrohet dhe programi i studimit Master i Shkencave në Fizioterapi, ka në përbërjen e vet:

- Departamentin e Lëndëve Klinike Infermieristikës së Përgjithshme, Infermieristikës në Sëmundje të Brendshme, Pediatri;
- Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor, Infermieristikës në Kirurgji, Infermieristikës në Obstetrikë-Gjinekologji;
- Departamenti i Lëndëve Paraklinike.

Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor, Infermieristikës në Kirurgji, Infermieristikës në Obstetrikë-Gjinekologji (DDRSHIKIOGJ) ofron programin e studimit Master i Shkencave në Fizioterapi. Paralelisht, kjo Njësi ofron dhe programe të tjera në këtë fushë përfshirë programin Bachelor në Fizioterapi si dhe programin Master Profesional në Fizioterapi.

Programi i studimit Master i Shkencave në Fizioterapi ofrohet që prej vitit 2009 bazuar në VKM Nr. 1184, Datë 3.12.2009.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Fizioterapi" që ofrohet nga Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor, Infermieristikës në Kirurgji, Infermieristikës në Obstetrikë-Gjinekologji (DDRSHIKIOGJ) të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë (UMT), filloi me marrjen e dokumentacionit të ofruar nga Intitucioni, si dhe ndarjen e punës për përgatitjen e pyetjeve dhe kërkesave për dokumentacion shtesë. ASCAL bazuar në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017", ka përzgjedhur dy ekspertë të vlerësimit të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UMT, për të kryer vizitën në institucion dhe për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Në kuadër të procesit të jashtëm të vlerësimit është përgatitur agjenda nga ASCAL dhe është kryer vizita në datat 05-06 Mars 2024. Dy ekspertët e përzgjedhur shoqëroheshin nga Koordinatori Teknik i ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm kishte në përbërje **Prof. Asoc. Fatjona Kamberi** dhe **Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli**. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm, ky grup pune u asistua edhe nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Msc. Arbri Ndreka.

Bazuar në agjendën e përgatitur nga ASCAL u zhvilluan takimet me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë, grupin e vlerësimit të brendshëm, anëtarë të stafit akademik dhe studentët. Paralelisht, ditën e parë u zhvillua dhe vizita në sekretarinë mësimore.

Ditën e dytë GVJ zhvilloi takime me përfaqësues të Drejtorisë së Administrimit Akademik dhe Kurrikulës (ku ishin të pranishëm përfaqësues të Sektorit të Kurrikulës dhe Pranimeve dhe përfaqësues të Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Statistikave), përfaqësues të Drejtorisë së Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit (ku ishin të pranishëm përfaqësues të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës) si dhe përfaqësues të Degës së Karrierës dhe Zhvillimit. Paralelisht, u zhvillua vizita në ambientet e Fakultetit. Gjatë vizitës në Institucion u panë klasa, laboratorë të ndryshëm si dhe biblioteka. Kohëzgjatja e takimeve ishte ajo e parashikuara.

Me përfundimin e takimeve, GVJ takoi Drejtuesin e Departamentit ndërsa Koordinatori Teknik i ASCAL do të informonte Koordinatorin Institucional mbi disa dokumenta shtesë. Në përfundim të vizitave, ekspertët në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, takimeve të zhvilluara si dhe vizitës në ambientet e Institucionit hartuan Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 15.10.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr.86/35 Prot, datë 15.10.2024. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë njofton në ASCAL më datë 23.10.2024, me anë të shkresës me Nr. 315/27 Prot, datë 22.10.2024 "Kthim përgjigje për Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit", ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Fizioterapi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti i Mjekësisë në Tiranë funksionon që prej vitit 2013 si Institucion i pavarur duke ofruar programe studimi në fushat mjekësore. Institucioni ka operuar që prej vitit 1952 si Instituti i Lartë Mjekësor dhe më pas në vitin 1957 si Fakulteti i Mjekësisë. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (UMT), është institucion publik, që synon arsimimin e lartë gjithëpërfshirës të studentëve vendas e të huaj, studimet dhe kualifikimet e mëtejshme, kërkimin shkencor dhe veprimtaritë mbështetëse në fushat e shkencave në fushën e mjekësisë. UMT, ka për qëllim zhvillimin e arsimit, edukimit dhe kërkimit shkencor në fushën e mjekësisë. Sipas Rregullores së UMT-së, Institucioni organizohet dhe funksionon sipas parimit të ligjshmërisë unitetit, hierarkisë, llogaridhënies, paanshmërisë, efektivitetit, si edhe bashkëpunimit të brendshëm institucional. Sipas Statutit të UMT-së, Institucioni operon në bazë të rregullave dhe parimet e hapësirës Europiane, ligjit të Republikës së Shqipërisë si dhe aktet e brendshme të veta. Evidenca: - Evidenca 1, Statuti i UMT; - Evidenca 2, Rregullore e UMT.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	UMT ka si vizion të jetë dhe të mbetet qendra më e rëndësishme akademike dhe kërkimore e shkencave mjekësore në Shqipëri. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është i vetmi institucion publik në fushën e shkencave mjekësore dhe ka si qëllim të ruajë rolin e udhërrëfyesit në përballjen e sfidave të se ardhmes të kujdesit shëndetësor, duke synuar formimin e profesionistëve të ardhshëm të shëndetit, të orientuar drejt kujdesit mjekësor të mbështetur në fakte, vlerësimit të cilësisë dhe performancës së kujdesit shëndetësor, mjekësisë së integruar proaktive dhe parandaluese, ofrimit të shërbimeve shëndetësore nga ekipe multidisciplinare etj. UMT ka si mision të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies,



	veprimtarisë kërkimore-shkencore e inovacionit, si dhe shërbimeve në fushat e shkencave mjekësore, të formojë specialistë të lartë e të përgatisë shkencëtarë të rinj në këtë drejtim. Paralelisht, bashkëpunon me studentët, qeverinë, shërbimin shëndetësor dhe shoqërinë civile me qëllim përgatitjen e profesionistëve të shëndetit që praktikojnë kujdesin optimal ndaj pacientit, me qëllim parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve dhe përparimin e kërkimit shkencor në dobi të shëndetit, të mundësojë formimin e vazhduar gjatë gjithë jetës si dhe të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel rajonal e kombëtar. Program i studimit Master i Shkencave në Fizioterapi ka qëllim të pajisë studentët me: • kompetencë të lartë në njohuritë e etikës dhe deontologjisë profesionale, legjislacionit mjekësor dhe ruajtjen e sekretit profesional; • njohuri të mira të teknikave dhe metodave të reja të trajtimit rehabilitues - fizioterapeutik, në pacientët me patologji të ndryshme, trajtimit ambulator dhe hospitalor të tyre; • aftësi në mënyrën e komunikimit midis kolegëve, eprorëve, vartësve, pacientëve dhe familjarëve. për përdorimin e mjeteve informatike dhe telematike në fushat me kompetenca specifike; • kompetencë në kryerjen e studimeve dhe hulumtimeve shkencore me vlerë në fushën e fizioterapisë. Programi i studimit është në unison me qëllimet dhe misionin e UMT. Evidenca: - Evidenca 1, Statuti i UMT; - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 86, Programi i Msc Fizioterapi 2021-2023; - Evidenca 170, Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat	Sipas strategjisë së UMT-së, objektivi kryesor është formimi i aftë i profesionistëve të shëndetit, për të përballuar sfidat e shëndetit. UMT si i vetmi institucion publik në fushën e shkencave mjekësore, ka si qëllim të ruajë rolin e udhërrëfyesit në përballjen e sfidave të së ardhmes të kujdesit shëndetësor, duke synuar formimin e profesionistëve të ardhshëm të shëndetit. Programi i studimit në Master i Shkencave në "Fizioterapi " ka

e drejtimet akademike së Institucionit.	qëllim të pajisë studentët me: a. kompetencë të lartë në njohuritë e etikës dhe deontologjisë profesionale, legjislacionit mjekësor dhe ruajtjen e sekretit profesional; b. njohuri të mira të teknikave dhe metodave të reja të trajtimit rehabilitues - Fizioterapik në pacientët me patologji të ndryshme, trajtimit ambulator dhe hospitalor të tyre; c. aftësi në mënyrën e komunikimit midis kolegëve, eprorëve, vartësve, pacienteve dhe familjarëve, për përdorimin e mjeteve informatike dhe telematike në fushat me kompetenca specifike; Rregullorja e programit të studimit është e bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UMT-së ndërsa programi i studimit ofrohet në përputhje me Strategjinë e zhvillimit. Kjo u konfirmua dhe në takimet e zhvilluara me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë. Evidenca: - Evidenca 1, Statuti i UMT; - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Evidenca 86, Programi i Msc Fizioterapi 2021-2023; - Evidenca 170, Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024; - Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë.
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjitë kombëtare si të arsimit ashtu edhe të shëndetësisë. Programi është në përputhje me vizionin, si edhe në vijim të arritjes të objektivave strategjike të këtij programi studimi. Sipas Rregullores së programit të studimit (neni 8), Programi MSc. në "Fizioterapi" e zhvillon veprimtarinë e tij në bazë të parimeve të lirisë dhe cilësisë akademike (liria akademike në mësimdhënien akademike nënkupton respektimin e shumëllojshmërisë së opinionëve, ideve e metodave dhe garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijues të mësimdhënies e të kërkimit shkencor). Kjo liri akademike ushtrohet në përputhje me planet e programet mësimore të hartuara e miratuara nga strukturat akademike të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, për të gjitha lëndët/modulet që përfshihen në të. Parimi i cilësisë nënkupton zbatimin e standardeve akademike dhe kërkimore menaxhuese të infrastrukturës si në aspektin e kërkesave edhe të rezultateve. Respektimi i parimit të cilësisë ka për qëllim realizimin e vlerësimit të brendshëm (të

	vetëvlerësimit), të vlerësimit të jashtëm dhe të akreditimit, duke synuar përmirësimin, ndryshimin dhe përparimin e cilësisë së programit të ciklit të dytë të studimit MSc. në Fizioterapi. Ky program studimi ka për objektiv t'u japë studentëve aftësi profesionale të avancuara në trajtimin e situatave mjekësore Fizioterapike, njohjen në detaje të protokolleve, teknikave dhe metodave rehabilituese të ndryshme më të fundit të trajtimit të pacientëve të të gjitha grupmoshave. Programi i nivelit të dytë (Master i Shkencave) në Fizioterapi ka si qëllim të formojë Fizioterapistë profesionist me njohuri të thella lidhur me zhvillimin gjuhësor problematikat që prekin gjuhën receptive dhe gjuhën ekspresive gjatë moshës evolutive, si dhe rastet e pacientëve pediatrik apo adult me çrregullime të ndryshme të fituara të të folurit. Ky program ka për qëllim të nxisë kërkimin dhe hulumtimin shkencor në Fizioterapi. MSc në "Fizioterapi" është hartuar në përputhje me strategjitë kombëtare dhe argumentohet që realizohet në përputhje me vizionin dhe strategjinë e interesat kombëtare si dhe mbi fokusin global të zhvillimit kombëtar përshkruar në ligjin Nr. 80/2015 Datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Evidenca: - Evidenca 1, Statuti i UMT; - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Evidenca 86, Programi i Msc Fizioterapi 2021-2023; - Evidenca 170, Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024.
Konkluzione	Universiteti i Mjeksisë në Tiranë funksionon që prej vitit 2013 si Institucion i pavarur duke ofruar programe studimi në fushat mjekësore. UMT ka si vision të jetë dhe të mbetet qendra më e rëndësishme akademike dhe kërkimore e shkencave mjekësore në Shqipëri. Universiteti i Mjeksisë, Tiranë, është i vetmi institucion publik në fushën e shkencave mjekësore dhe ka si qëllim të ruajë rolin e udhërrëfyesit në përballjen e sfidave të së ardhmes të kujdesit shëndetësor, duke synuar formimin e profesionistëve të ardhshëm të shëndetit. Programi MSc. në Fizioterapi ka për objektiv t'u japë studentëve aftësi profesionale të avancuara në trajtimin e situatave mjekësore Fizioterapike, njohjen në detaje të protokolleve, teknikave dhe metodave rehabilituese të

	<i>ndryshme më të fundit te trajtimit të pacientëve të të gjitha grupmoshave.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, u krijua në vitin 2013, si universiteti i parë gjithëpërfshirës i arsimit të lartë publik në shkencat mjekësore dhe i kërkimit shkencor në vend, pas një tradite 65 vjeçare të formimit universitar publik në fushën e shkencave mjekësore në Republikën e Shqipërisë, pas krijimit të Institutit të Lartë Mjekësor në vitin 1952 dhe Fakultetit të Mjekësisë në vitin 1957. UMT ka në përbërjen e vet 3 Njësi Kryesore dhe 22 Njësi Bazë. Këto Njësi ofrojnë në total 94 programe studimi në të tre ciklet. Njësia kryesore që ofron këtë program studimi ka në total 338 staf akademik nga të cilët 69 personel akademik me kohë të plotë (PAE), 260 personel akademik me kontratë dhe 9 personel ndihmës akademik. Në total Njësia Bazë që ofron këtë program studimi (DDRSHIKIOGJ) ka në përbërje të vet 27 (2 Prof. Dr., 9 Prof. Assoc., 14 Dr. dhe 2 MSc.) personel akademik PAE dhe 113 personel akademik me kontratë (1 Prof. Dr., 4 Prof. Assoc., 21 Dr., 86 MSc. dhe 1 Mp.) si dhe 3 staf ndihmës akademik. Institucioni demonstroi se ka kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e këtij programi studimi. UMT është akredituar më herët. Infrastruktura në funksion të mësimdhënies është e mjaftueshme për ofrimin e programit të studimit MSc. në Fizioterapi. Evidenca: - Evidenca 1, Statuti i UMT; - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 3, Organigrama UMT; - Evidenca 77, Vendimi 69, dt.21.09.2017 për Akreditimin Inst. të UMT nga Bordi i Akreditimit + Certifikata; - Evidenca 97, Tablelat me statistikat përmbledhese (Anekset_ASCAL);





	- Evidenca 97, Tabelat permbledhese per Aneks_RVB Msc. Fizioterapi; - Evidenca 117, Lista e laboratoreve didaktike ne te 3 Fakultetet – UMT; - Evidenca 118, Infrastruktura ne funksion te mesimdhenies, Universiteti i Mjekesise, Tirane.
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Universiteti i Mjekësisë është i vetmi Institucion publik në Shqipëri që ofron programe studimi në fushën e shkencave Mjekësore. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT) i cili ofron këtë program studimi, ka në përbërjen e vet Departamentin e Lëndëve Klinike Infermieristikës së Përgjithshme, Infermieristikës në Sëmundje të Brendshme, Pediatri, Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor, Infermieristikës në Kirurgji, Infermieristikës në Obstetrikë-Gjinekologji (DDRSHIKIOGJ) dhe Departamenti i Lëndëve Paraklinike. Njësia Kryesore ofron programe të tjera në fushën e shkencave mjekësore si Infermieri, Mami, Teknik Imazherie, Teknik Laboratori, Logopedi, si dhe programe të ciklit të dytë e të tretë në këto fusha. Ndërthurja e programeve të ndryshme të studimit që FSHMT ofron, u raportua dhe në takimin e zhvilluar me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë. Departamenti ofron dhe programe të tjera të ngjashme në këtë fushë si Bachelor në Fizioterapi dhe Master Profesional në Fizioterapi. Ky program studimi i përket Nivelit shtatë (7) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve si dhe të EQAF. Evidenca: - Evidenca 1, Statuti i UMT; - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; - Evidenca 7, Organigrama Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike; - Evidenca 55, Lista e programeve të studimit të ofruara në UMT; - Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë.
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje	Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor, Infermieristikës në Kirurgji, Infermieristikës në Obstetrikë-Gjinekologji (DDRSHIKIOGJ) që ofron programin e studimit MSc. në "Fizioterapi" ofron dhe programe të tjera të ngjashme

me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	në këtë fushë si Bachelor në Fizioterapi dhe Master Profesional në Fizioterapi. Paralelisht, njësia Bazë ofron programe të ngjashme si Logopedi, Teknik Laboratori etj. Ky nuk është një program ndërdisiplinor. Evidenca: - Evidenca 1, Statuti i UMT; - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; - Evidenca 7, Organigrama Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike; - Evidenca 55, Lista e programeve të studimit të ofruara në UMT; Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë.
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Jo e aplikueshme.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	UMT raporton se zhvillon rregullisht aktivitete trajnuese në bashkëpunim me punëdhënësit. Organizimi i konferencave, trajnimeve, workshop-eve etj. Është një procedurë që Institucioni ndjek. Këto aktivitete organizohen në bashkëpunim edhe me IAL të tjera publike/private brenda edhe/ose jashtë vendit. Përmes Zyrës së Karrierës, Institucioni organizon aktivitete të ndryshme për studentët si ata aktual ashtu edhe për të diplomuarit. Organizimi i aktiviteteve të akredituara për profesionistët e shëndetit është një procedurë që UMT ndjek. Organizimi i aktiviteteve të tilla u konfirmua dhe në takimin e zhvilluar me autoritetet drejtuese. Evidenca: - Evidenca 29, Programi-konferenca-VLORE-2023-tetor-26-27; - Evidenca 30, Konferenca-vjetore-2023-FSHMT-ne-bashkepunim-me-UV-dhe-UISH;

	- Evidenca 44, Lista e projekteve ndërkombëtare të aplikuara dhe të fituara; - Evidenca 45, Lista e projekteve kombëtare të aplikuara dhe të fituara; - Evidenca 46, Memorandume bashkëpunimi UMT me MShMS; - Evidenca 49, Lista e bashkëpunimeve me IAL kombëtare, ndërkombëtare dhe institucione të tjera; - Evidenca 108, Aktivitete te Zyrës së Karrierës FSHMT; Takim me Drejtuesen e Njësisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësisë Bazë.			
Konkluzione	UMT ka në përbërjen e vet 3 Njësi Kryesore dhe 22 Njësi Bazë. Aktualisht (viti akademik 2023-2024). Departamenti i DDRSHIKIOGJ i cili ofron këtë program studimi ka në përbërjen e vet 27 personel akademik efektiv PAE (2 Prof. Dr., 9 Prof. Assoc., 14 Dr. dhe 2 MSc.) dhe 113 personel akademik me kontratë PAK (1 Prof. Dr., 4 Prof. Assoc., 21 Dr., 86 MSc. dhe 1MP) si dhe 3 staf ndihmës akademik. Departamenti ofron dhe programe të tjera të ngjashme në këtë fushë si Bachelor në Fizioterapi dhe Master Profesional në Fizioterapi. UMT raporton se zhvillon rregullisht aktivitete trajnuese në bashkëpunim me punëdhënësit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së	UMT ka në Rregulloren dhe Statutin e vet Njësitë akademike dhe administrative specifike të cilat bashkëpunojnë me njëra tjetrën me qëllim mbarëvajtjen e programeve të studimit, përfshirë këtu edhe programin e studimit MSc. në “Fizioterapi”. Organigrama e Institucionit përcakton Njësitë Akademike dhe jo akademike. Secila Njësi si dhe organet e ndryshme kanë hartuar rregulloret e veta të cilat zbatojnë (sipas raportimeve në takimet e zhvilluara).

detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Në UMT janë të përfshira Njësi Kryesore, njësi Bazë, Njësi Administrative si dhe Komisione të përhershme. Të gjitha këto Njësi bashkëpunojnë me njëra tjetrën në bazë të detyrave të përcaktuara. <i>Në takimet e zhvilluara në Institucion, autoritetet drejtuese raportuan se një nga problemet kryesore është egzistenca e tre Njësive Bazë vetëm pranë Njesisë Kryesore (FSHMT) pavarësisht se ofrohen shumë programe studimi, të ndryshme. Ata sugjeruan që do të ishte mirë që numri i njësive bazë të shtohet.</i> Evidenca: - Evidenca 1, Statuti i UMT; - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; - Evidenca 7, Organigrama Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike; - Evidenca 173, Rregullore e funksionimit të Këshillit të Etikës - UMT; - Evidenca 177, Rregullore për fitimin e titujve akademike në UMT; - Evidenca 181, Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT; - Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë; - Takim me GVB.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	FSHMT gjendet brenda ambienteve të Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza. Me qëllim realizimin e objektivave të procesit mësimor, Institucioni ka marrëveshje të veçantë me QSUNT. Paralelisht, UMT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me spitale dhe klinika publike e private për realizimin e praktikave mësimore. <i>Pavarësisht marrëveshjeve egzistuese, GVJ konsideron të rëndësishëm që të rritet numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit me qendra rehabilitimi. Këto marrëveshje duhet të kenë fokus të veçantë studentët e Fizioterapisë.</i> Evidenca: - Evidenca 46, Memorandume bashkëpunimi UMT me MShMS.pdf;




	- Evidenca 49, Lista e bashkepunimeve me IAL kombëtare, ndërkombëtare dhe institucione të tjera; - Evidenca 112, Liste e Shërbimeve të QSU; - Takime në Institucion.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Me qëllim realizimin e programit të studimit MSc. në Fizioterapi, Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me IAL kombëtare dhe ndërkombëtare, institucione të ndryshme si (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kompani farmaceutike, Akademia e Shkencave, etj.). Paralelisht, UMT ka marrëveshje me Qendra Kërkimore si dhe me Institucione të Shëndetit Publik. <i>GVJ vëren se pak marrëveshje fokusohen specifikisht në programet e Fizioterapisë dhe kjo është një pikë që Njësia Bazë duhet të punoj më shumë.</i> Evidenca: - Evidenca 46, Memorandume bashkëpunimi UMT me MShMS.pdf; - Evidenca 49, Lista e bashkepunimeve me IAL kombetare, nderkombetare dhe institucione te tjera; - Evidenca 112, Liste e Sherbimeve te QSU; - Takime në Institucion.
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	UMT ka pjesë të strategjisë së vet rritjen e bashkëpunimeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndërkombëtarizimi është një pikë themelore e Planit Strategjik të Institucionit. Për këtë arsye ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi me IAL brenda dhe jashtë vendit. Në fund të vitit dhe sipas parashikimeve ligjore, UMT harton raportin e vet vjetor në bazë të raportimeve në nivel Njësie Kryesore dhe Njësie Bazë si dhe në bazë të raportimeve të njësive Administrative. Në raportin vjetor përfshihet një pjesë mbi bashkëpunimet kombëtare dhe ndërkombëtare duke evidentuar dhe rezultatet apo përfitimet e mundshme. <i>GVJ konsideron se kjo pjesë duhet të fokusohet më shumë tek marrëveshjet në implementim dhe jo çfarë pritet nga marrëveshjet e reja. Në raportin e Njesisë Bazë nuk përfshihet një pjesë specifike për rezultatet e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe GVJ konsideron se kjo është e nevojshme të përfshihet. Mungesa e një raporti të tillë u konfirmua dhe në takimin e zhvilluar me autoritetet Drejtuese.</i> Evidenca:

	- Evidenca 46, Memorandume bashkepunimi UMT me MShMS.pdf; - Evidenca 49, Lista e bashkëpunimeve me IAL kombëtare, ndërkombëtare dhe institucione të tjera; - Evidenca 79, Raporti Vjetor _UMT_ 2020-2021; - Evidenca 79.1, Raporti Vjetor UMT 2021-2022; - Evidenca 81, Raport vjetor FSHMT 2021-2022; - Evidenca 84, Analiza vjetore 2021-2022 DDRSHIKIOGJ; - Evidenca 85, Analiza vjetore 2022-2023 DDRSHIKIOGJ; - Evidenca 170, Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024; - Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë.			
Konkluzione	UMT ka në Rregulloren dhe Statutin e vet Njësitë akademike dhe administrative specifike të cilat bashkëpunojnë me njëra tjetrën me qëllim mbarëvajtjen e programeve të studimit. UMT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me spitale dhe klinika publike e private për realizimin e praktikave mësimore. GVJ konsideron të rëndësishëm që të rritet numëri i marrëveshjeve të bashkëpunimit me qendra rehabilitimi. GVJ vëren se pak marrëveshje fokusohen specifikisht në programet e Fizioterapisë dhe kjo është një pikë që Njësia Bazë duhet të punoj më shumë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit MSc. në "Fizioterapi" është hapur me VKM Nr. 1184, Datë 3.12.2009 dhe është i organizuar sipas legjislacionit në fuqi dhe me sistemin European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (niveli 7 i kualifikimeve sipas përcaktimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve) me total 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike. Sipas Rregullores së UMT-së (neni 71) programet e studimit janë të organizuara në module/diiplina dhe të vlerësuara në kredite. Një kredit është i barabartë me 25 orë ndërsa në total në vit, një student zhvillon 1500 orë. Sipas nenit 74 të Rregullores së UMT-së, veprimtaritë formuese, që karakterizojnë një program studimi, përbëhen nga komponentët mësimore, të cilët ndahen në: mësim në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, praktika profesionale/klinike, forma të kontrollit të vazhdueshëm etj), studim individual (studim, punim relacionesh detyrash apo projektesh), përgatitje për provime, përgatitje e tezës së diplomës. Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme: a. lëndë bazë të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme; b. lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij; c. lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup lëndë me zgjedhje; d. lëndë plotësuese, të fokusuara në përfundimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim; e. detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar. Të gjitha këto përcaktohen dhe në nenin 31 të Rregullores së Njësisë Kryesore. Në programin e studimit MSc. në Fizioterapi, parashikohen

	lëndët dhe modulet si dhe kreditet për secilën lëndë/modul. Në përgjithësi, sipas planit mësimor, parashikohen 8 kredite për lëndët bazë, 69 kredite për lëndët karakterizuese, 15 kredite për lëndët ndërdisiplinore, 12 kredite për lëndët plotësuese dhe 16 kredite për detyrimet përmbyllëse. Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Evidenca 91.2 Plani mesimor Msc Fizio 23-25; - Evidenca 91. Plani mesimor_MSH Fizioterapi 21-23.
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Program i studimit MSc. në Fizioterapi ka qëllim të pajisë studentët me: • kompetencë të lartë në njohuritë e etikës dhe deontologjisë profesionale, legjislacionit mjekësor dhe ruajtjen e sekretit profesional; • njohuri të mira të teknikave dhe metodave të reja të trajtimit rehabilitues - fizioterapeutik, në pacientët me patologji të ndryshme, trajtimit ambulator dhe hospitalor të tyre; • aftësi në mënyrën e komunikimit midis kolegëve, eprorëve, vartësve, pacientëve dhe familjarëve. për përdorimin e mjeteve informatike dhe telematike në fushat me kompetenca specifike; • kompetencë në kryerjen e studimeve dhe hulumtimeve shkencore me vlerë në fushën e fiziterapisë. Programi MSc. Fizioterapi ka për objektiv t'u japë studentëve aftësi profesionale të avancuara në trajtimin e situatave mjekësore Fizioterapike, njohjen në detaje të protokolleve, teknikave dhe metodave rehabilituese të ndryshme më të fundit të trajtimit të pacientëve të të gjitha grupmoshave. Programi i nivelit të dytë (Master i Shkencave) në Fizioterapi ka si qëllim të formojë Fizioterapistë profesionist me njohuri të thella lidhur me zhvillimin gjuhësor problematikat që prekin gjuhën receptive dhe gjuhën ekspresive gjatë moshës evolutive, si dhe rastet e pacientëve pediatrik apo adult me çrregullime të ndryshme të fituara të të folurit. Ky program ka për qëllim të nxisë kërkimin dhe hulumtimin shkencor në Fizioterapi.




	Evidenca: - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Evidenca 86. Programi Msc në Fizioterapi 21-23; - Evidenca 91.2 Plani mësimor Msc Fizio 23-25.
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Ky program studimi ka në total 120 kredite të cilat studentët mund ti fitojnë brenda dy (2) viteve akademike. Në programin e studimit MSc. në Fizioterapi, parashikohen lëndët dhe modulet si dhe kreditet për secilën lëndë/modul. Në përgjithësi, sipas planit mësimor, parashikohen 8 kredite për lëndët bazë, 69 kredite për lëndët karakterizuese, 15 kredite për lëndët ndërdisiplinore, 12 kredite për lëndët plotësuese dhe 16 kredite për detyrimet përmbyllëse. Në planin mësimor, veprimtaritë formuese janë të përcaktuara qartë. Kreditet dhe orët për secilën lëndë/modul paraqiten në planin mësimor. Për praktikën profesionale parashikohen 12 kredite dhe 18 kredite për detyrimet përmbyllëse. Evidenca: - Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Evidenca 86. Programi Msc në Fizioterapi 21-23; - Evidenca 91.2 Plani mësimor Msc Fizio 23-25.
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.	Jo e aplikueshme pasi ky nuk është një program i ciklit të dytë në fushën e Mësuesisë.
Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të	Jo e aplikueshme pasi ky nuk është një program i ciklit të dytë në fushën e Mësuesisë.

krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Jo e aplikueshme pasi ky nuk është një Institucion i Arsimit të Lartë me status të veçantë.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Në takimin e zhvilluar me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë ata konfirmuan se ky program studimi është i ngjashëm me programe studimi të Fiziotherapisë në Shqipëri (Universiteti i Sporteve, Universiteti Aldent, Universiteti Reald etj.) si dhe jashtë Shqipërisë (Universiteti i Barit). Ata konfirmuan se pjesa më e madhe e IAL-ve publike e private të cilat ofrojnë këtë program studimi, e kanë bazuar në programin aktual. Institucioni raportoi se ka përcjellë në Ministri të gjitha programet e studimit me qëllim kodifikimin e tyre dhe arrijten e ngjashmërisë në një nivel të paktën 70% ose edhe më të lartë. Evidenca:
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet	Njësia Bazë ka përcaktuar kod për secilën lëndë të këtij program studimi. Propozimi për kodifikimin e këtij program studimi është zhvilluar nga Institucioni dhe i është përcjellë MAS. Evidenca: - <i>Evidenca 91.2 Plani mesimor Msc Fizio 23-25;</i> - <i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë.</i>

kodifikimi i lëndëve të programit.									
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky nuk është një program i përbashkët por ofrohet vetëm nga UMT.								
Konkluzione	<i>Ky është një program studimi i ciklit të dytë me total 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike. Në programin e studimit Master i Shkencave në Fizioterapi, parashikohen lëndët dhe modulet si dhe kreditet për secilën lëndë/modul. Programi i studimit Master i Shkencave në Fizioterapi ka si qëllim të formojë fizioterapistë profesionistë me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme që të punojnë në klinika spitalore, poliklinika, shtëpi kujdesi, shkolla, kopshte etj., për organizimin e punës në drejtim të edukimit Fizioterapik të të gjithë pacientëve me këto probleme. Programi i studimit ka të parashikuar praktikën profesionale (12 kredite) dhe detyrimet përmbyllëse (18 kredite).</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table><tr><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr></table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Ky program studimi ofrohet nga UMT. Njësia Kryesore që ofron këtë program studimi (FSHMT) ka në përbërjen e vet 3 Njësi Bazë. Njësia kryesore që ofron këtë program studimi ka në total 338 staf akademik nga të cilët 69 personel akademik me kohë të plotë (PAE), 260 personel akademik me kontratë dhe 9 personel ndihmës akademik. Institucioni demonstron se ka kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e këtij programi studimi. UMT është akredituar më herët. Infrastruktura në funksion të mësimdhënies është e mjaftueshme për ofrimin e programit të studimit MSc. në Fizioterapi.

Njësia bazë	PAE	Tituj/Grada	PAK	Tituj/Grada
Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji dhe në Obstetrikë Gjinekologji	27	2 - Prof. Dr. 10 - Prof. Asoc. 13 - Dr. 2 - Msc	113	1 - Prof. Dr. 4 - Prof. Asoc. 21 - Dr. 15 - Dr. në Proc. 72 - Msc
Departamenti i Lëndëve Klinike, Infermieristikës së Përgjithshme dhe Infermieristikës në Sëmundje të Brendshme dhe në Pediatri	27	2 - Prof. Dr. 8 - Prof. Asoc. 15 - Dr. 2 - Dr. në Proc. 0 - Msc	130	0 - Prof. Dr. 5 - Prof. Asoc. 16 - Dr. 5 - Dr. në Proc. 104 - Msc
Departamenti i Lëndëve Paraklinike	15	2 - Prof. Dr. 4 - Prof. Asoc. 9 - Dr. 0 - Msc	17	0 - Prof. Dr. 1 - Prof. Asoc. 3 - Dr. 2 - Dr. në Proc. 11 - Msc
Total		69		260
Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; - Evidenca 7, Organigrama Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike; - Evidenca 93, Tabelat e personelit akademik 20-21;				

	- Evidenca 94, Tabelat e personelit akademik 21-22; - Evidenca 95, Tabelat e personelit akademik 22-23; - Evidenca 97, Tablelat me statistikat permbledhese (Anekset_ASCAL); <i>Evidenca 97, Tabelat permbledhese per Aneks_RVB Mp Fizioterapi.</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Neni 46 i Rregullores së Institucionit parashikon përfshirjen e personelit ndihmës akademik dhe administrativ në UMT. Neni 24 i Rregullores së Njesisë Kryesore parashikon të drejtat dhe detyrimet e personelit ndihmës akademik. Njësia Bazë ka sekretaren mësimore, detyrat e së cilës parashikohen në Rregulloren e Njesisë. Detyrat e personelit ndihmës akademik për këtë program studimi parashikohen dhe në nenin 12 të Rregullores së programit të studimeve. Njësia Bazë ka 3 staf ndihmës akademik me qëllim realizimin e orëve laboratorike. <i>Në krahasim me vitet e kaluara, numri i stafit ndihmës akademik është rritur (1 në vitin akademik 2020-2021 dhe 3 në vitin akademik 2022-2023).</i> Në takimet në UMT u raportua se një personel ndihmës akademik është i përfshirë në ofrimin e këtij programi studimi. Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Evidenca 97, Tabelat me statistikat përmbledhëse (Anekset_ASCAL); - Evidenca 97, Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB Msc. Fizioterapi; <i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë.</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe	Ky program studimi ofrohet në nivel Njësie Kryesore dhe të tre Njësive Bazë përfshihen në implementimin e tij. Koordinatori i programit të studimit përcjell problematikat e ndryshme mbi ecurinë e programit të studimit. Paralelisht, ai harton dhe orarin mësimor. Këto u konfirmuan dhe në takimin e zhvilluar me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë. Studentët konfirmuan se e njohnin koordinatoren e programit të studimit. <i>GVJ propozon përfshirjen e detyrave të koordinatorit të programit të studimit në Rregulloren e Njesisë Bazë.</i>

praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; - Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë; Takim me studentët.			
Konkluzione	Njësia kryesore që ofron këtë program studimi ka në total 338 staf akademik nga të cilët 69 personel akademik me kohë të plotë (PAE). Në total Njësia Bazë që ofron këtë program studimi ka në përbërje të vet 27 personel akademik PAE dhe 113 personel akademik me kontratë si dhe 3 staf ndihmës akademik. Në krahasim me vitet e kaluara, numri i stafit ndihmës akademik është rritur. GVJ propozon përfshirjen e detyrave të koordinatorit të programit të studimit në Rregulloren e Njesisë Bazë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3 Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Dokumentacioni i nevojshëm për ofrimin e këtij program studimi ishte i disponueshëm nga Njësia Kryesore. Statuti dhe Rregullorja e Institucionit përcaktojnë rregullat e përgjithshme ndërsa me më shumë informacione për këtë program studimi (Master i Shkencave në Fizioterapi), ato prezantohen në Rregulloren e programit të studimit. Në rregulloren e programit, në nenet 12-25 përcaktohen qartë të gjithë elementët e programit të studimit. Ato përfshijn strukturën e studimeve, format e mësimit dhe frekuentimit, procedurat dhe kriteret e vlerësimit, pranimin si dhe detyrat e studentëve. Në vizitën e zhvilluar në Institucion u raportua se pranë Njesisë Bazë disponohet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm përfshirë këtu planin mësimor, syllabuset, tezat e provimeve etj.
	Evidenca:

	- Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Takim me Drejtuesen e Njësisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësisë Bazë.																																													
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Plani mësimor i programit të studimit përfshin ndarjen e moduleve, ngarkesën mësimore, semestrin për secilën lëndë/modul, orët në auditor si dhe jashtë auditori, kreditet dhe formën e vlerësimit. Plani mësimor përfshin po ashtu informacion mbi leksionet, seminarët, praktikën dhe laboratorët. Informacion mbi orët e studimit individual janë të përfshirë në planin mësimor. Syllabuset e lëndëve prezantojnë me detaje po ashtu informacionin e nevojshëm mbi lëndët/modulet, ngarkesën etj. <table><tr><th>MSc “Fizioterapi”</th><th>Viti I</th><th>Viti II</th><th>Në total</th><th>Në total %</th></tr><tr><td>Në auditor</td><td>621</td><td>589</td><td>1210</td><td>40.3</td></tr><tr><td>Leksione</td><td>396</td><td>174</td><td>570</td><td>19</td></tr><tr><td>Seminare</td><td>81</td><td>39</td><td>120</td><td>4</td></tr><tr><td>Laboratore</td><td>20</td><td>0</td><td>20</td><td>0.6</td></tr><tr><td>Praktika profesionale dhe lëndore</td><td>110</td><td>360</td><td>470</td><td>15.6</td></tr><tr><td>Projekte/Detyra kursi</td><td>14</td><td>16</td><td>30</td><td>0.4</td></tr><tr><td>Punë e pavarur e studentit</td><td>879</td><td>911</td><td>1790</td><td>59.7</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>1500</td><td>1500</td><td>3000</td><td>100</td></tr></table> GVJ vëren se numri i orëve laboratorike është i ulët. Për këtë arsye sugjeron që orët laboratorike të rriten. Evidenca: - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Evidenca 86. Programi Msc në Fizioterapi 21-23; - Evidenca 91.2 Plani mësimor Msc Fizio 23-25; - Evidenca 92.1-92.8, Syllabuset e lëndëve.	MSc “Fizioterapi”	Viti I	Viti II	Në total	Në total %	Në auditor	621	589	1210	40.3	Leksione	396	174	570	19	Seminare	81	39	120	4	Laboratore	20	0	20	0.6	Praktika profesionale dhe lëndore	110	360	470	15.6	Projekte/Detyra kursi	14	16	30	0.4	Punë e pavarur e studentit	879	911	1790	59.7	Gjithsej	1500	1500	3000	100
MSc “Fizioterapi”	Viti I	Viti II	Në total	Në total %																																										
Në auditor	621	589	1210	40.3																																										
Leksione	396	174	570	19																																										
Seminare	81	39	120	4																																										
Laboratore	20	0	20	0.6																																										
Praktika profesionale dhe lëndore	110	360	470	15.6																																										
Projekte/Detyra kursi	14	16	30	0.4																																										
Punë e pavarur e studentit	879	911	1790	59.7																																										
Gjithsej	1500	1500	3000	100																																										

Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në Rregulloren e Institucionit, në nenet 108-112 përfshihen të gjitha informacionet e nevojshme për transferimet, njohjen e krediteve si dhe ekuivalentimin. Neni 72 përcakton politikat e pranimi. Nenet 62 dhe 63 të Rregulores së Njesisë Kryesore përcaktojnë kriteret e transferimeve si dhe të njohjes së krediteve. Informacione të detajuara për transferimet dhe ekuivalentimin e studimeve jepen në Rregulloren e Njesisë Bazë (nenet 46-49). Në Rregulloren e programit të studimit parashikohen politikat e pranimi, procedura që ndiqet si dhe dokumentacioni i nevojshëm (nenet 21-23). Kriteret e pranimi propozohen nga Njësia Bazë dhe miratohen nga Senati Akademik. Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë.
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi mësimor i lëndës hartohet për çdo disiplinë që përmban plani mësimor. Në programin mësimor të lëndës jepen në formë të përmbledhur: 1. të dhënat e përgjithshme për lëndën, viti akademik, njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e lëndës, struktura e lëndës sipas ndarjeve të bëra në planin mësimor, emri i titullarit të lëndës dhe i stafit mësimdhënës; 2. njohuritë paraprake që duhet të ketë fituar paraprakisht studenti, objektivat formuese të lëndës, njohuritë dhe aftësitë që përfton studenti nga përvetësimi i lëndës, konceptet dhe termat bazë mbi të cilat ndërtohet lënda; 3. përmbajtja e lëndës, e ndarë në leksione dhe ushtrime/seminare, e detajuar në tematika që zhvillohen sipas javëve mësimore; 4. përmbajtja e punëve laboratorike, praktikave klinike; 5. forma e kontrollit që do të përdoret, parakushtet e hyrjes në provim, mënyra e vlerësimit përfundimtar, literatura bazë dhe ajo ndihmëse. Të gjitha këto parashikohen dhe në Rregulloren e Njesisë Kryesore. Syllabuset hartohen nga titullari i lëndës dhe miratohen nga Drejtuesi i Njesisë Bazë/Kryesore. Kjo procedurë u konfirmua dhe në takimin e zhvilluar me stafin akademik. <i>GJV vëren se një pjesë e syllabuseve nuk janë të miratuara nga Drejtuesi i Njesisë Bazë dhe për këtë arsye rekomandon që kjo procedurë të ndiqet rregullisht. Po ashtu,</i>

	<i>një pjesë e literaturës është e vjetër dhe ka nevojë për përditësim.</i> Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 92.1-92.8, Syllabuset e lëndëve; - Takim me stafin akademik.			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Programi i studimit MSc. në “Fizioterapi” përditësohet në mënyrë të vazhdueshme. Në takimin e zhvilluar me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë si dhe me stafin akademik, ata raportuan se programi i studimit përmirësohet vazhdimisht dhe në fillim të vitit akademik bëhen ndryshimet/përmirësimet e nevojshme. Kjo u konfirmua dhe nga stafi akademik. Sipas Rregullores së Njesisë Kryesore, stafi akademik paraqet pranë Njesisë Bazë / Dekanat programin e përditësuar të lëndës për vitin akademik përkatës, një javë para fillimit të vitit akademik. <i>Pavarësisht se kjo është një procedurë që FSHMT ndjek, GVJ konsideron si të rëndësishme dokumentimin e rregullt të përditësimeve.</i> Evidenca: - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 21, Rregullore MP Fizioterapi; - Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me GVB.			
Konkluzione	Dokumentacioni i nevojshëm për ofrimin e këtij program studimi ishte i disponueshëm nga Njësia Kryesore. Plan i mësimor i programit të studimit përfshin ndarjen e moduleve, ngarkesën mësimore, semestrin për secilën lëndë/modul, orët në auditor si dhe jashtë auditori, kreditet dhe formën e vlerësimit. Në Rregulloren e Institucionit, në nenet 108-112 përfshihen të gjitha informacionet e nevojshme për transferimet, njohjen e krediteve si dhe ekuivalentimin. Neni 72 përcakton politikat e pranimit. Programi mësimor i lëndës hartohet për çdo disiplinë që përmban plani mësimor. Programi i studimit MSc. në “Fizioterapi” përditësohet në mënyrë të vazhdueshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit ka në përbërje të vet leksione, seminare, orë laboratorike, praktikë si dhe studim individual. Ndërthurja e këtyre komponentëve u jep mundësinë studentëve të thellojnë njohuritë e tyre si dhe mundësi punësimi. Studentët të cilët përfundojnë programin e studimit MSc. në Fizioterapi kanë mundësi të vazhdojnë studimet e tyre në këtë fushë duke zhvilluar studime doktorale ose të punësohen. Në takimin e zhvilluar me studentët, një pjesë e madhe e tyre kishin përfunduar studimet e tyre Bachelor në këtë Universitet. Evidenca: - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Evidenca 86. Programi Msc në Fizioterapi 21-23; - Evidenca 91.2 Plani mesimor Msc Fizio 23-25; - Evidenca 92.1-92.8, Syllabuset e lëndëve.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërimit shkencor.	Programi MSc. në Fizioterapi ka për qëllim të formojë fizioterapistë profesionistë me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme që të punojnë në klinika spitalore, poliklinika, shtëpi kujdesi, shkolla, kopshte etj., për organizimin e punës në drejtim të edukimit Fizioterapik të të gjithë pacientëve me këto probleme. Ka një ndërthurje të lëndëve të përgjithshme me lëndët më specifike. Ato janë të shpërndara në dy vite, e në katër semestra dhe mundësojnë formimin profesional dhe shkencor të studentëve. Plani mësimor mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit. Plani mësimor është i ndarë në lëndë/module me kredite specifike (120 kredite në total). Në syllabuset e lëndëve përcaktohen kreditet dhe orët brenda dhe jashtë auditorit (leksione, seminare, laborator, praktik profesionale etj.). Secili syllabus përcakton edhe objektivat e lëndës si dhe rezultatet e pritshme të të nxënit. <i>GVJ vëren se orët laboratorike janë të pakta dhe duhet të rriten.</i>

	Evidenca: - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Evidenca 86. Programi Msc ne Fizioterapi 21-23; - Evidenca 91.2 Plani mesimor Msc Fizio 23-25; - Evidenca 92.1-92.8, Syllabuset e lëndëve; - Takim me studentët.																																													
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Programi i studimit përfshin orë brenda dhe jashtë auditorit. Në total ky program për dy vite akademike kërkon angazhimin për 3000 orë (1210 brenda në auditor dhe 1790 jashtë). Programi përfshin teori dhe praktikë. Syllabuset e lëndëve pasqyrojnë qartë orët teorike dhe praktike që duhet të ndjekin studentët. Në diskutimet në UMT, u raportua se ky program është i ngjashëm me programe të tjera brenda dhe jashtë vendit. Orët totale të praktikës janë 470, të cilat zhvillohen si pjesë përbërëse e disa prej lëndëve si dhe në fund të vitit të dytë akademik. Programi i studimit, u ofron studentëve njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale. <i>Autoritetet drejtuese raportuan se një nga ndryshimet kryesore që kanë bërë është rritja e orëve të praktikës për këtë program studimi. GVJ vëren se orët laboratorike janë të pakta dhe duhet të rriten.</i> <table><tr><th>MSc “Fizioterapi”</th><th>Viti I</th><th>Viti II</th><th>Në total</th><th>Në total %</th></tr><tr><td>Në auditor</td><td>621</td><td>589</td><td>1210</td><td>40.3</td></tr><tr><td>Leksione</td><td>396</td><td>174</td><td>570</td><td>19</td></tr><tr><td>Seminare</td><td>81</td><td>39</td><td>120</td><td>4</td></tr><tr><td>Laboratore</td><td>20</td><td>0</td><td>20</td><td>0.6</td></tr><tr><td>Praktika profesionale dhe lëndore</td><td>110</td><td>360</td><td>470</td><td>15.6</td></tr><tr><td>Projekte/Detyra kursi</td><td>14</td><td>16</td><td>30</td><td>0.4</td></tr><tr><td>Punë e pavarur e studentit</td><td>879</td><td>911</td><td>1790</td><td>59.7</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>1500</td><td>1500</td><td>3000</td><td>100</td></tr></table> Evidenca: - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Evidenca 86. Programi Msc ne Fizioterapi 21-23;	MSc “Fizioterapi”	Viti I	Viti II	Në total	Në total %	Në auditor	621	589	1210	40.3	Leksione	396	174	570	19	Seminare	81	39	120	4	Laboratore	20	0	20	0.6	Praktika profesionale dhe lëndore	110	360	470	15.6	Projekte/Detyra kursi	14	16	30	0.4	Punë e pavarur e studentit	879	911	1790	59.7	Gjithsej	1500	1500	3000	100
MSc “Fizioterapi”	Viti I	Viti II	Në total	Në total %																																										
Në auditor	621	589	1210	40.3																																										
Leksione	396	174	570	19																																										
Seminare	81	39	120	4																																										
Laboratore	20	0	20	0.6																																										
Praktika profesionale dhe lëndore	110	360	470	15.6																																										
Projekte/Detyra kursi	14	16	30	0.4																																										
Punë e pavarur e studentit	879	911	1790	59.7																																										
Gjithsej	1500	1500	3000	100																																										

	- Evidenca 91.2 Plani mesimor Msc Fizio 23-25; - Evidenca 92.1-92.8, Syllabuset e lëndëve; - Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë; - Takim me stafin akademik.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ky program studimi ka në total 120 kredite të cilat studentët mund ti fitojnë brenda dy (2) viteve akademike. Në programin e studimit MSc. në Fizioterapi, parashikohen lëndët dhe modulet si dhe kreditet për secilën lëndë/modul. Në përgjithësi, sipas planit mësimor, parashikohen 8 kredite për lëndët bazë, 69 kredite për lëndët karakterizuese, 15 kredite për lëndët ndërdisiplinore, 12 kredite për lëndët plotësuese dhe 16 kredite për detyrimet përmbyllëse. Në planin mësimor, veprimtaritë formuese janë të përcaktuara qartë. Në secilin semestër, studenti mund të fitoj 30 kredite. Kreditet dhe orët për secilën lëndë/modul paraqiten në planin mësimor. Sipas parashikimeve në Rregulloret e Institucionit, studentët kanë mundësi të zhvillojnë transferim të studimeve. Zhvillimi i një mobiliteti është në planin strategjik të Institucionit (përmes ndërkombëtarizimit). <i>Asnjë nga studentët që morën pjesë në takim nuk kishte zhvilluar mobilitete. GVJ konsideron se kjo është një pikë e dobët që UMT duhet të punoj më shumë.</i> Punësimi me përfundimin e studimeve ose studime të mëtejshme është e mundur për studentët që përfundojnë këtë program studimi. Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Evidenca 86. Programi Msc në Fizioterapi 21-23; - Evidenca 91.2 Plani mesimor Msc Fizio 23-25.
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë	Programi mësimor i lëndës hartohet për çdo disiplinë që përmban plani mësimor. Syllabuset hartohen nga titullari i lëndës dhe miratohen nga Drejtuesi i Njesisë Bazë/Kryesore. Kjo procedurë u konfirmua dhe në takimin e zhvilluar me stafin akademik. <i>GVJ vëren se një pjesë e syllabuseve nuk janë të miratuara nga Drejtuesi i Njesisë Bazë dhe për këtë arsye rekomandon që kjo procedurë të ndiqet rregullisht. Po ashtu, një pjesë e literaturës është e vjetër dhe ka nevojë për përditësim.</i> Programi i studimit përmirësohet vazhdimisht dhe në fillim të vitit akademik bëhen

dhe ndihmëse të viteve të fundit.	ndryshimet/përmirësimet e nevojshme. Kjo u konfirmua dhe nga stafi akademik. Sipas Rregullores së Njesisë Kryesore, stafi akademik paraqet pranë Njesisë Bazë / Dekanat programin e përditësuar të lëndës për vitin akademik përkatës, një javë para fillimit të vitit akademik. <i>Pavarësisht se kjo është një procedurë që FSHMT ndjek, GVJ konsideron si të rëndësishme dokumentimin e rregullt të përditësimeve.</i> Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Evidenca 86. Programi Msc në Fizioterapi 21-23; - Evidenca 91.2 Plani mësimor Msc Fizio 23-25; - Evidenca 92.1-92.8, Syllabuset e lëndëve; - Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë; - Takim me stafin akademik.
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi i studimit MSc. në Fizioterapi përfshin element si leksione, seminare, laboratore, praktika profesionale etj. Kjo ndërthurje e këtyre elementëve u jep mundësinë studentëve të fitojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të reja. Neni 6 dhe 7 i Rregullores së programit të studimit si dhe syllabuset e lëndëve përcaktojnë qartë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studentët përfitojnë në fund të çdo lënde/moduli si dhe në përfundim të studimeve. <i>Studentët raportuan se përmes praktikës ata kanë mundësi të “prekin” pacientë shumë shpejt dhe kjo i ndihmon ata të rrisin njohuritë dhe aftësitë e tyre.</i> Evidenca: - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Evidenca 86. Programi Msc në Fizioterapi 21-23; - Evidenca 91.2 Plani mësimor Msc Fizio 23-25; - Evidenca 92.1-92.8, Syllabuset e lëndëve; - Takim me studentët.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e	Në përfundim të këtij cikli studimesh, studentët kanë mundësi të vazhdojnë studimet e tyre brenda ose jashtë vendit por edhe të punësohen. Gjatë takimeve në UMT, pjesa më e madhe e studentëve të cilët ndiqnin një cikël studimesh të dytë, kishin përfunduar studimet Bachelor në këtë Institucion. Po ashtu, disa

studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	nga anëtarët e stafit akademik kishin përfunduar program studimi në Fizioterapi pranë UMT-së. Për shkak edhe të pozicionit të FSHMT (pranë QSUNT), të diplomuarit kanë mundësi të kenë kontakt direkt me tregun e punës. Studentët në takimin e zhvilluar raportuan se një pjesë do të zhvilloj studime të mëtejshme ndërsa disa të tjerë do ti drejtohen tregut të punës. Paralelisht, disa studentë raportuan se preferojnë të punësohen fillimisht diku me qëllim përfitimin e njohurive dhe aftësive dhe pastaj do të shikonin mundësinë për të hapur një punë të tyre private. Evidenca: - Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.			
Konkluzione	Programi i studimit ka në përbërje të vet leksione, seminare, orë laboratorike, praktikë si dhe studim individual. Ndërhurja e këtyre komponentëve u jep mundësinë studentëve të thellojnë njohuritë e tyre si dhe mundësi punësimi. Në syllabuset e lëndëve përcaktohen kreditet dhe orët brenda dhe jashtë auditorit. Orët totale të praktikës janë 470. Asnjë nga studentët që morën pjesë në takim nuk kishte zhvilluar mobilitet. GVJ konsideron se kjo është një pikë e dobët që UMT duhet të punoj më shumë. GVJ vëren se një pjesë e syllabuseve nuk janë të miratuara nga Drejtuesi i Njesisë Bazë dhe për këtë arsye rekomandon që kjo procedurë të ndiqet rregullisht. Po ashtu, një pjesë e literaturës është e vjetër dhe ka nevojë për përditësim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me	Programi i studimit përmirësohet në bazë të sugjerimeve të stafit akademik dhe të studentëve. Studentët, shprehin mendimet e tyre përmes pyetësorit të zhvilluar. Stafi akademik përmirëson rregullisht syllabuset në bazë të zhvillimeve të fushës. Kjo u

kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	konfirmua në takimet e zhvilluara në Institucion. Rritja e orëve të praktikës profesionale ka ardhur si pasojë e propozimeve të bëra nga stafi akademik. Kjo u raportua dhe nga GVB në takimin e zhvilluar me ata. FSHMT është e pozicionuar brenda spitalit Universitar QSUNT dhe kjo i jep mundësi stafit të marri parasysh rregullisht propozimet e Institucionit, acientëve si dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. <i>Pavarësisht këtyre, dokumentimi i rregullt i përmirësimit të programit të studimit me përfshirjen e aktorëve të ndryshëm, është i nevojshëm.</i> Përfshirja e rregullt e aktorëve të jashtëm do i japi mundësi UMT të përshtasi akoma dhe më mirë programin e studimit në bazë të nevojave të tregut të punës. Evidenca: - Evidenca 27, Pyetëtori i studenteve fshmt_23; - Evidenca 28, Rezultatet_pyetesorit_studentet_23; - Evidenca 127, Statuti i Keshillit Studentor UMT; - Takim me Drejtuesen e Njësisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësisë Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me GVB; - Takim me studentët.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Studentët përfshihen në përmirësimin e programit të studimit përmes pyetëtorit të cilit ata plotësojnë. Në përfundim të pyetëtorit NJSBC harton raportin dhe ia përcjell organeve repektive. Studentët raportuan se e zhvillojnë rregullisht plotësimin e pyetëtorit. Paralelisht studentët raportuan se janë të përfshirë në përmirësimin e programit të studimit përmes përfaqësuesve të tyre (senatorëve). Përfshirja e studentëve të diplomuar nuk është ende në nivele të larta pasi tani institucioni po krijon një database të mirëfilltë duke përdorur si referenc edhe ata që janë larguar nga Shqipëria. Përfshirja e alumni, por më shumë në mënyrë informale u konfirmua në takimin e zhvilluar me autoritetet Drejtuese të UMT. <i>GVJ konsideron të rëndësishme përfshirjen e alumni në përmirësimin e programit të studimit dhe UMT duhet të punoj më shumë në këtë drejtim.</i> Evidenca: - Evidenca 27, Pyetëtori i studenteve fshmt_23; - Evidenca 28, Rezultatet_pyetesorit_studentet_23; - Evidenca 107, Manuali i keshillimit te karrieres fshmt;

	- Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë; - Takim me studentët; - Takim me përfaqësues të Degës së Karrierës dhe Zhvillimit.			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	UMT bashkëpunon rregullisht me MAS, QSUNT si dhe Institucione e rrjete profesionistësh e shoqata mjekësore. Bashkëpunimi përfshin organizimin e aktiviteteve të ndryshme, konferenca, kërkim shkencor etj. Në takimet e zhvilluara në Institucion u raportua se programi i studimit përditësohet rregullisht (çdo vit) duke u bazuar dhe në bashkëpunimin e UMT me shoqatat e ndryshme. Disa herë ky bashkëpunim është dhe “informal” u raportua. GVJ konsideron si të rëndësishme përmirësimin e programit duke përfshirë këto grupe interesi si dhe duke i dokumentuar këto aktivitete/takime. Evidenca: - Evidenca 46, Memorandume bashkëpunimi UMT me MShMS.pdf; - Evidenca 49, Lista e bashkëpunimeve me IAL kombetare, nderkombetare dhe institucione te tjera; - Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë; - Takim me stafin akademik.			
Konkluzione	Programi i studimit përmirësohet në bazë të sugjerimeve të stafit akademik dhe të studentëve. FSHMT është e pozicionuar brenda spitalit Universitar QSUNT dhe kjo i jep mundësi stafit të marri parasysh rregullisht propozimet e Institucionit, pacientëve si dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. Dokumentimi i rregullt i përmirësimit të programit të studimit me përfshirjen e aktorëve të ndryshëm, është i nevojshëm. GVJ konsideron të rëndësishme përfshirjen e alumni dhe grupeve të profesionistëve dhe shoqatave në përmirësimin e programit të studimit dhe UMT duhet të punoj më shumë në këtë drejtim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit është hartuar në përputhje me vizionin e Institucionit, si edhe në vijim të arritjes të objektivave strategjike të këtij programi. Sipas Rregullores së programit të studimit (neni 8), Programi MSc. në "Fizioterapi" e zhvillon veprimtari të tij në bazë të parimeve të lirisë dhe cilësisë akademike (liria akademike në mësimdhënien akademike nënkupton respektimin e shumëllojshmërisë së opinioneve, ideve e metodave dhe garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijes të mësimdhënies e të kërkimit shkencor). Parimi i cilësisë nënkupton zbatimin e standardeve akademike dhe kërkimore menaxhuese të infrastrukturës si në aspektin e kërkesave edhe të rezultateve. Respektimi i parimit të cilësisë ka për qëllim realizimin e vlerësimit të brendshëm (të vetëvlerësimit), të vlerësimit të jashtëm dhe të akreditimit, duke synuar përmirësimin, ndryshimin dhe përparimin e cilësisë së programit të ciklit të dytë të studimit MSc. në Fizioterapi. UMT ka si vizion të jetë dhe të mbetet qendra më e rëndësishme akademike dhe kërkimore e shkencave mjekësore në Shqipëri. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është i vetmi institucion publik në fushën e shkencave mjekësore dhe ka si qëllim të ruajë rolin e udhërrëfyesit në përballjen e sfidave të së ardhmes të kujdesit shëndetësor, duke synuar formimin e profesionistëve të ardhshëm të shëndetit, të orientuar drejt kujdesit mjekësor të mbështetur në fakte, vlerësimit të cilësisë dhe performancës së kujdesit shëndetësor, mjekësisë së integruar proaktive dhe parandaluese, ofrimit të shërbimeve shëndetësore nga ekupe multidisciplinare etj. UMT ka si mision të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, veprimtarisë kërkimore-shkencore e inovacionit, si dhe shërbimeve në fushat e shkencave mjekësore, të formojë specialistë të lartë e të përgatisë shkencëtarë të rinj në këtë drejtim. Paralelisht, bashkëpunon me studentët, qeverinë, shërbimin shëndetësor dhe shoqërinë civile me qëllim përgatitjen e profesionistëve të shëndetit që praktikojnë kujdesin optimal ndaj pacientit, me qëllim parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve dhe përparimin e kërkimit shkencor në dobi të shëndetit, të mundësojë formimin e vazhduar gjatë gjithë jetës si dhe të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel rajonal e kombëtar. Programi i studimit Master Programi i nivelit të dytë (Master i Shkencave) në Fizioterapi ka si qëllim të formojë Fizioterapist profesionistë me njohuri të thella lidhur me

	zhvillimin gjuhësor problematikat që prekin gjuhën receptive dhe gjuhën ekspresive gjatë moshës evolutive, si dhe rastet e pacientëve pediatrik apo adult me çrregullime të ndryshme të fituara të të folurit. Ky program ka për qëllim të nxisë kërkimin dhe hulumtimin shkencor në Fizioterapi. MSc në "Fizioterapi" është hartuar në përputhje me strategjitë kombëtare dhe argumentohet që realizohet në përputhje me vizionin dhe strategjinë e interesat kombëtare si dhe mbi fokusin global të zhvillimit kombëtar përshkruar në ligjin Nr. 80/2015 Datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Programi i studimit është në unison me qëllimet dhe misionin e UMT. Evidenca: - Evidenca 1, Statuti i UMT; - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Evidenca 86, Programi i MP Fizioterapi 2021-2022; - Evidenca 170, Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Sipas Rregullores së programit të studimit (neni 8), Programi Master Shkencor në "Fizioterapi" e zhvillon veprimtarinë e tij në bazë të parimeve të lirisë dhe cilësisë akademike (liria akademike në mësimdhënien akademike nënkupton respektimin e shumëllojshmërisë së opinioneve, ideve e metodave dhe garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijues të mësimdhënies e të kërkimit shkencor). Kjo liri akademike ushtrohet në përputhje me planet e programet mësimore të hartuara e miratuara nga strukturat akademike të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, për të gjitha lëndët/modulet që përfshihen në të. Kërkimi shkencor që zhvillon stafi akademik është në bazë të interesave personale, ekspertizës si dhe objektivave madhore të Institucionit. Evidenca: - Evidenca 1, Statuti i UMT; - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Takim me Drejtuesen e Njësisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë;

	- <i>Takmi me stafin akademik.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit MSc. në Fizioterapi ka kohëzgjatje 2 vite akademike (4 semestra) dhe në total 120 kredite. Nuk përfshihen lëndë specifike me qëllim kërkimin shkencor. Studentët raportuan se në bazë të dëshirës mund të përfshihen në aktivitete kërkimore (si psh. konferenca, workshope etj.). Plani mësimor ka të përfshirë lëndën “Metodologjia e Kërkimit” e cila përmban dy module 1) Metodologji Kërkimi dhe 2) Shkrim Akademik. Evidenca: - Evidenca 15, Aktivitete student libri i abstrakteve_konferenca e shkencave mjekesore; - Evidenca 16, Info-Session për Konkursin e Kërkimit Shkencor dedikuar studenteve. FSHMT; - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Evidenca 86. Programi Msc në Fizioterapi 21-23; - Evidenca 91.2 Plani mesimor Msc Fizio 23-25; - Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Në takimet e zhvilluara me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë si dhe me stafin akademik, u raportua se ata rregullisht mbështeten nga Institucioni për pjesëmarrje në aktivitete shkencore ose për publikim artikujsh. Kjo bëhet përmes financimit të fee-së së pjesëmarrjes. Paralelisht, institucioni organizon aktivitete shkencore vetëm ose në bashkëpunim me Institucione brenda ose jashtë Shqipërisë. Evidenca: - Evidenca 18, Konferenca vjetore libri i abstrakteve_FSHMT; - Evidenca 29, Programi-konferenca-VLORE-2023-tetor-26-27; - Evidenca 30, Konferenca-vjetore-2023-FSHMT-në-bashkëpunim-me-UV-dhe-UIISH; - Takim me Drejtuesen e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë; - Takmi me stafin akademik.

Konkluzione	Programi i studimit është hartuar në përputhje me vizionin e Institucionit. Program i studimit MSc. në Fizioterapi ka si qëllim të formojë fizioterapistë profesionistë me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme. Programi ofrohet në bazë të parimeve të lirisë dhe cilësisë akademike. Plani mësimor ka të përfshirë lëndën "Metodologjia e Kërkimit" e cila përmban dy module 1) Metodologji Kërkimi dhe 2) Shkrim Akademik. Staf i akademik mbështetet nga Institucioni për aktivtete të Kërkimit Shkencor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Institucioni mbështet zhvillimin e kërkimit shkencor përmes bashkëpunimit me Institucione brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ky bashkëpunim ka sjell si rezultat organizimin e aktiviteteve të ndryshme kërkimore shkencore përfshirë këtu publikime artikujsh, organizimin e konferencave, workshop-eve etj. Bashkëpunimi po ashtu me QSUNT, i jep mundësinë stafit akademik të zhvillojë kërkime shkencore dhe të testoj efektivitetin e tyre. <i>Në vlerësimin e GVJ, kjo është një pikë e fortë që Institucioni duhet të vazhdoj ta ndjek.</i> Evidenca: - Evidenca 18, Konferenca vjetore libri i abstrakteve_FSHMT; - Evidenca 29, Programi-konferenca-VLORE-2023-tetor-26-27; - Evidenca 30, Konferenca-vjetore-2023-FSHMT-ne-bashkepunim-me-UV-dhe-UISH; - Takimi me stafin akademik.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe	UMT merr pjesë rregullisht në projekte kërkimore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Çdo vit, stafi akademik aplikon në projekte të MAS, AKKSHI, ose thirrje Europiane. Studentët përfshihen në këto projekte për aktivitete të ndryshme si mbledhje të dhënash dhe veprimtari të tjera mbështetëse. Raportet vjetore

angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	të Institucionit prezantojnë me detaje aktivitetin shkencor të stafit akademik. Evidenca: - Evidenca 18, Konferenca vjetore libri i abstrakteve_FSHMT; - Evidenca 29, Programi-konferenca-VLORE-2023-tetor-26-27; - Evidenca 30, Konferenca-vjetore-2023-FSHMT-në-bashkëpunim-me-UV-dhe-UISH; - Evidenca 44, Lista e projekteve nderkombetare te aplikuara dhe te fituara; - Evidenca 45, Lista e projekteve kombetare të aplikuara dhe të fituara; - Evidenca 79.1, Raporti Vjetor_UMT_2021-2022; - Evidenca 81, Raport vjetor FSHMT 2021-2022; - Evidenca 85, Analiza vjetore 2022-2023 DDRSHIKIOGj.
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Institucioni organizon rregullisht konferenca ose aktivitete kërkimore shkencore. Konferencat shkencore organizohen zakonisht për fushën e shkencave mjekësore dhe jo specifiku për fizioterapinë. Pavarësisht kësaj, sesione të veçanta i dedikohen zhvillimeve në fushën e fizioterapisë. Publikimi i artikujve shkencor në revistën shkencore të FSHMT-së ose në revista të tjera kombëtare/ndërkombëtare është një praktikë e rregullt që stafi akademik ndjek. Evidenca: - Evidenca 18, Konferenca vjetore libri i abstrakteve_FSHMT; - Evidenca 29, Programi-konferenca-VLORE-2023-tetor-26-27; - Evidenca 30, Konferenca-vjetore-2023-FSHMT-në-bashkëpunim-me-UV-dhe-UISH; - Evidenca 152, Lista e botimeve të revistës shkencore të FSHMT2; - Evidenca 154, Analizë për aktivitetin kërkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik te UMT.
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues	Programi i studimit mundëson përgatitjen e studentëve për tregun e punës. Zhvillimi i praktikave profesionale pranë QSUNT edhe/ose spitaleve dhe qendrave të tjera publike/private, përgatit studentët për tregun e punës. Ndërthurja e leksioneve me

për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	seminaret, laboratorët dhe praktikat mësimore u jep mundësinë studentëve të fitojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për tregun e punës. Për shkak edhe të pozicionit të FSHMT (pranë QSUNT), të diplomuarit kanë mundësi të kenë kontakt direkt me tregun e punës. Në takimet e zhvilluara u raportua se një pjesë e madhe e të diplomuarve i drejtohen dhe tregut ndërkombëtar. Studentët e diplomuar nga ky program studimi kanë mundësinë të punësohen në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në takimin me Drejtuesit e Njësive kryesore dhe Bazë ata raportuan se shumë studentë largohen nga vendi për punësim. Studentët po ashtu raportuan se një pjesë e tyre po përgatiten për tregun ndërkombëtar. Evidenca: - Takim me Drejtuesin e Njësive Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët; - Takim me Përfaqësues të Degës së Karrierës dhe Zhvillimit.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	FSHMT bashkëpunon rregullisht me Urdhërin e Infermierit. Studentët e diplomuar janë të regjistruar pranë Urdhërit. Njësia Bazë raporton se ka takime të vazhdueshme me Urdhërin e Infermierit. Këto takime zakonisht janë informale dhe <i>kjo është një pikë e cila është e nevojshme të ndryshoj. Dokumentimi i bashkëpunimit rekomandohet nga GVJ.</i> Evidenca: - Takim me Drejtuesin e Njësive Kryesore dhe Bazë.
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Programi i studimit MSc. në “Fizioterapi” është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në vend si dhe rekomandimet ndërkombëtare dhe direktivat e Rregullores së Bashkimit Europian. Stafi akademik është i përshtatshëm dhe me kualifikimin e duhur për ofrimin e këtij programi studimi. Rregullorja e programit është në përputhje me Ligjin 80/2015 si dhe Rregulloren dhe Statutin e UMT-së, ndërsa plani mësimor përfshin të gjithë elementët e nevojshëm. Evidenca: - Evidenca 1, Statuti i UMT; - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT;

	- Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Evidenca 86. Programi Msc në Fizioterapi 21-23; - Evidenca 91.2 Plani mesimor Msc Fizio 23-25.			
Konkluzione	Institucioni mbështet zhvillimin e kërkimit shkencor përmes bashkëpunimit me Institucione brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ky bashkëpunim ka sjell si rezultat organizimin e aktiviteteve të ndryshme kërkimore shkencore përfshirë këtu publikime artikujsh, organizimin e konferencave, workshop-eve etj. UMT merr pjesë rregullisht në projekte kërkimore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Programi i studimit mundëson përgatitjen e studentëve për tregun e punës. FSHMT bashkëpunon rregullisht me Urdhërin e Infermierit. Programi i studimit MSc. në "Fizioterapi" është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në vend.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat	Sipas Rregullores së UMT (neni 74), veprimtaritë formuese, që karakterizojnë një program studimi, përbëhen nga komponentët mësimore, të cilët ndahen në: mësim në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, praktika profesionale/klinike, forma të kontrollit të vazhdueshëm etj), studim individual (studim, punim relacionesh detyrash apo projektesh), përgatitje për provime, përgatitje e tezës së diplomës. Këto përcaktohen

profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	dhe në Rregulloren e Njesisë Kryesore (neni 31). Në rregulloren e programit të studimit (neni 14) përcaktohet se veprimtaria akademike realizohet nëpërmjet orëve teorike, hulumtimit shkencor dhe praktikës klinike: leksioneve, seminareve, detyrave të kursit, prezantimeve dhe praktikës. Kohëzgjatja e seancave mësimore (në minuta) është sipas përcaktimeve të akteve nënligjore. Programi i studimit në MSc. në Fizioterapi” zgjat 2 vite dhe ndahet në 4 semestra, të cilët ndahen në modulet përkatëse. Pjesëmarrja në leksione është fakultative, ndërsa në seminare dhe praktika në masën 70%. Raporti leksione/seminare i orëve në auditor është 2:1. Një kredit ka 25 orë mësimore, nga të cilat 12 janë orë në auditor dhe 13 janë orë individuale. Në fund të çdo moduli, studenti shlyen lëndët përkatëse (të detyrueshme) me një provim për çdo lëndë të modulit. Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Evidenca 86. Programi Msc në Fizioterapi 21-23; - Evidenca 91.2 Plani mësimor Msc Fizio 23-25; - Evidenca 92.1-92.8, Syllabuset e lëndëve.
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Për ofrimin e këtij programi studimi, stafi akademik përdor mënyra të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Stafi akademik raportoi se përdor mënyra si role playing, diskutime në klasë, raste specifike, raste klinike, ilustrime në video dhe foto të ndryshme. Stafi akademik theksoi se mundohet të përdori metodën “sandwich” gjatë mësimdhënies dhe mësimnxënies. Paralelisht, ata raportuan se përdorin prezantime në PowerPoint gjatë zhvillimit të leksioneve të tyre. Ndërthurja e leksioneve me seminarët, laboratorët dhe praktikat mësimore u jep mundësinë studentëve të fitojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për tregun e punës. <i>Metodat e mësipërme u konfirmuan dhe në takimin e zhvilluar me studentët të cilët e vlerësuan pozitivisht zhvillimin e leksioneve. Studentët theksuan se njohuritë teorike që ata fitojnë i ndihmojnë shumë gjatë zhvillimit të praktikave.</i>

	Evidenca: - Evidenca 18, Konferenca vjetore_libri i abstrakteve_FSHMT; - Evidenca 29, Programi-konferenca-VLORE-2023-tetor-26-27; - Evidenca 30, Konferenca-vjetore-2023-FSHMT-në-bashkëpunim-me-UV-dhe-UISH; - Evidenca 118, Infrastruktura në funksion të mësimdhënies, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët;
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	UMT mbështet stafin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike përmes formave të ndryshme. Stafi akademik raportoi se Institucioni organizon rregullisht aktivitete trajnuese për përmirësimin e aftësive mësimdhënëse dhe kërkimore shkencore. Organizimi i konferencave, workshop-eve etj. janë një pikë e fortë që u raportua. Po ashtu, përmes projektit HUB për didaktikën, stafi akademik ka përfituar njohuri të reja mësimdhënëse. UMT mundohet të suportoje vazhdimisht stafin përmes mbështetjes financiare të pjesëmarrjes në konferenca/simpoziume etj. (përmes pagesës së fee-së) edhe/ose përmes financimit të botimeve shkencore. Shkëmbimi i eksperiencave përmes programit Erasmus+, i ka dhënë mundësinë stafit akademik të zhvillojë mobilitete afatshkurtra për mësimdhënie ose trajnim. Evidenca: - Evidenca 49, Lista e bashkëpunimeve me IAL kombetare, nderkombetare dhe institucione të tjera; - Evidenca 116, Projekti i Qendres së Biosimulimit klinik dhe Edukimit në vazhdim UMT; - Evidenca 154, Analize për aktivitetin kërkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik të UMT; - Evidenca 166, Lista e mobiliteteve; - Evidenca 171, Lista e mobiliteteve hyrese dhe dalese & analize statistikore FSHMT; - Takim me stafin akademik.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program	Një nga objektivat kryesore të Planit strategjik të UMT është ai i krijimit të stafit akademik cilësor, të përkushtuar, profesionist dhe etik. Personeli akademik i Universitetit të Mjekësisë,

është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Tiranë, përbën elitën e sistemit shëndetësor, elitë e cila duhet nxitur dhe zhvilluar për një staf ekselent të zbatimit të politikave "brain-gain" që nxisin rritjen e performancës së personelit akademik dhe kërkimit shkencor, përmes përfshirjes në projekte kombëtare dhe ndërkombetare etj. Personeli akademik i cili është i angazhuar në mësimdhënie ka njohuritë dhe aftësitë e duhura. Rekrutimi i tyre zhvillohet në bazë të disa kriterëve specifikë (përfshirë këtu edhe eksperiencën e mëparshme në mësimdhënie dhe kërkim shkencor). Stafi akademik konfirmoi se përdor metoda interaktive gjatë mësimdhënies dhe se qëllimi i tyre është mësimdhënia me në qendër studentin. Studentët konfirmuan këtë më lart. Paralelisht, studentët përmes pyetësorit të përdorur për vlerësimin e mësimdhënies kanë mundësi të shprehin lirshëm mendimet dhe idetë e tyre. Respektimi i kodit të etikës është një nga detyrimet kryesore si të stafit akademik ashtu edhe të studentëve. Evidenca: - Evidenca 96, CV-te e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit; - Evidenca 96.1, CV-te e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit; - Evidenca 157, Model kontrate personel administrativ; - Evidenca 158, Model kontrate personel ndihmes akademik; - Evidenca 159, Model kontrate pedagoget e jashtëm; - Evidenca 160, Model kontrate personel akademik; - Evidenca 162, Procedurat e punësimit të personelit akademik, ndihmës..., administrativ UMT; - Evidenca 165.1 Staf Akademik PAE_PAK Fizioterapi; - Evidenca 165, Te dhena statistikore_stafi akademik 2019-2024; - Evidenca 170, Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024; - Takim me stafin akademik; - Takim me përfaqësues të Burimeve Njerëzore.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat	Studentët që ndjekin programin e studimit MSc. në Fizioterapi janë të përfshirë në mënyrë aktive në vlerësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies. Studentët përmes pyetësorit të cilit plotësojnë, vlerësojnë pedagogët e lëndës respektive. Bazuar në

e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	rezultatet e pyetësorit, NJSBC përpunon të dhënat dhe harton raporte. <i>Studentët konfirmuan që marrin pjesë rregullisht në plotësimin e pyetësorit ndërsa raportuan se nuk njihen mbi rezultatet e pyetësorit dhe kjo është një pikë mbi të cilën Institucioni duhet të punoj më shumë.</i> Në bazë të rezultateve ndërmerren hapa për përmirësimin e problematikave u raportua nga NJSBC si dhe stafi akademik. <i>Në bazë të rezultateve, përfaqësues të NJSBC raportuan se merren masa por nuk hartohet një plan specifik.</i> Evidenca: - Evidenca 68, Shembull_Pyetesor_Vlerësim i studentëve për UMT_formular; - Evidenca 69, Përbërja e NJSBC - VSA nr.103, dt.20.10.2020 ndryshuar; - Takim me studentët; - Takim me përfaqësues të NJSBC.
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Institucioni ka ngritur NJSBC e cila harton standardet për sigurimin e cilësisë së brendshme në përputhje me Kodin e Cilësisë në nivel Institucional. Përfaqësues të sektorit raportuan se përfshihen në të gjitha proceset e përmirësimit të cilësisë. Kjo zhvillohet në bazë të detyrimeve ligjore si dhe bazuar në procedurat standarde dhe rregullat e brendshme të UMT-së. UMT ka dhe Drejtorinë e Administrimit Akademik dhe Kurrikulës e cila rregullisht vlerëson kurrikulat si dhe propozon ndryshimet e nevojshme. Drejtoria e Kërkit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit asiston rregullisht stafin akademik në përmirësimin e aftësive të veta duke i mbështetur me organizimin e aktiviteteve shkencore ose për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme akademike dhe shkencore. Evidenca: - Evidenca 3, Organigrama UMT; - Evidenca 181, Rregullore e funksionimit NJSBC-UMT; - Evidenca 182, Rregullore mbi botimet mësimore-shkencore në UMT; - Evidenca 183, Rregullore-mbi-organizimin-dhe-funksionimin-e-Këshillit-të-Botimeve-UMT-VSA-nr.-42-datë-29.04.2022 (1); - Takim me stafin akademik; - Takim me përfaqësues të NJSBC.

Konkluzione	<i>Veprimtaritë formuese, që karakterizojnë një program studimi, përbëhen nga komponentët mësimore, të cilët ndahen në: mësim në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, praktika profesionale/klinike, forma të kontrollit të vazhdueshëm etj), studim individual (studim, punim relacionesh detyrash apo projektsh), përgatitje për provime, përgatitje e tezës së diplomës. Staf i akademik raportoi se përdor mënyra si role playing, diskutime në klasë, raste specifike, raste klinike, ilustrime në video dhe foto të ndryshme. Staf i akademik raportoi se Institucioni organizon rregullisht aktivitete trajnuese për përmirësimin e aftësive mësimdhënëse dhe kërkimore shkencore. Studentët konfirmuan që marrin pjesë rregullisht në plotësimin e pyetësorit. Institucion ka ngritur NJSBC e cila harton standardet për sigurimin e cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Në nenet 86-88 të Rregullores së Institucionit përcaktohet mënyra/t e testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve. Për të vlerësuar njohuritë e studentit, në UMT përdoret sistemi shqiptar i vlerësimit me 10-të nota. Nota minimale kaluese është 5 (pesë) dhe nota maksimale është 10 (dhjetë). Me këtë sistem bëhet vlerësimi në të gjitha format e kontrollit të përdorura. Nenet 40-42 të Rregullores së Njesisë Kryesore, neni 37 i Rregullores së Njesisë Bazë dhe neni 16 i Rregullores së programit të studimit përcaktojnë procedurën dhe kriteret e vlerësimit. Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve. Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet: a) me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar: b) me detyra kursi; c) i bazuar në kombinimin e formave të mësipërme të vlerësimit. Vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet pas përfundimit të saj me sistemin e notave. Evidenca:

	- Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Takim me studentët.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në nenin 86 të Rregullores së Institucionit përcaktohet se në programin e lëndës/modulit shprehen mënyrat e vlerësimit të saj, të cilat i bëhen të njohura studentit me fillimin e procesit mësimor. Studentët orën e parë të lëndës informohen nga pedagogu respektiv mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Ky informacion është po ashtu edhe në syllabuset e lëndëve. Informimi i studentëve orën e parë të modulit u konfirmua dhe gjatë takimeve si nga stafi akademik po ashtu dhe nga studentët. Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Evidenca 92.1-92.8, Syllabuset e lëndëve; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi i studentit mbështetet në vlerësimin vjetor/semestral të punës në auditor, rezultateve të seminareve, rezultateve laboratorike, përgatitjes së detyrave të kursit, praktikave profesionale, etj., por provimi, është forma kryesore për vlerësimin e nivelit të përvetësimit të njohurive që studenti ka përfutur gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde. Mënyra e vlerësimit dhe shpërndarja e pikëve brenda lëndës/modulit bëhet sipas modelit të detajuar paraprakisht nga njësia bazë. Pikët e fituara nga detyrat dhe vlerësimet gjatë vitit i bëhen të njohura studentit para provimit. Kur lënda përmban dy ose më shumë module, nota përfundimtare vendoset mbi bazën e mesatares së ponderuar. Format e kontrollit të dijeve janë me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Rezultati përfundimtar i kontrollit të dijeve përfshin vlerësimin e të gjithë elementëve të studimit të parashikuar në programin mësimor. Vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet pas përfundimit të saj me sistemin e notave, ku 5 është nota minimale kaluese dhe 10 ajo maksimale.

	Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Evidenca 92.1-92.8, Syllabuset e lëndëve.			
Konkluzione	Në nenet 86-88 të Rregullores së Institucionit përcaktohet mënyra/t e testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve. Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet: a) me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar: b) me detyra kursi; c) i bazuar në kombinimin e formave të mësipërme të vlerësimit. Studentët orën e parë të lëndës informohen nga pedagogu respektiv mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet pas përfundimit të saj me sistemin e notave, ku 5 është nota minimale kaluese dhe 10 ajo maksimale. Programi i studimit përmirësohet në bazë të sugjerimeve të stafit akademik dhe të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i studentit mbështetet në vlerësimin vjetor/semestral të punës në auditor, rezultateve të seminareve, rezultateve laboratorike, përgatitjes së detyrave të kursit, praktikave profesionale, etj., por provimi, është forma kryesore për vlerësimin e nivelit të përvetësimit të njohurive që studenti ka përfituar gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde. Mënyra e vlerësimit dhe shpërndarja e pikëve brenda lëndës/modulit bëhet sipas modelit të detajuar paraprakisht nga njësia bazë. Pikët e fituara nga detyrat dhe vlerësimet gjatë vitit i bëhen të njohura studentit para provimit. Kur lënda përmban dy ose më shumë module, nota përfundimtare vendoset mbi bazën e mesatares së ponderuar. Mënyra e vlerësimit parashikohet edhe në syllabuset e secilës lëndë. Vlerësimi i

	vazhduar u raportua dhe në takimet me stafin akademik dhe studentët. Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Evidenca 92.1-92.8, Syllabuset e lëndëve; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UMT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me AADF me qëllim implementimin e projektit CleanScore. Ky projekt ka si qëllim korrigjimin dhe vlerësimin e tezave të studentëve në mënyrë anonime dhe elektronike. Përmes këtij projekti, vlerësimi zhvillohet në mënyrë të automatizuar duke rritur transparencën dhe shmangien e padrejtësive. Përdorimi i këtij sistemi u konfirmua dhe nga studentët dhe stafi akademik. Paralelisht, provimet zhvillohen me sekretim (neni 91 i Rregullores së UMT-së). Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 145, Relacion cleanscore; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Rezultati përfundimtar i kontrollit të dijeve përfshin vlerësimin e të gjithë elementëve të studimit të parashikuar në programin mësimor. Teza e provimit hartohet nga titullari i lëndës, miratohet nga përgjegjësi i departamentit/zv. dekani për anën mësimore (i cili luan edhe rolin e koordinatorit). Pas përfundimit të provimit teza e provimit depozitohet së bashku me çelësin e zgjidhjes tek drejtuesi i njësisë bazë/ zv. dekani (për lëndët në varësi të dekanatit) për anën mësimore menjëherë pas zhvillimit të provimit me shkrim. I gjithë vlerësimi i studentëve zhvillohet në përputhje me syllabusin si dhe rregulloret e UMT-së. Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT;

	- <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Rezultatet e provimit/kolokiumit u bëhen të njohura studentëve nga komisioni në përfundim të provimit me gojë dhe për provimet me shkrim, pas korrigjimit të tyre. Në këtë rast, rezultatet e provimit afishohen për çdo grup. Personeli akademik i lëndës i komunikon studentëve pikët e vlerësimit të provimit/kontrollit të ndërmjetëm, përfundimtar dhe të detyrave/projekteve, etj, si dhe notën përfundimtare me të cilën janë vlerësuar në këtë lëndë, apo në Praktikën Profesionale. Rezultatet e provimit ju bëhen me dije studentëve përmes platformës elektronike PITAGORA (Portalin e Studentit). Në rast se provimi zhvillohet në formën e pyetjeve me përgjigje alternative, komisioni shpall dhe çelësin e zgjidhjes, kur kërkohet ose zhvillohet me CleanScore. Rezultatet paraprake të provimit hidhen në sistem nga komisioni i provimit brenda ditës kur provimi është me gojë dhe brenda 5 ditëve (të punës) nga data e kryerjes, kur provimi është me shkrim ose me shkrim dhe gojë. Mbas shpalljes së rezultateve paraprake të provimit (hedhjes së tyre në sistem) studentët kanë detyrimin e leximit të notës së tyre në sistem dhe të kontestimit të mundshëm brenda një dite (24 orë). Në të kundërt nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit në sistem. Studentët kanë mundësi të diskutojnë/pyesin pedagogun e lëndës mbi paqartësitë apo/edhe gabimet e tyre. Kjo procedurë u konfirmua edhe nga studentët gjatë takimit me ta. Evidenca: - <i>Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ;</i> - <i>Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Nuk lejohet hyrja në provim e personave të jashtëm. Në provim nuk lejohet mbajtja dhe përdorimi i telefonave celularë apo mjeteve të dyshimta elektronike, si dhe komunikimi midis studentëve gjatë procesit të zhvillimit të provimit. Studenti që në provim përdor forma e mjete të palejueshme, përjashtohet nga provimi. Komisioni i provimit vë në dijeni drejtuesin e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, për të proceduar më tej në përputhje me Kodin e Etikës së UMT-së. UMT ka në dispozicion edhe mjete elektronike të kontrollit të plagjiaturës.

	Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; - Takim me stafin akademik.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e provimit/kolokiumit u bëhen të njohura studentëve nga komisioni në perfundim të provimit me gojë, dhe për provimet me shkrim, pas korrigjimit të tyre. Në këtë rast, rezultatet e provimit afishohen për çdo grup. Studenti i merr rezultatet e provimit për modulin përkatës në Portalin e Studentit. Rezultatet paraprake të provimit hidhen në sistem nga komisioni i provimit brenda ditës kur provimi është me gojë dhe brenda 5 ditëve (të punës) nga data e kryerjes, kur provimi është me shkrim ose me shkrim dhe gojë. Mbas shpalljes së rezultateve paraprake të provimit (hedhjes së tyre në sistem) studentët kanë detyrimin e leximit të notës së tyre në sistem dhe të kontestimit të mundshëm brenda një dite (24 orë). Në të kundërt nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit në sistem. Në rregulloren e Institucionit (neni 91, pika 10) dhe në Rregulloren e Njesisë Kryesore (neni 45, pika 10) përcaktohet se rezultatet e provimit me shkrim publikohen brenda 10 ditëve, ndërsa në rregulloren e Njesisë Bazë ky afat është 5 ditë (neni 30, pika 5a). <i>GVJ sugjeron që kjo të korrigjohet.</i> Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ.
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e marrë në provim, nëpërmjet ankimit zyrtar drejtuar Komisionit, brenda 24 orëve. Komisioni i vlerësimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën brenda 24 orëve nga përfundimi i afatit të ankimit. Mbas shpalljes së rezultateve paraprake të provimit (hedhjes së tyre në sistem) studentët kanë detyrimin e leximit të notës së tyre në sistem dhe të kontestimit të mundshëm brenda një dite (24 orë). Në të kundërt nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë

	mbylljen përfundimtare të procesverbalit në sistem. Studentët konfirmuan se njhen me vlerësimin ndërsa një nga studentët raportoi se ka kërkuar rishikim të vlerësimit nga pedagogu. Në rastet e hedhjes së gabuar të notave/notës nga ana e komisionit, në lidhje me vlerësimin e studentit, komisioni ka të drejtë të verifikojë dhe bëjë korrektimin vetëm brenda kohës kur rezultati konsiderohet paraprak (24 orë). Komisioni ka të drejtë të bëjë 1 (një) ndryshim rezultati, pas hedhjes dhe pranimi në sistem. Në raste të jashtëzakonshme mbas këtij afati ligjor (max.7 ditë nga dita e provimit), komisioni i paraqet një kërkesë me shkrim përgjegjësit të Departamentit ku zhvillohet moduli për ndryshimin e notës së pretenduar dhe me miratimin e dekanit të Fakultetit korrigjohet nota në sistem nga IT e fakultetit. Procesverbali i korrigjuar arshivohet në Sekretarinë Mësimore. Mbas hedhjes përfundimtare në sistem të notave, komisioni printon pasqyrën përfundimtare të rezultateve të provimit, i plotëson me firmat e nevojshme (komisionit, përgjegjësit të departamentit /dekanit) dhe e dorëzon tek Sekretaria Mësimore dhe një kopje të tij në Departament. Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; - Takim me studentët.
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Ankimimi parashikohet në nenet 92 të Rregullores së Institucionit, 46 të Rregullores së Njesisë Kryesore dhe neni 32 i Rregullores së Njesisë Bazë. Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të procedurës të zhvillimit të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim drejtuesit të njesisë bazë brenda 24 orëve nga data e zhvillimit të provimit. Drejtuesi i njesisë bazë në bashkëpunim me komisionin e provimit, bejnë korrigjimet e duhura nëse e gjejnë të arsyeshme. Studenti ka të drejtë të ankohet në rast se nuk është dakord me vlerësimin e bërë nga Komisioni i Vlerësimit. Ankesa duhet të depozitohet me shkrim jo më vonë se 24 orë nga shpallja e rezultatit përfundimtar tek drejtuesi i njesisë bazë/shërbimit. Drejtuesi i njesisë bazë bën verifikimet e duhura së bashku me komisionin e provimit dhe nëse vlerëson se ankesa është e drejtë bëjnë korrigjimet e duhura. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë brenda 24 orëve nga përfundimi i afatit të

	ankimimit, dokumentohet dhe vendimi i njoftohet studentit. Studenti ka të drejtë të ankohet në rast se nuk është dakord dhe me vlerësimin e bërë nga njësi bazë. Ankesa duhet të depozitohet me shkrim në sekretarinë e dekanit, brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit. Kjo ankesë shqyrtohet nga dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime drejtuesin e njësisë bazë përkatëse, komisionin e provimit dhe vetë studentin. Dekani merr vendimin përkatës të formës së prerë, brenda 24 orëve nga paraqitja e ankesës. Nuk u raportuan nga stafi akademik dhe studentët raste të tilla. Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.			
Konkluzione	Vlerësimi i studentit mbështetet në vlerësimin vjetor/semestral të punës në auditor, rezultateve të seminareve, rezultateve laboratorike, përgatitjes së detyrave të kursit, praktikave profesionale, etj. UMT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me AADF me qëllim implementimin e projektit CleanScore. Rezultati përfundimtar i kontrollit të dijeve përfshin vlerësimin e të gjithë elementëve të studimit të parashikuar në programin mësimor. Rezultatet e provimit/kolokiumit u bëhen të njohura studentëve nga komisioni në përfundim të provimit me gojë dhe për provimet me shkrim, pas korrigjimit të tyre. Nuk lejohet hyrja në provim e personave të jashtëm. Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e marrë në provim, nëpërmjet ankimimit zyrtar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit MSc. në Fizioterapi është program i Ciklit të dytë të Studimeve që ofrohet në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë. Programi MSc. në Fizioterapi zgjat 2 vite, 4 semestra akademikë me kohë të plotë, me 120 kredite (ECTS) në total. Ky program studimi ka për objektiv t'u japë studentëve aftësi profesionale të avancuara në trajtimin e situatave mjekësore Fizioterapeutike, njohjen në detaje të protokolleve, teknikave dhe metodave rehabilituese të ndryshme më të fundit të trajtimit të pacientëve të të gjitha grupmoshave. Programi i nivelit të dytë (Master i Shkencave) në Fizioterapi ka si qëllim të formojë Fizioterapistë profesionistë me njohuri të thella lidhur me zhvillimin gjuhësor problematikat që prekin gjuhën receptive dhe gjuhën ekspresive gjatë moshës evolutive, si dhe rastet e pacientëve pediatrik apo adult me çrregullime të ndryshme të fituara të të folurit. Ky program ka për qëllim të nxisë kërkimin dhe hulumtimin shkencor në Fizioterapi. Evidenca: - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Evidenca 86. Programi Msc ne Fizioterapi 21-23.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit përfshin lëndën "Shkenca Komunikimi" e cila përmban tre module (Komunikim profesional, Bioetikë dhe Psikologji Shëndeti). Programi i studimit nuk përfshin lëndë në fushën e teknologjisë së informacionit. <i>GVJ sugjeron të përfshihet një modul i tillë në këtë program studimi.</i> Evidenca: - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi; - Evidenca 86. Programi Msc ne Fizioterapi 21-23; - Evidenca 91.2 Plani mesimor Msc Fizio 23-25; - Evidenca 92.1-92.8, Syllabuset e lëndëve.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të	Në përfundim të modulit/lëndës pedagogu/ët respektiv të lëndës/ve u paraqesin studentëve dhe i orientojnë ata mbi çështjet më të rëndësishme si dhe ku të fokusohen për provimin respektiv. Kjo procedurë u konfirmua nga stafi akademik dhe studentët gjatë takimeve të zhvilluara në Institucion. <i>GVJ e konsideron këtë si një praktikë të mirë dhe sugjeron përfshirjen e kësaj procedure në rregulloren e programit të studimit edhe/ose në syllabuset e lëndëve respektive.</i>

rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Evidenca: - Takimi me stafin akademik; - Takimi me studentët.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Studentët për këtë program studimi zhvillojnë leksione, seminare, orë laboratorike si dhe praktikë profesionale. Paralelisht, Institucioni organizon rregullisht leksione të hapura, konferenca, workshope etj. të cilat u japin mundësinë të rrisin dhe të thellojnë njohuritë e tyre. Syllabuset e programit të studimit përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që marrin gjatë zhvillimit të moduleve/lëndëve. Studentët kanë mundësi të aplikojnë njohuritë teorike që marrin gjatë praktikave në spital. Orët e praktikës janë rritur. Studentët raportuan se gjatë leksioneve/seminareve stafi akademik i përfshin ata në diskutime si dhe diskuton çështjet e ndryshme. <i>Mobiliteti i studentëve është i mundur por deri në këtë moment, mobilitetet në IAL jashtë Shqipërisë nuk ka. Kjo është një pikë e dobët mbi të cilën autoritetet drejtuese duhet të punojnë më shumë.</i> Evidenca: - Evidenca 18, Konferenca vjetore libri i abstrakteve_FSHMT; - Evidenca 29, Programi-konferenca-VLORE-2023-tetor-26-27; - Evidenca 30, Konferenca-vjetore-2023-FSHMT-ne-bashkepunim-me-UV-dhe-UIH; - Evidenca 91.2, Plani Mesimor Mp Fizioterapi 23-24;; - Evidenca 154, Analize per aktivitetin kerkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik te UMT; - Takimi me stafin akademik; - Takimi me studentët.
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Stafi akademik organizon rregullisht orë të hapura dhe seminare mbi fushën e programit të studimit MSc. në Fizioterapi. Studentët raportuan se kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme jashtë strukturës së programit të studimi. Këto aktivitete kanë si qëllim informimin e stafit akademik dhe studentëve mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda dhe jashtë vendit. Evidenca:

	<i>Evidenca 154, Analizë për aktivitetin kërkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik te UMT;</i> - <i>Takimi me stafin akademik;</i> - <i>Takimi me studentët.</i>			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Nxitja e studentëve dhe zhvillimi i ideve inovative është një nga pikat kryesore të strategjisë së zhvillimit të UMT. Përmes projekteve të ndryshme, studentët përfshihen në punë kërkimore. <i>Pavarësisht kësaj, nuk u raportua mbështetje financiare e studentëve në këtë fushë.</i> Evidenca: - <i>Evidenca 170, Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024;</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>			
Konkluzione	<i>Programi MSc. në Fizioterapi ka për objektiv t'u japë studentëve aftësi profesionale të avancuara në trajtimin e situatave mjekësore Fizioterapeutike, njohjen në detaje të protokolleve, teknikave dhe metodave rehabilituese të ndryshme më të fundit të trajtimit të pacientëve të të gjitha grupmoshave. Lënda Bioetikë dhe Komunikim Profesional përfshihet në planin mësimor. Programi i studimit nuk përfshin lëndë në fushën e teknologjisë së informacionit. Në përfundim të modulti/lëndës pedagogu/ët respektiv të lëndës/ve u paraqesin studentëve dhe i orjentojnë ata mbi çështjet më të rëndësishme si dhe ku të fokusohen për provimin respektiv. Studentët për këtë program studimi zhvillojnë leksione, seminare, orë laboratorike si dhe praktikë profesionale. Stafi akademik organizon rregullisht orë të hapura dhe seminare mbi fushën e programit të studimit MP. në Fizioterapi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Neni 96 i Rregullores së Institucionit përcakton mënyrat e diplomimit. Studentët në programet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” të studimeve diplomohen me punim diplome (Neni 96 pika 3). Në Rregulloren e Njesisë Kryesore (neni 50, pika 3) përcaktohet se studentët në programet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” të studimeve diplomohen me punim diplome. Neni 42, pika 2c e Rregullores së Njesisë Bazë dhe neni 15 i Rregullores së programit të studimit përcaktojnë se studentët e Masterit të Shkencave diplomohen me punim diplome. Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e UMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Për të fituar diplomën në Master Shkencor në Fizioterapi, studenti duhet të mbrojë me sukses diplomën e përgatitur në bashkëpunim me udhëheqësin e tij/saj. Modalitetet e hulumtimit, hartimit të diplomës, disertacioni dhe mbrojtjes para juris jepen në udhëzues të veçantë në përputhje me aktet e brendshme të institucionit. Për të fituar të drejtën e hyries në mbrojtjen e diplomës, studenti duhet të ketë marrë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët mësimore dhe në praktikë, duke marrë kreditet e nevojshme. Institucion ka hartuar dhe një udhëzues specifik për detyrimet përmbyllëse të studentëve. Evidenca: - Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; - Evidenca 9, Udhëzues për hartimin e temës së diplomës; - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në këtë program studimi, studentët diplomohen me punim diplome dhe jo me provim të përgjithshëm përfundimtar.




Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Një pedagog nuk mund të udhëheqë më shumë se pesë (5) student. Departamenti përcakton listën e temave të diplomave të paktën 6 muaj para përfundimit të studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave. Përcaktimi i temave bëhet në bazë të fushës së studimit që mbulon Njësia Bazë. Pedagogu udhëheqës mbështet dhe orienton studentin në përgatitjen e punimit të diplomës gjatë gjithë kohës deri në momentin e prezantimit. Pedagogu udhëheqës jep dakordësinë e vet për prezantimin e punimit të diplomës para komisionit. Evidenca: - Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; - Evidenca 9, Udhëzues për hartimin e temës së diplomës; - Evidenca 21, Rregullore Msc në Fizioterapi.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Ambjentet e institucionit janë në dispozicion të studentëve për realizimin e diplomës. Kjo u konfirmua dhe në takimet e zhvilluara me drejtuesit e institucionit si dhe me stafin akademik. Evidenca: - Evidenca 117, Lista e laboratoreve didaktike në te 3 Fakultetet – UMT; - Evidenca 118, Infrastruktura në funksion të mesimdhënie, Universiteti i Mjekësisë, Tirane; - Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësive Bazë; - Takim me stafin akademik.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Temat e diplomës dhe provimet e formimit vlerësohen nga i njëjti komision vlerësimi. Komisionet e vlerësimit përbëhen nga të paktën 2 anëtarë, që propozohen nga Departamenti dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit. Për vlerësimin e temave të diplomave, komisionet e vlerësimit konsiderojnë: ➤ punimin e paraqitur në formë të shkruar e të lidhur; ➤ prezantimin e punimit për diplomë nga ana e studentit gjatë mbrojtjes në komision; ➤ përgjigjet e studentit ndaj pyetjeve të komisionit; ➤ vlerësimin e referencës dhe mendimin e udhëheqësit të temës etj.

	Komisioni i vlerësimit, pas mbrojtjes, tërhiqet për të bërë vlerësimin përfundimtar. Komisioni vlerëson studentin në përfundim të prezantimit të punimit të diplomës me notë. Nota përfundimtare llogaritet si mesatare e thjeshtë e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit dhe i bëhet e ditur studentit ditën e mbrojtjes përpara komisionit. Evidenca: - <i>Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ;</i> - <i>Takim me stafin akademik.</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diplomën e programit përkatës si dhe suplementin e diplomës (neni 97 pika 1 e Rregullores së Institucionit). Neni 99 përcakton elementët e diplomës. Neni 50 pika 7 e Rregullores së Njesisë Kryesore dhe neni 45 i Rregullores së Njesisë Bazë, parashikojnë pajisjen e studentëve me diplomën përkatëse si dhe suplementin. Evidenca: - <i>Evidenca 2, Rregullore e UMT;</i> - <i>Evidenca 5, Rregullore FSHMT;</i> - <i>Evidenca 6, Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ.</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Kopje e dokumentacionit të studentit ruhet në bazë të legjislacionit në fuqi. Kopje e këtij dokumentacioni ju paraqit dhe GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore. Evidenca: - <i>Evidenca 2, Rregullore e UMT;</i> - <i>Evidenca 5, Rregullore FSHMT;</i> - <i>Vizita në sekretarinë mësimore.</i>
Konkluzione	Në Rregulloren e Njesisë Kryesore (neni 50, pika 3) përcaktohet se studentët në programet e ciklit të dytë "Mater i Shkencave" të studimeve diplomohen me punim diplome. Për të fituar diplomën në MSc. në Fizioterapi studenti duhet të mbrojë me sukses diplomën e përgatitur në bashkëpunim me udhëheqësin e tij/saj. Departamenti përcakton listën e temave të diplomave të paktën 6 muaj para përfundimit të studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave. Ambjentet e institucionit janë në dispozicion të studentëve për realizimin e diplomës. Komisioni i vlerësimit të punimit të diplomës vlerëson studentin në përfundim me notë. Në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diplomën e programit përkatës si dhe suplementin e

	<i>diplomës. Kopje e dokumentacionit të studentit ruhet në bazë të legjislacionit në fuqi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Jo e aplikueshme pasi nuk është program studimi “Master Profesional”.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Jo e aplikueshme pasi nuk është program studimi “Master Profesional”.
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Jo e aplikueshme pasi nuk është program studimi “Master Profesional”.

Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.						
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve					
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në Fizioterapi përmbush kërkesat ligjore në fuqi, kualifikimin akademik dhe mbulimin e lëndëve të programit me ekspertizën e duhur kërkimore dhe praktike të lidhur me veçorinë e programit të studimit. Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, për tre vitet e fundit akademike janë si në tabelën më poshtë :					
	Stafi akademik i programit të studimit	2021-2022		2022-2023		2023-2024
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE
	Prof. Dr	0	0	0	0	2
	Prof. Asoc.	5	0	7	0	7
	Dr/Phd	7	4	5	4	4
	Msc.	2	9	1	9	2
	Gjithsej	14	13	13	13	15

	Fusha përkatëse, kualifikimet dhe zhvillimi akademik janë të faktuara nga CV-të e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit në zyrën e burimeve njerëzore. Evidenca: - Evidenca 97, Tabelat 6.1,6.2,6.3 aneks tabelat përmbledhëse (Aneksset ASCAL); - Evidenca 179, Të dhëna statistikore për personelin akademik PAE, PAK, administrativ 2017-2022 UMT; - Evidenca 57, Lista e titujve akademik Profesor dhe Profesor i Asociuar 2020-2022; - Evidenca 91, Plani Mësimor Msc. Fizioterapi; - Evidenca 92, Syllabuset e Lëndëve Msc. Fizioterapi; - Vizita në Institucion dhe takimi me drejtuesin e departamentit dhe stafin akademik; - Takimi me përfaqësues të zyrës së Burimeve njerëzore.															
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Personeli akademik efektiv (PAE) i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në Fizioterapi bazuar në dokumentat e dorëzuara dhe takimet në institucion mbulon ngarkesën mësimore mesatarisht në masën 43% dhe 57%. e ngarkesës mësimore mbulohet nga personel akademik me kohë të pjesëshme dhe i ftuar (PAK). Personeli akademik i angazhuar si me kohë të plotë dhe të pjesshme është i kualifikuar në përputhje me fushën e programit të studimit, natyrën dhe specifikat e lëndëve/moduleve. Pranë drejtuesit të departamentit, pedagogët dorëzojnë dhe miratojnë programet mësimore për modulet që do të mbulojnë. CV-të e personelit akademik të angazhuar faktojnë se fusha e tyre e ekspertizës dhe kërkimit përputhen plotësisht me natyrën e moduleve që mbulojnë në programin e studimit Master i Shkencave në Fizioterapi. Ngarkesa e orëve mësimore e stafit akademik PAE dhe PAK për programin e studimit është si më poshtë: <table><tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr><tr><td>2021-2022</td><td>1210</td><td>489</td><td>721</td><td>40.4% / 59.6%</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>1210</td><td>515</td><td>695</td><td>42.5% / 57.5%</td></tr></table>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2021-2022	1210	489	721	40.4% / 59.6%	2022-2023	1210	515	695	42.5% / 57.5%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)												
2021-2022	1210	489	721	40.4% / 59.6%												
2022-2023	1210	515	695	42.5% / 57.5%												

	2023-2024	1210	515	695	42.5% / 57.5%
	Ngarkesa e orëve mësimore në të tre vitet e fundit akademike, nuk mbulohet nga personeli akademik efektiv në masën e kërkuar mbi 70%, sipas ligjit në fuqi. Evidenca: - Evidenca 97, Tabelat 12.1, 12.2, 12.3 aneks tabelat përmbledhëse (Aneksset ASCAL). - Evidenca 97, Tabelat me statistikat përmbledhëse (Aneksset ASCAL); - Evidenca 154, Ndërfaqe ASCAL; - Evidenca 96, CV-të e personelit akademik të angazhuar në Msc. Fizioterapi; - Evidenca 91, Plani mësimor Msc. Fizioterapi; - Evidenca 92, Syllabuset e lëndëve Msc. Fizioterapi; - Evidenca 164, Praktika për planifikimin dhe realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik; - Evidenca 175, Praktikë për punësimin e personelit administrativ; - Evidenca 176, Procedura e personelit akademik, ndihmës administrativ UMT; - Takim me stafin akademik, drejtuesin e departamentit DDRSHIKIOGJ.				
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Qëndrueshmëria e personelit efektiv të angazhuar në programin e studimit është pjesë e politikave të vazhdueshme të institucionit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet gjatë vizitës institucionale u konstatua se shumica e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në Fizioterapi kanë nisur karrierën e tyre në këtë fakultet dhe kanë avancuar në karrierën e tyre falë politikave mbështetëse të institucionit për promovimin e stafit akademik, ku 90% e stafit akademik të angazhuar janë me grada dhe tituj (doktor i shkencave, profesor i asociuar dhe profesor doktor). Rekrutimi i stafit akademik kryhet në bazë të një rregullore të miratur dhe nënshkrimi i kontratës së punës, efektiv me kontratë dhe afat të pacaktuar është garancia për plotësimin e këtij kriteri. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit ka mbështetje të gjerë institucionale e reflektuar në lirinë				

	akademike, mbështetjen logjistike, shëndetësore dhe sociale, lirinë e veprimit dhe në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale. Evidenca: - Evidenca 97, Tabelat me statistikat përmbledhëse (Anekset_ASCAL); - Evidenca 171, Model kontrate personel administrativ; - Evidenca 172, Model kontrate personel ndihmës akademik; - Evidenca 173, Model kontrate pedagogët e jashtëm; - Evidenca 174, Model kontrate personel akademik; - Evidenca 175, Praktikë për punësimin e personelit administrativ; - Evidenca 176, Procedurat e punësimit të personelit akademik, ndihmës, administrativ UMT; - Evidenca 177, Praktikë e punësimit të personelit akademik në UMT; - Evidenca 169, Shembull Vlerësimi i performancës së stafit administrativ; - Evidenca 170, Formular raporti për realizimin e veprimtarisë akademike; - Evidenca 171, Model kontrate personel administrativ; - Vizita në Institucion, takimi me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe stafin akademik.
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi bazuar në kriteret të përgjithshme dhe specifike në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Marrje e informacionit në lidhje me procedura për rekrutimin e stafit nga takimet me drejtuesit e departamenteve dhe dekanen gjatë vizitës institucionale konstatoi se përzgjedhja e personelit akademik kryhet me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Zyra e Burimeve Njerëzore, është njësi që administrohen të gjithë të dhënat mbi personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Çdo anëtar i personelit akademik ka dosjen e vetë personale në Zyrën e Burimeve Njerëzore e cila përditësohet në mënyrë periodike, kryesisht në fillim të çdo viti akademik. Formatit për plotësimin e dosjes së personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ të

	institucionit është standard për të gjithë stafin e angazhuar në programin e studimit. Evidenca: - Evidenca 117, Analizë vjetore Zyra e Burimeve Njerëzore; - Evidenca 175, Praktikë për punësimin e personelit administrativ; - Evidenca 176, Procedurat e punësimit të personelit akademik, ndihmës, administrativ UMT; - Evidenca 177, Praktikë e punësimit të personelit akademik në UMT; - Evidenca 169, Shembull Vlerësimi i performancës së stafit administrativ; - Evidenca 170, Formular raporti për realizimin e veprimtarisë akademike; - Evidenca 171, Model kontrate personel administrativ; - Vizita në Institucion, takimi me dekanen, drejtuesit e departamenteve, dhe me përfaqësues së Zyrës së Burimeve Njerëzore.
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	FSHMT në departamentin DRSHIKIOGJ, përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në Fizioterapi përveç personelit akademik të angazhuar në programet e studimit që ofron, ka të angazhuar edhe personel ndihmës akademik të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike. Në total në institucion janë të angazhuar 260 personel akademik me kohë të pjesshme. Rreth 38% e personelit akademik me kohë të pjesshme janë të punësuar me kohë të plotë në Struktura Shëndetësore Universitare dhe rreth 20% e personelit akademik me kohë të pjesshme janë të punësuar me kohë të plotë në Struktura të tjera Shëndetësore Jo - Universitare, si Poliklinika, Qendra e Zhvillimit dhe Mirëritjes së Fëmijëve, Instituti i Fëmijëve që nuk dëgjojnë, Sisteme shëndetësore private, spitale, klinika, kabinete, laboratore. Në total 58% e personelit akademik me kohë të pjesshme të angazhuar në institucion është i punësuar në strukturat shëndetësore. Personeli ndihmës akademik që angazhohet në veprimtaritë laboratorike, ka kualifikimet dhe kompetencën për të zhvilluar me cilësi të lartë lëndët dhe modulet e programit të studimit. Ata angazhohen për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, që lidhen me

	programin e studimit Master i Shkencave në Fizioterapi. Gjatë takimit me stafin ndihmës akademik në institucion, u evidentua se ai kishte një rol aktiv në mbështetjen e studentëve dhe stafit akademik në realizimin e orëve laboratorike eficiente për parapërgatitjen e studentëve për mjediset e kujdesit klinik. <i>GVJ e konsideron këtë praktikë si shembull të praktikës së mirë.</i> Evidenca: - Evidenca 97, Tabelat me statistikat përmbledhëse (Anekset ASCAL); - Evidenca 79, Raport vjetor UMT 2021,2022,2023; - Evidenca 80, Raport vjetor FSHMT 2020-2021; - Evidenca 81, Raport vjetor FSHMT 2021-2022; - Evidenca 82, Raport vjetor FSHMT 2022-2023; - Takimi në institucion me stafin ndihmës akademik, akademik, studentët dhe vizitat te laboratorët.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Struktura përgjegjëse institucionale që mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programet e studimit që ky institucion ofron përfshirë dhe programin e studimit Master i Shkencave në Fizioterapi është Zyra e Burimeve Njerëzore. Përmbajtja e dosjes së secilit anëtar të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit është e dokumentuar dhe organizuar në bazë të udhëzimit përkatës. Në dosje dokumentohet dhe ruhet informacioni personal, por edhe të dhëna në lidhje me aktivitetin mësimor dhe kërkimor të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Edhe Departamenti ka një dosje të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, ku ruhen të dhënat personale të anëtarit të stafit akademik si dhe të dhëna mbi angazhimin/ngarkesën e tyre në çdo semestër dhe vit akademik. Të dhënat e dorëzuara nga stafi akademik kryesisht ato që lidhen me angazhimet, kualifikimet dhe veprimtarinë kërkimore shkencore përbëjnë dhe bazën për hartimin e raportit vjetor instiucional në kuadër të vlerësimit periodik të performancës dhe vetëvlerësimit për procese të ndryshme. Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e Universitetit të Mjekësisë; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 169, Shembull Vlerësimi i performancës së stafit administrativ;

	- Evidenca 170, Formular raporti për realizimin e veprimtarisë akademike; - Evidenca 117, Analizë vjetore Zyra e burimeve njerëzore - Evidenca 79, Raport vjetor UMT 2021,2022,2023; - Evidenca 80, Raport vjetor FSHMT 2020-2021; - Evidenca 81, Raport vjetor FSHMT 2021-2022; - Evidenca 82, Raport vjetor FSHMT 2022-2023; - Vizita në Institucion.
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	UMT dhe FSHMT, kanë marrëveshje bashkëpunimi të gjera me institucione të kujdesit klinik, përfshirë spitale dhe qendra shëndetësore, për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve të masterit shencor në praktikën profesionale angazhojnë personel akademik që ka eksperiencë disavjeçare në fizioterapi. Pozicioni gjeografik i institucionit mundëson kryerjen e praktikave profesionale në mjediset e QSUT por edhe në laboratorët e institucionit dhe shërbimet universitare të fizioterapisë dhe në institucione të tjera me të cilët institucioni bashkëpunon. Në klinikat e fizioterapisë me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi është caktuar personeli i duhur, i kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale në institucionin e tyre por edhe ndërmarrjen e studimeve të nevojshme për punimin e diplomës. Personeli akademik ka një rol shumë aktiv në këtë proces pasi shumica prej tyre janë personel shëndetësor në këto klinika dhe PAK ose mbikqyrës klinik në programin Master i Shkencave në Fizioterapi. Duke qënë se <i>udhëheqësit e praktikave janë personel i ambjenteve klinike, kjo është një garanci më shumë e shfrytëzimit të orëve praktike me efikasitet në të mësuar nga ana e studentëve të programit të studimit, si dhe përballjen me raste reale klinike për menaxhim. Studentët nëpërmjet zhvillimit të praktikave në këto klinika kanë mundësinë të aftësohen profesionalisht, të kenë akses në të dhëna dhe pacientë që u nevojiten për punimin e diplomës, por edhe të njihen paraprakisht me tregun e punës pasi një pjesë e tyre edhe janë të punësuar me kohë të pjessëshme në këto klinika, duke siguruar integrim më të shpejt me tregun e punës. Shembull i praktikës së mirë.</i> Evidenca: - Evidenca 101, Lista e projekteve ndërkombetare të aplikuar dhe të fituara;

	- Evidenca 102, Lista e projekteve kombëtare të aplikuara dhe të fituara; - Evidenca 103, Memorandume bashkëpunimi UMT me MShMS 2019,2021; - Evidenca 104, Shembull Marrëveshje për diploma të përbashkëta, Universiteti Bologna; - Evidenca 105, Shembull marrëveshje bashkëpunimi me IAL ndërkombëtare, Univiversiteti Tor Vergata Rome; - Evidenca 106, Lista e bashkëpunime me IAL kombëtare, nderkombëtare dhe institucione të tjera; - Evidenca 107, Lista e bashkëpunime me institucione të tjera, FSHMT; - Vizita në Institucion, takimet me stafin dhe studentët.
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Mbikqyrja e praktikave profesionale realizohet nga personeli akademik i FSHMT ose mbikqyrësi klinik që është personel akademik me kohë të pjesshme por që njëkohësisht është edhe pjesë e shërbimeve ku do të kryhet praktika profesionale. Shpërndarja e praktikës profesionale në shërbimin e QSUT apo institucionet e tjera kryhet nga përgjegjësi i departamentit. Evidenca: - Evidenca 13, Ditari i praktikës profesionale bachelor, FSHMT; - Evidenca 128, Shembull Udhëzues i praktikës profesionale MP. Infermieri Familje, FSHMT; - Evidenca 11; Praktikë për miratimin e planeve mësimore; - Vizita në Institucion, takimet me studentët dhe stafin.
Konkluzione	Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në Fizioterapi, përbush standardet dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit të studimit. Staf akademik i angazhuar është me grada dhe tituj (Prof. Dr., Prof. Asoc., Dr/Phd), stafi ndihmës akademik ka një rol aktiv në mbështetjen e studentëve dhe stafit akademik në realizimin e orëve laboratorike eficiente ndërkohë që udhëheqësit e praktikave janë personel i ambjentëve klinike. Kjo gjë garanton shfrytëzim të orëve praktike me efikasitet në të mësuar dhe përballjen me raste reale klinike për menaxhim nga ana e studentëve. Ngarkesa e orëve mësimore nuk mbulohet nga stafi akademik PAE në masën e

	<i>kërkuar nga kuadri ligjor në fuqi. Për këtë rekomandohet që institucioni të marri masa në adresimin e këtij kriteri.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	FSHMT disponon dy godina ku ofrohen programet e studimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit për infrastrukturën mësimore dhe vizita institucionale, evidentohet se institucioni disponon infrastrukturën e nevojshme të pajisur me didaktikën e duhur për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve dhe specifikën për çdo program studimi. Aktiviteti akademik për programin Master i Shkencave në Fizioterapi zhvillohet pasdite. Studentët kishin mundësi të zhvillonin edhe veprimtari të tjera në mbështetje të mësimdhënies si leksione të hapura, workshope, konferenca, punë në grup në ambientet e bibliotekës dhe sallës së leximit. Biblioteka ishte e vendosur në katin e pestë të godinës, e hapur nga ora 8.00 deri në orën 18.00 me akses në internet. Institucioni dispononte dhe një sallë leksionesh me kapacitet 250 veta që ishte gjithashtu në funksion të mësimdhënies. Në mbështetje të procesit akademik janë edhe zyra e shërbimit informatik (IT), arkiva si dhe zyra e informacionit që janë në shërbim të studentëve dhe gjithë të interesuarve. <i>Tabela e të dhënave për infrastrukturën në funksion të programeve të studimit, evidenton se ky kriter përmbushet plotësisht nga institucioni.</i> <table><tr><th>Numri i sallave të leksioneve</th><th>Numri i sallave seminar</th><th>Numri i lab</th><th>Biblioteka, sala leximi</th><th>Zyra për PAKPp, PAKP</th><th>Zyra për administratën</th></tr><tr><td>25</td><td>15</td><td>12</td><td>1</td><td>14</td><td>24</td></tr></table> Evidenca: - Evidenca 79, Raport vjetor UMT 2021,2022,2023; - Evidenca 80, Raport vjetor FSHMT 2020-2021; - Evidenca 81, Raport vjetor FSHMT 2021-2022;	Numri i sallave të leksioneve	Numri i sallave seminar	Numri i lab	Biblioteka, sala leximi	Zyra për PAKPp, PAKP	Zyra për administratën	25	15	12	1	14	24
Numri i sallave të leksioneve	Numri i sallave seminar	Numri i lab	Biblioteka, sala leximi	Zyra për PAKPp, PAKP	Zyra për administratën								
25	15	12	1	14	24								

	- Evidenca 82, Raport vjetor FSHMT 2022-2023; - Evidenca 90, Të dhëna për zhvillimin e infrastrukturës dhe investimet; - Evidenca 124, Infrastruktura në funksion të mësimdhënies, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë; - Evidenca 125, Lista e aseteve infrastrukturore të UMT dhe planimetritë; - Vizita në institucion.																														
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Aktiviteti mësimdhënës dhe kërkimor shkencor i FSHMT kryhet kryesisht në dy godinat e fakultetit. Këto godina kanë mjedise bashkëkohore dhe të mjaftueshme, të cilat janë rikonstruktuar vazhdimisht duke mundësuar paisje me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik të programit të studimit Master i Shkencave në Fizioterapi, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. <table><tr><th>Godina 1 FSHMT</th><th>Auditorë</th><th>Salla seminari</th><th>Laboratorë</th><th>Zyra administrative</th></tr><tr><td>Numri</td><td>6</td><td>10</td><td>4</td><td>15</td></tr><tr><td>Kapacitet (vende)</td><td>330</td><td>50</td><td>30</td><td></td></tr><tr><th>Godina 2 FSHMT</th><th>Auditorë</th><th>Salla seminari</th><th>Laboratorë</th><th>Zyra administrative</th></tr><tr><td>Numri</td><td>11</td><td>14</td><td>3</td><td>21</td></tr><tr><td>Kapacitet (vende)</td><td>780</td><td>50</td><td>70</td><td></td></tr></table> Fakulteti mbështet personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ me mjete audiovizive të instaluar dhe portabël, printera, fotokopje, materiale kancelarie në dispozicion të mësimdhënies e faktuar nga dokumentacionet por edhe bisedat me studentët dhe stafin akademik për mënyrën e zhvillimit të mësimdhënies me kontribut në mësimdhënie cilësore dhe në aftësim të mendimit kritik te studentët. Evidenca: - Evidenca 82, Raport vjetor FSHMT 2022-2023; - Evidenca 90, Të dhëna për zhvillimin e infrastrukturës dhe investimet; - Evidenca 124, Infrastruktura në funksion të mësimdhënies, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë;	Godina 1 FSHMT	Auditorë	Salla seminari	Laboratorë	Zyra administrative	Numri	6	10	4	15	Kapacitet (vende)	330	50	30		Godina 2 FSHMT	Auditorë	Salla seminari	Laboratorë	Zyra administrative	Numri	11	14	3	21	Kapacitet (vende)	780	50	70	
Godina 1 FSHMT	Auditorë	Salla seminari	Laboratorë	Zyra administrative																											
Numri	6	10	4	15																											
Kapacitet (vende)	330	50	30																												
Godina 2 FSHMT	Auditorë	Salla seminari	Laboratorë	Zyra administrative																											
Numri	11	14	3	21																											
Kapacitet (vende)	780	50	70																												

	- Evidenca 125, Lista e asetëve infrastrukturore të UMT dhe planimetritë; - Evidenca 38, Laboratori i Fizioterapisë; - Vizita dhe takimet në institucion.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	UMT dispononte infrastrukturën laboratorike dhe praktike dhe mjedise të tjera të të mësuarit të cilat janë të pajisura me aparaturat dhe mjetet e nevojshme në përputhje me specifikën dhe misionin e këtij institucioni. FSHMT si njësi kryesore përgjegjëse që ofron programin e studimit Master i Shkencave në Fizioterapi disponon laboratorët e duhur për aftësimin teorik dhe praktik të studentëve që ndjekin këtë program studimi. Përveç laboratorit të dedikuar të Fizioterapisë digjitale në funksion të programit të studimit janë edhe laboratorët e infermierisë, përfshirë laboratorin simulator, por dhe laboratorët specifik për programin si laborator i anatomisë radiologjike dhe laborator i ekografisë. Vizita në institucion dhe takimet konstatuan se këta laboratorë kishin një infrastrukturë dhe logjistikë bashkëkohore me kontribut cilësor në përmbushjen e objektivave praktikë dhe formues të programit Master i Shkencave në Fizioterapi. Investimet në infrastrukturën laboratorike ishin bërë nga vetë institucioni, por kjo infrastrukturë ishte zgjeruar e pasuruar me 10 laboratorë modern edhe falë bashkëpunimeve, projekteve dhe donacioneve të ndryshme. Evidenca: - Evidenca 79, Raport vjetor UMT 2021,2022,2023; - Evidenca 80, Raport vjetor FSHMT 2020-2021; - Evidenca 81, Raport vjetor FSHMT 2021-2022; - Evidenca 82, Raport vjetor FSHMT 2022-2023; - Evidenca 90, Të dhëna për zhvillimin e infrastrukturës dhe investimet; - Evidenca 124, Infrastruktura në funksion të mësimdhënies, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë; - Evidenca 125, Lista e asetëve infrastrukturore të UMT dhe planimetritë; - Evidenca 123, Lista e laboratoreve didaktike në të 3 Fakultetet – UMT; - Evidenca 38, Shembull Propozim projekti Laboratori Imazherisë Dixhitale 23; - Vizita dhe takimet në institucion.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së	FSHMT disponon një laborator të dedikuar për programet e studimit në Fizioterapi përfshirë dhe programin Master i Shkencave në Fizioterapi. Ky laborator i emërtuar ndryshe edhe si kabineti i Fizioterapisë ishte i

paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	pajisuar me kompjutera profesional të cilat kishin të integruar programe profesionale që mundësonin vizualizimin dhe përpunimin e imazheve mjekësore të lidhura me specifikën e programit. Laboratori i Fizioterapisë dispononte mjetet e duhura specifike për realizimin e programit mësimor si videoprojektor, topa rehabilitimi, krevate të rehabilitimit, kompjuter, pasqyrë për bustin, peshore, shkallë suedeze, tapete të gomuar etj. Edhe laboratorët e tjerë që shfrytëzoheshin nga studentët e programit të studimit dispononin logjistikën e duhur dhe teknologjinë për zhvillim të mësimit me metoda bashkëkohore. Në funksion të studentëve dhe stafit janë edhe 8 salla informatike me kapacitet prej 200 kompjutera tavoline. Në të gjithë mjediset e FSHMT ishte i mundur akses i falas në internet dhe wifi mbulonte të gjithë mjediset e institucionit duke mundësuar aksesimin në database me literaturë elektronike në funksion të programit dhe jo vetëm për të gjithë studentët dhe stafin si akademik dhe administrativ. Evidenca: - Evidenca 90, Të dhëna për zhvillimin e infrastrukturës dhe investimet; - Evidenca 124, Infrastruktura në funksion të mësimdhënies, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë; - Evidenca 125, Lista e aseteve infrastrukturore të UMT dhe planimetritë; - Evidenca 151, UMED google education.ipg; - Evidenca 152, Pr.sc Ndërfaqe EasyWeb (për lëndën).pdf; - Evidenca 154, Ndërfaqe ASCAL; - Evidenca 155, Pr.sc të shërbimeve të RASH.pdf; - Evidenca 156, Ndërfaqe web UMT.pdf; - Vizita dhe takimet në institucion.
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të	Institucioni disponon kapacitetet dhe mjediset e duhura për kryerjen e praktikave profesionale të programit të studimit Master i Shkencave në Fizioterapi. Këto kapacitete përfshijnë kabinetet dhe laboratorët e vetë institucionit por edhe shërbimet universitare të fizioterapisë në QSUT dhe institucione të tjera me të cilët institucioni bashkëpunon si SUT, neurologjinë, sëmundjet e brendshme, poliklinika, pediatria. Bashkëpunimet përfshijnë edhe zhvillimin e praktikave profesionale në klinika rehabilituese të cilat instruktojnë, udhëheqin dhe mbikëqyrin studentët në praktikën profesionale në institucionin e tyre nëpërmjet caktimit të personelit të duhur të kualifikuar për drejtim të studentëve në këtë proces.

bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Evidenca: - Evidenca 101, Lista e projekteve ndërkombetare të aplikuara dhe të fituar; - Evidenca 102, Lista e projekteve kombëtare të aplikuara dhe të fituar; - Evidenca 103, Memorandume bashkëpunimi UMT me MShMS 2019, 2021; - Evidenca 104, Shembull Marrëveshje për diploma të përbashkëta-Universiteti Bologna; - Evidenca 105, Shembull marrëveshje bashkëpunimi me IAL ndërkombetare – Universiteti Tor Vergata Romë; - Evidenca 106, Lista e bashkëpunime me IAL kombëtare, ndërkombëtare dhe institucione të tjera; - Evidenca 107, Lista e bashkëpunimeve me institucione të tjera, FSHMT; - Evidenca 118, Listë e Shërbimeve të QSUT; - Vizita dhe takimet në institucion.			
Konkluzione	FSHMT për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit Master i Shkencave në Fizioterapi ka vënë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e nevojshme të përshtatshme. Mjediset mësimore, laboratorike dhe sallat e leximit të pajisura me infrastrukturën e nevojshme dhe teknologjinë e informacionit u sigurojnë studentëve formim praktikë specifik me natyrën e programit duke u dhënë baza të forta praktike që u mundëson integrim më të lehtë në mjediset e kujdesit klinik. Marrëveshjet e bashkëpunimit me klinikat e fizioterapisë dhe kryerja e praktikës profesionale në shërbimet spitalore universitare të fizioterapisë është një vlerë e shtuar në zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike për studentët që ndjekin këtë program studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Në dispozicion të studentëve që ndjekin programin e studimit Master i Shkencave në Fizioterapi, institucioni ka vendosur literaturë bazë që përditësohet periodikisht nga titullarët e lëndëve. Literatura bazë fizike sigurohet nga ciklet e leksioneve të përgatitura dhe përditësuara nga titullarët e lëndëve si dhe tekste të hartuara nga stafi akademik që janë miratuar para përdorimit dhe vënies në dispozicion studentëve. Nëpërmjet platformës elektronike të UMT, apo Google classroom studentëve u vihet në dispozicion edhe kopje elektronike e materialeve didaktikore si cikël leksionesh, prezantime, materiale shtesë, të cilat garantojnë dhënien e njohurive shtesë dhe të nevojshme për studentët. Evidenca: - Evidenca 119, Biblioteka FSHMT; - Evidenca 120, Bibliotekat online - lista dhe përshkrim; - Evidenca 121, Komunikimi zyrtar për U-Library; - Evidenca 23, Shembull_ndërfaqe_Googleclassroom; - Evidenca 24, Udhëzues biblioteka online; - Evidenca 151, UMED google education.jpg; - Evidenca 152, Pr.sc Ndërfaqe EasyWeb (për lëndën).pdf; - Evidenca 156, Ndërfaqe web UMT.pdf; - Vizita dhe takimet në institucion.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	Departamenti DDRSHIKIOGJ, përgjegjës për ofrimin e programit të studimit Master i Shkencave në Fizioterapi kryen çdo fillim viti akademik përditësimin e syllabuseve të lëndëve ku përfshihet literaturë bazë e detyrueshme dhe ndihmëse kryesisht e 5 viteve të fundit, bazuar dhe në udhëzimin Nr. 41 të MAS. Drejtuesi i departamentit e fillon dhe drejton vetë këtë proces me qëllim sigurimin e literaturës bashkohore në përputhje me specifikën e programit. <i>U evidentua se në programin Master i Shkencave në Fizioterapi në 3 vitet e fundit nuk janë bërë ndryshime të planit mësimor.</i> Evidenca: - Evidenca 178, Praktika për planifikimin dhe realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik; - Evidenca 91, Planit mësimor MSc. Fizioterapi; - Evidenca 92, Syllabuset e lëndëve Mcs. Fizioterapi;

	- Vizita dhe takimet në institucion me stafin akademik dhe drejtuesin e departamentit DDRSHIKIOGJ.
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Studentët që ndjekin programin e studimit MSc. në Fizioterapi kanë në dispozicion bibliotekën mësimore të fakultetit dhe bibliotekën qendrore të UMT. Biblioteka qendrore disponon një numër vëllimesh prej 53,000 libra dhe revista shkencore 18,000 koleksione. Disertacionet, botimet shkencore dhe tekstet mësimore të personelit akademik të institucionit ruhen në Bibliotekën qendrore. Biblioteka e FSHMT disponon kryesisht literaturë mësimore bazë dhe ndihmëse, si dhe literaturë shkencore të fushave përkatëse sipas specifikave të programeve të studimit që ofron. Bibliotekat janë të shfrytëzueshme dhe të aksesueshme në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët pa dallim. Ato përfshijnë një gamë të gjerë tekstesh, botime, dizertacione si në formatin digjital dhe fizik. Tekstet mësimore të hartuara nga stafi akademik, marrin miratim për përdorim nga Këshilli Botues i UMT, organ kolegjal dhe që më pas janë pjesë e fondit të bibliotekës duke garantuar aksesin e literaturës mësimore për të gjithë studentët. Studentët dhe stafi akademik kanë mundësi të botojnë falas në revistën shkencore të fakultetit. Botimet shkencore të publikuara në revistat shkencore të institucionit janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit. Biblioteka në përputhje me normat ligjore në fuqi, është struktura përgjegjëse që siguron, mirëmban dhe mundëson shfrytëzimin e literaturës nga studentët. Evidenca: - Evidenca 24, Udhëzues biblioteka online; - Evidenca 119, Biblioteka FSHMT; - Evidenca 120, Bibliotekat online - lista dhe përshkrim; - Evidenca 121, Komunikimi zyrtar për U-Library; - Evidenca 23, Shembull_ndërfaqe_Googleclassroom; - Evidenca 151, UMED google education.jpg; - Evidenca 152, Pr.sc Ndërfaqe EasyWeb (për lëndën).pdf; - Evidenca 156, Ndërfaqe web UMT.pdf; - Evidenca 10, Revista shkencore e FSHMT 2022-2023; - Evidenca 166, Lista e botimeve të revistës shkencore të FSHMT;

	- Evidenca 201, Rregullore mbi botimet mësimore shkencore në Universitetin e Mjekësisë Tiranë; - Evidenca 202, Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Botimeve UMT VSA nr. 42-datë-29.04.2022; - Evidenca, Shembull miratim teksti (dokumentacion shtesë pas vizitës institucionale); - Vizita në institucion.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Institucioni përvec fondit fizik me 53.000 libra dhe revista shkencore si dhe 18.000 koleksione tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, në dispozicion të studentëve në bibliotekën qendrore ka vendosur edhe bibliotekën digjitale https://ulibrary.rash.al/. Kjo u mundëson studentëve konsultim të literaturës specifike për programin dhe jo vetëm. Biblioteka e fakultetit shërbente kryesisht si sallë leximi për shfletimin e literaturës për studentët dhe profesionistët si në formatin fizik por edhe atë elektronik. Gjithashtu, kjo bibliotekë ofron mundësi kërkimi të informacionit online, nëpërmjet kompjuterëve të sallës së leximit. Çdo studentë dhe profesionistë akseson falas në bibliotekë pas paraqitjes së dokumentacionit të duhur, hapjes së kartelës së regjistrimit dhe pajisjes me librezë anëtarësimi. Evidenca: - Evidenca 10, Revista shkencore e FSHMT 2022-2023; - Evidenca 166, Lista e botimeve të revistës shkencore të FSHMT; - Vizita në bibliotekë dhe takimet në institucion.
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Aksesi në biblioteka si fizik dhe online në FSHMT apo UMT mundësohej në mënyrë të barabartë e pa pagesë nga studentët e të gjitha programeve të studimit përfshirë dhe studentët e programit MSc. në Fizioterapi. Çdo studenti, pa asnjë dallim nëpërmjet anëtarësimit falas në bibliotekë i sigurohet mundësia e shfrytëzimit të sallave të leximit dhe aksesit falas i bibliotekave online prestigjioze të shkencave mjekësore si Hinari, Telemedicina, Albanian Health foundation etj. Institucioni si pjesë e U-Library të vënë në dispozicion nga RASH u mundëson studentëve aksesimin falas të literaturës së dëshiruar nga salla e bibliotekës dhe online në çdo kohë.

	Mundësia për të aksesuar online dhe pa pagesë në baza të dhënash mjekësore të indeksuara konsiderohet nga GVJ si shembull i praktikës e mirë. Evidenca: - Evidenca 24, Udhëzues biblioteka online; - Evidenca 119, Biblioteka FSHMT; - Evidenca 120, Bibliotekat online - lista dhe përshkrim; - Evidenca 121, Komunikimi zyrtar për U-Library; - Evidenca 23, Shembull_ndërfaqe_Googleclassroom; - Evidenca 151, UMED google education.jpg; - Evidenca 156, Ndërfaqe web UMT.pdf; - Evidenca 10, Revista shkencore e FSHMT 2022-2023; - Evidenca 166, Lista e botimeve të revistes shkencore të FSHMT; - Evidenca 201, Rregullore mbi botimet mësimore shkencore në Universitetin e Mjekësisë Tiranë; - Evidenca URL të bibliotekave online; - Vizita në Institucion dhe takimi me studentët.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka e FSHMT është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. Ajo ka një sipërfaqe prej 400 m² dhe 138 vende leximi si dhe një fond prej 164 botime në gjuhë të huaj si dhe një sërë botimesh në gjuhën shqipe. Në këtë bibliotekë studentët kishin mundësi të konsultonin edhe punimet e temave master të bashkëmoshatarëve të tyre si dhe shfrytëzonin mjedisin edhe për organizim të aktiviteteve të tjera në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Evidenca: - Evidenca 113, Biblioteka FSHMT; - Evidenca 114, Bibliotekat online - lista dhe përshkrim; - Evidenca 121, Komunikimi zyrtar për U-Library; - Vizita në Institucion në mjediset e bibliotekës dhe takimi me studentët.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit	Biblioteka e FSHMT vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, nga ora 8.00-18.00. Ambienti i bibliotekës dhe sallës së leximit është vendosur në katin e pestë të institucionit dhe ka akses në internet falas në cdo kohë. Ajo është e pajisur me

mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	tavolina dhe kompjutera që janë në dispozicion të studentëve për literaturë bazë dhe suplementare fizike dhe digjitale. Nga takimet me studentët, u raportua se ata në mjediset e bibliotekës mund të organizonin takime dhe zhvillonin diskutime në funksion të projekteve të ndryshme, diskutonin për temat e diplomës apo detyrat e kursit. Evidenca: - Evidenca 119, Biblioteka FSHMT; - Evidenca 24, Udhëzues biblioteka online; - Evidenca 120, Bibliotekat online - lista dhe përshkrim; - Evidenca 121, Komunikimi zyrtar për U-Library; - Vizita në mjediset e bibliotekës dhe takimi me studentët.
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Cilësia e fondit fizik dhe online i bibliotekës janë në monitorim të vazhdueshëm si nga njësitë përgjegjëse të programit dhe vetë bibliotekës. Institucioni ka orientuar investimet e veta në formatin online në respekt të ambjentit por edhe aksesit në çdo kohë, duke përmirësuar vazhdimisht fondin digjital të bibliotekës me blerje të botimeve të reja apo aksesime në database të rëndësishme dhe specifike në bazë të kërkesave të personelit akademik dhe studentëve të programeve të studimit. Fondi fizik dhe online i bibliotekës përditësohet vazhdimisht me literaturë të viteve të fundit bazuar në kërkesat individuale të pedagogëve dhe studentëve. Pasurimi i bibliotekës zë një vend të veçantë edhe në projekt buxhetin e fakultetit. Evidenca: - Evidenca 52, Praktikë për miratimin e buxhetit vjetor UMT; - Evidenca 88, Të dhëna Fianciare për alokim buxheti FSHMT (3 vite) ; - Evidenca 110, Praktikë për miratimin e buxhetit vjetor UMT; - Evidenca 111, Procedura për miratimin e buxhetit vjetor; - Evidenca 112, Procedura e hartimit të projekt buxhetit afatmesëm; - Evidenca 119, Biblioteka FSHMT; - Vizita në ambjentet e bibliotekës dhe takimet me studentët dhe stafin akademik.

Konkluzione	GVJ konstaton se institucioni ka vendosur në dispozicion të programit të studimit MSc. në Fizioterapi literaturën e nevojshme të përditësuar si fizike dhe online që mbështet mësimdhënien. Mjediset mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekat janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme digjitale për aksesimin falas të literaturës nga të gjithë studentët por edhe në shfrytëzimin e këtyre mjediseve nga ana e tyre për zhvillimin e aktiviteteve mbështetëse të mësimdhënies dhe mësimnxënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UMT-FSHMT disponon sistem të menaxhimit, konkretisht platformën Easy - Web me funksione të shumëfishta, nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, përfshirë dhe programin e studimit MSc. në Fizioterapi. Ky sistem i dedikuar mundësoi menaxhimin e veprimtarive akademike dhe të mësimdhënies në distancë gjatë pandemisë dhe tashmë është shndërruar në një platformë aktive për zhvillimin e proceseve të trajnimit në distancë për të gjithë profesionistët e shëndetit përfshirë edhe ata të diasporës. Ndërkohë që, në bashkëpunim me kompanitë ARKIT dhe AADF po punohet që në platformën Easy - Ueb të integrohen edhe shërbime që lidhen me vlerësimin e performancës në nivel njësie bazë, kryesore dhe institucionale, vlerësim nga individët si dhe organizimin e aktiviteteve simulatore në mjekësi. Nga takimet në institucion si stafi akademik dhe studentët deklaruan se ishin të kënaqur me përdorimin e platformave elektronike Easy - Web dhe Pitagora që i konsideronin lehtësisht të aksesueshme dhe të thjeshta për përdorim. Evidenca: - Evidenca 150, Ndërfaqe e Sistemit PITAGORA;

	- Evidenca 151, UMED google education.jpg; - Evidenca 152, Pr.sc Ndërfaqe Easeweb (për lëndën).pdf; - Evidenca 153, Pr.sc Sistem elektronik i dedikuar për pikëzimin dhe renditjen e aplikantëve.pdf; - Evidenca 155, Pr.sc të shërbimeve të RASH.pdf; - Evidenca 156, Ndërfaqe web UMT.pdf; - Evidenca 163, Përshkrimi i funksionaliteteve të sistemit PITAGORA; - Evidenca 164, Përmbledhje Manuale Easyweb.pdf; - Evidenca 165, Marrëveshje me RASH për shërbime në fushën e IT; - Vizita dhe takimet me studentët dhe stafin akademik.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Institucioni, prej vitit akademik 2021-2022 disponon sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit Pitagora që administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Në këtë sistem ofrohet shërbimi i sekretarive mësimore dhe menaxhimi i veprimtarisë akademike të studentëve. Gjithashtu, UMT disponon llogari të posaçme duke përdorur shërbimin e ASCAL, AMS, ku mundësohet aksesimi dhe ruajtja nga ana e institucionit i çdo informacioni që lidhet me strukturën e institucionit, programet e studimit, studentët aktiv, kualifikime, stafin akademik në kohë reale. Këto informacione përditësohen vazhdimisht duke u bazuar në raportet e vlerësimit të NjsSBC dhe raportin e vlerësimit vjetor institucional. Ndërkohë që në kuadër të projektit GRADUA me koordinator Universitetin Bujqësor të Tiranës, institucioni është duke përdorur një sistem tjetër informacioni që synon krijimin e bazës së të dhënave të të diplomuarëve në programet e studimit që UMT ofron. Sistem tjetër informacioni i përdorur ishte edhe sistemi i përzgjedhjes së kandidatëve që aplikojnë në programet e UMT. Evidenca: - Evidenca 163, Përshkrimi i funksionaliteteve të sistemit PITAGORA; - Evidenca 153, Pr.sc Sistem elektronik i dedikuar për pikëzimin dhe renditjen e aplikantëve.pdf; - Evidenca 155, Pr.sc të shërbimeve të RASH.pdf;

	- Evidenca 154, Ndërfaqe ASCAL; - Vizita dhe takimet me studentët dhe stafin akademik, administrativ.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Nëpërmjet sistemeve elektronike Easy - Web dhe Pitagora lehtësisht të aksesueshme dhe të thjeshta për përdorim, institucioni siguron akses për të gjithë studentët, personelin akademik dhe profesionistët e shëndetësisë. Sistemet janë të integruar me Google education me akses në E-mailet institucionale, në libraritë online, hapësirë të dedikuar pa limit në Google Drive dhe akses në arkivën elektronike të institucionit. Evidenca: - Evidenca 163, Përshkrimi i funksionaliteteve të sistemit PITAGORA; - Evidenca 153, Pr.sc Sistem elektronik i dedikuar për pikëzimin dhe renditjen e aplikanteve.pdf; - Evidenca 155, Pr.sc të shërbimeve të RASH.pdf; - Evidenca 154, Ndërfaqe ASCAL; - Vizita dhe takimet me studentët dhe stafin akademik, administrativ.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit UMT Easy - Web që institucioni përdor për menaxhimin e informacionit ka të integruar platformën Google education. Nëpërmjet kësaj platforme mundësohet dhënia e moduleve, leksioneve, kryerja e detyrave të kursit, njoftime dhe komunikim interaktiv student-pedagog. Platforma mundëson aksesin me email institucional për të gjithë stafin dhe studentët, hapësirën Google Drive pa limit dhe akses në arkivën elektronike të institucionit. Çdo anëtar i UMT disponon emailin me domain institucional. Komunikimi interaktiv dhe shkëmbimi i informacionit sigurohet edhe nëpërmjet aksesit falas në një sërë librarish online si U-Library, Training 4ALL, E-Research, Virtual university etj. Në bashkëpunim me QSHA, institucioni realizon edhe procesin e aplikimit online të maturantëve kandidatë që dëshirojnë të jenë pjesë e programeve që UMT ofron, matrikullimin e studentëve bazuar në të dhënat e detajuara të përcjella nga UMT, menaxhon dhe monitoron procesin e provimit të shtetit ose liçensimit. Nëpërmjet sistemimit të menaxhimit, sipas udhëzimeve të MAS koordinohen të dhënat e studentëve aktualë dhe të rinj për krijimin e regjistrat elektronik

	themeltar, ose përditësohen numrat e matrikullimit në bazën e të dhënave së agjencisë së provimeve. Sistemi i menaxhimit UMT Easy - Web nëpërmjet platformave të integruara mundëson edhe përpunimin e të dhënave dhe përcjelljen e informacionit në MAS, QSHA dhe në rrjetin e institucioneve të arsimit të lartë të menaxhuar nga Rrjeti Akademik Shqiptar. Evidenca: - Evidenca 151, UMED google education.jpg; - Evidenca 152, Pr.sc Ndërfaqe Easyweb (për lëndën).pdf; - Evidenca 155, Pr.sc të shërbimeve të RASH.pdf; - Evidenca 156, Ndërfaqe web UMT.pdf; - Evidenca 164, Përmbledhje Manuale Easyweb.pdf; - Evidenca 165, Marrëveshje me RASH për shërbime në fushën e IT; - Vizita dhe takimet me studentët dhe stafin akademik, dhe administrativ.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i menaxhimit institucional mundëson komunikimin në kohë reale nëpërmjet adresave të emailit <i>emër.mbiemër@umed.edu.al</i> që e disponon çdo person si staf apo student që në momentin që bëhet pjesë e UMT. Edhe organet drejtuese, stafi akademik, organet kolegjiale kanë mundësi për raportime individuale apo problematika të ndryshme nëpërmjet komunikimit online. Përveç komunikimit me emailin zyrtar institucional, stafi përdor dhe platformën Google classroom, Google site, Google meet si dhe faqe personale interneti mundësuar nga platforma Google education. Personi përgjegjës i teknologjisë së informacionit për ruajtjen, sigurinë e të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi administronin informacionin online në nivel rektorati dhe njësie kryesore dhe mbështet në zgjidhjen e problematikave të hasura në këtë formë komunikimi. Evidenca: - Evidenca 150, Ndërfaqe e Sistemit PITAGORA; - Evidenca 151, UMED google education.jpg; - Evidenca 152, Pr.sc Nderfaqe Easyweb (për lëndën).pdf; - Evidenca 74, Shembull Vendim Rektorati për implementimin e platformës online Easyweb LMS në UMT;

	- Vizita dhe takimet me studentët dhe stafin akademik, dhe administrativ.
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Njësia kryesore, FSHMT ku ofrohet programi i studimit MSc. në Fizioterapi nëpërmjet faqes së saj të Internetit https://fshmt.edu.al/ publikon informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme dhe çdo informacion të lidhur me programin, veprimtarinë institucionale, njoftime për punësim, orarin mësimor, njoftime për konferenca të ndryshme, trajnime, sezonin i provimeve etj. Publikimi mundësohet në gjuhën shqipe dhe angleze. Dhënia dhe shkëmbimi i informacionit mundësohet edhe nëpërmjet platformës së rrjeteve sociale ku FSHMT është shumë aktiv dhe ndërvepron me partnerët dhe publikun e gjerë për mundësitë që ofron dhe jo vetëm. Evidenca: - Evidenca 150, Ndërfaqe e Sistemit PITAGORA; - Evidenca 151, UMED google education.jpg; - Evidenca 152, Pr.sc Ndërfaqe Easyweb (për lëndën).pdf; - Evidenca 155, Pr.sc të shërbimeve të RASH.pdf; - Evidenca 156, Ndërfaqe web UMT.pdf; - Evidenca 163, Përshkrimi i funksionaliteteve të sistemit PITAGORA; - Evidenca 164, Përmbledhje Manuale EasyWeb.pdf; - Evidenca 165, Marrëveshje me RASH për shërbime në fushën e IT; - Evidenca 74, Shembull Vendim Rektorati për implementimin e platformës online Easyweb LMS në UMT; - Vizita dhe takime me studentët dhe stafin akademik, dhe administrativ.
Konkluzione	FSHMT-UMT, disponon sistem të menaxhimit të informacionit, konkretisht platformën Easy - Ueb dhe Pitagora me funksione të shumëfishta. Nëpërmjet këtij sistemi administrohet informacioni, dokumentacioni dhe aktiviteti i personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në programin e studimit. Sistemi i menaxhimit UMT Easy - Ueb ka të integruar edhe platformën Google education që mundëson komunikim interaktiv student-pedagog. GVJ konstatoi se komunikimi

	realizohet në kohë reale nëpërmjet adresave të emailit emër.mbiemër@umed.edu.al, e disponueshme nga çdo student dhe staf i angazhuar në programin e studimit MSc. në Fizioterapi. Sistemi është në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit MSc. në Fizioterapi bazuar në legjislacionin në fuqi për ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit MSc. në Fizioterapi. Raporti hartohet në nivel njësisë dhe strukturash përgjegjëse për programin e studimit. Në këtë kuadër institucioni harton analizën vjetore përfshirë atë financiare në nivel departamenti, fakulteti dhe universiteti. Zyra e financës harton raportin financiar institucional. Në bazë të këtyre raporteve si dhe analizës vjetore të aktivitetit kërkimor shkencor dhe projekteve të stafit hartohet edhe plani i masave për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit, dhe vlerësimin e performancës së stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Planin e masave është rezultat i diskutimeve aktive në nivele të ndryshme si dhe mbledhjes së hapur të Senatit Akademik me të gjitha palët e interesuara (personel akademik dhe administrativ, të ftuar dhe studentë). Raporti vjetor i hartuar bazuar në udhëzimin nr. 5, datë 19.02.2018, i ndryshuar të MAS pas miratimit nga Senati Akademik publikohet në faqen Web të institucionit. Raporti është publik dhe i aksesueshëm për të gjithë. Evidenca: - Evidenca 79, Raport vjetor UMT 2021,2022,2023; - Evidenca 80, Raport vjetor FSHMT 2020-2021;




	- Evidenca 81, Raport vjetor FSHMT 2021-2022; - Evidenca 82, Raport vjetor FSHMT 2022-2023; - Evidenca 83, Raport i aktivitetit shkencor i Departamentit 2020; - Evidenca 84, Raport i aktivitetit shkencor i Departamentit 2021; - Evidenca 85, Raport i aktivitetit shkencor i Departamentit 2022; - Evidenca 167, Model formular i aktivitetit shkencor; - Evidenca 168, Analizë për aktivitetin kërkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik të UMT.pdf; - Evidenca 73, Shembull VBA për miratimin e efekteve financiare të hapjes së një programi; - Evidenca 116, Analizë vjetore zyra e financës; - Evidenca 169, Shembull Vlerësimi i performancës së stafit administrativ; - Vizita dhe takimet me studentët dhe stafin akademik, drejtuesin e departamentit dhe stafin administrativ.
--	---




Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Bazuar në Rregulloren e UMT, menaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimeve kryhet në nivel rektorati, njësie kryesore dhe bazë. Plani i financimit përmban çdo nevojë e kërkesë që vjen nga departamenti për burimet njerëzore të anagazhuar në programin e studimit, shpenzime operative për mirëmbajtjen dhe pasurimin e mjediseve laboratorike dhe të teknologjisë mbështetëse, shpenzime për bibliotekën, aksesin në libraritë online, dhe çdo zë tjetër që është në funksion të programit të studimit. Nga takimet në institucion u konstatua se ky plan financiar hartohet çdo vit në formën e projekt buxhetit ku pasqyrohet çdo nevojë e njësisë bazë ku ofrohet programi i studimit. Stafi akademik gjatë vizitës raportoi gjithashtu se kishte mbështetje financiare nga institucioni për pjesëmarrje në konferenca dhe botim artikujsh në revista ndërkombëtare të indeksuara me tarifë. Stafi akademik pohoi se institucioni ofronte mbështetje financiare edhe për pjesëmarrje në mobilitete ndërkombëtare të planifikuara. Çdo anëtar i angazhuar në programin e studimit si staf apo student kishin akses individual me fjalëkalimin dhe emrin e përdoruesit përkatës në libraritë mjekësore online në çdo kohë dhe pa pagesë. Plani financiar i institucionit miratohet nga Bordi i Administrimit, ndërkohë që FSHMT si njësi kryesore e UMT ka administratorin e saj. Evidenca: - Evidenca 1, Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë; - Evidenca 2, Rregullore e Universiteti të Mjekësisë Tiranë; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamentit FSHMT; - Evidenca 167, Model formular i aktivitetit shkencor; - Evidenca 168, Analizë për aktivitetin kërkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik të UMT.pdf; - Evidenca 73, Shembull VBA për miratimin e efekteve
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	FSHMT dhe njësitë bazë përgjegjëse për programet e studimit kryejnë kontrolle periodike që kanë në fokus gjendjen e planit të financimit dhe efektivitetin financiar të këtij plani. Këto auditime kryhen nga njësi dhe struktura të institucionit, si Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB), të pavaruara dhe që sigurojnë zbatimin e duhur dhe respektim të kërkesave ligjore në fuqi, apo

	akteve normative të dala nga organet kolegjiale apo drejtuese të institucionit. Për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe mbikëqyrjen financiare në institucion kryhet edhe auditimi i jashtëm. Evidenca: - Evidenca 50, Praktika e ndjekur për auditim nga njësi audituese e jashtme (UNICEF); - Evidenca 51, Praktika e ndjekur për auditim nga Njësia e Auditit të Brendshëm; - Evidenca 183, Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Institucional _UMT Maj 2022; - Vizita në institucion.
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Institucioni ka një praktikë të konsoliduar në lidhje me raportimin për programet e studimit që ofron përfshirë dhe programin e studimit MSc. në Fizioterapi, mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës në çdo nivel, përfshirë dhe njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit. Procesi është edhe më i lehtë për tu realizuar në sajë të përdorimit të sistemit të menaxhimit dhe komunikimit në kohë reale nga njësitë respektive por edhe informimit të partnerëve të jashtëm të institucionit si MAS, QSHA, ASCAL etj. I gjithë procesi dokumentohet në Raportin Vjetor institucional të hartuar në bazë të udhëzimit përkatës të MAS dhe kuadrit ligjor në fuqi. Në këtë raport përfshihet veprimtaria akademike, financiare dhe shkencore e çdo njësie bazë e cila është diskutuar dhe miratuar paraprakisht në nivel departamenti, fakulteti dhe institucioni në një mbledhje të hapur të Senatit Akademik. Evidenca: - Evidenca 1, Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë; - Evidenca 2, Rregullore e Universitetit të Mjekësisë Tiranë; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamentit FSHMT; - Evidenca 79, Raport vjetor UMT 2021,2022,2023; - Evidenca 80, Raport vjetor FSHMT 2020-2021; - Evidenca 81, Raport vjetor FSHMT 2021-2022; - Evidenca 82, Raport vjetor FSHMT 2022-2023;

	- Evidenca 83, Raport i aktivitetit shkencor i Departamentit 2020; - Evidenca 84, Raport i aktivitetit shkencor i Departamentit 2021; - Evidenca 85, Raport i aktivitetit shkencor i Departamentit 2022; - Evidenca 88, Të dhëna Fianciare për alokim buxheti FSHMT (3 vite); - Evidenca 89, Të dhëna për bursat e studenteve FSHMT (3 vite); - Evidenca 90, Të dhëna për zhvillimin e infrastrukturës dhe investimet; - Evidenca 167, Model formular i aktivitetit shkencor; - Vizita në institucion, takime me stafin akademik, studentët, drejtuesin e departamentit dhe përfaqësues të zyrës së Financës.
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programit të studimit MSc. në Fizioterapi dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtij programi, duke përdorur një sërë metodash përfshirë planifikimin në kuadër të hartimit të projekt buxhetit vjetor dhe afatmesëm. Për të siguruar dhe garantuar qëndrueshmërinë financiare institucioni vepron duke mbledhur fonde të tjera jashtë buxhetit të shtetit, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi si tarifat e shkollimit, regjistrimit, të ardhura nga projektet si dhe bashkëpunime me institucione publike apo private, brenda dhe jashtë vendit. Në miratimin e buxhetit vjetor diskutohen edhe raste të cilat kanë nevojë për përmirësim të situatës financiare që realizohet nëpërmjet diversifikimit eventual të financimit të programit të studimit. Institucioni ka të drejtën që të përdori të ardhurat që gjeneron vetë dhe ti trashëgoj në masën 100% për veprimtari apo shërbime që ofron. Evidenca: - Evidenca 52, Praktikë për miratimin e buxhetit vjetor UMT; - Evidenca 53, Procedura për miratimin e buxhetit vjetor; - Evidenca 54, Procedura e hartimit të projekt buxhetit afatmesëm;

	- Evidenca 110, Praktikë për miratimin e buxhetit vjetor UMT; - Evidenca 111, Procedura për miratimin e buxhetit vjetor; - Evidenca 112, Procedura e hartimit të projekt buxhetit afatmesëm; - Evidenca 116, Analizë vjetore zyra e financës; - Vizita në institucion.			
Konkluzione	Institucioni garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit MSc. në Fizioterapi dhe mbështetjen e studentëve që ndjekin këtë program studimi. Institucioni harton një raport financiar të kostove bazuar në nevojat dhe kuadrin rregullator në fuqi, harton dhe planifikon veprimtarinë financiare si vjetore dhe afatmesëm duke marrë në konsideratë nevojat e njëjësive bazë dhe kryesore si dhe garanton qëndrueshmërinë financiare duke përdorur mekanizma të ndryshëm si planifikimi, ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të	Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve të programit MSc. në Fizioterapi nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nëpërmjet akteve të veta rregullatore ku

studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	përfshihen kriteret bazë të pranimi, kriteret e përzgjedhjes, kuotat e planifikuara për studentë vendas, vendet shqip folëse, kategoritë e marginalizuara etj, institucioni garanton përzgjedhje të kandidatëve me arritje të larta akademike. Cikli i plotë akademik i studentëve mbështetet nga Zyra e Karrierës, informimi nga sekretaritë mësimore dhe stafi akademik si dhe organizimi vjetor i ditëve të hapura dhe të informimit. Raporti staf/student, m² për student, staf akademik me grada dhe tituj, si dhe mbulimi 70% i ngarkesës mësimore nga personeli akademik me kohë të plotë janë kriteret e cilësisë që përmbushen nga institucioni. Studentët kanë infrastrukturën e nevojshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor si dhe një staf akademik të kualifikuar dhe brenda fushës së ekspertizës. Procedurat e regjistrimit të studentëve kryhen sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatore. Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e Universiteti të Mjekësisë, Tiranë; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 21, Rregullore për Progimet në FSHMT; - Evidenca 34, Pranimet dhe Regjistrimet në UMT; - Evidenca 35, Shembull Njoftim punësimi part time web; - Evidenca 36, Platforma e UMT; - Evidenca 139, Pr.Sc Publikimi i kriterëve të pranimi ciklit i parë dhe PICD.pdf; - Evidenca 140, Procedura e aplikimit dhe regjistrimit në programet e ciklit , I), I (SPA) ; - Evidenca 142, Praktikë për miratimin e kriterëve të pranimi cikli i parë dhe integruar; - Evidenca 143, Praktikë për miratimin e kuotave cikli i parë dhe integruar; - Evidenca 144, Raporti MAS për verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet 21-22- certifikimi i kuotave; - Vizita në institucion, takimi me studentët, përfaqësues të stafit akademik të zyrës së këshillimit të karrierës dhe sekretarisë mësimore.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje	FSHMT nëpërmjet politikave dhe procedurave që ndjek garanton barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët

garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	për studentë dhe studentët e programit të studimit MSc. në Fizioterapi. Komisionet ad-hoc me përfaqësues nga çdo fakultet, kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara dhe shpallura si dhe teknologjia e informacionit e përdorur për përzgjedhje janë garant të barazisë dhe transparencës për përzgjedhjen e kandidatëve që dëshirojnë të ndjekin ciklin e studimeve MSc. në Fizioterapi në FSHMT-UMT. Edhe rezultatet e studimeve të ciklit të parë të studimeve ndër të tjera janë komponentë që përdoren për përzgjedhjen e kandidatëve. Regjistrimi i studentëve kryhet pranë sekretarisë mësimore, të cilët më pas regjistrohen në sistemin Easy Web, ku ndjekin vijimësinë e studimeve deri në diplomim. Evidenca: - <i>Evidenca 132, Procedura dhe praktika e pikëzimit dhe renditjes së aplikanteve në programin e ciklit I dhe të integruar.pdf;</i> - <i>Evidenca 140, Procedura e aplikimit dhe regjistrimit në programet e ciklit , I), I (SPA);</i> - <i>Evidenca 142, Praktikë për miratimin e kriterëve të pranimit cikli i parë dhe integruar;</i> - <i>Evidenca 143, Praktikë për miratimin e kuotave cikli i parë dhe integruar;</i> - <i>Vizita në institucion, sekretaria mësimore.</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Në përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve Master i Shkencave në Fizioterapi, konstatohet se FSHMT harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimit në përputhje me kriteret, kuotat e propozuara nga njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe të miratura nga dekani. I gjithë procesi është transparent dhe publik në faqen Web të institucionit dhe bazuar në Udhëzimet e MAS. FSHMT bashkëpunon për realizimin e procesit me MAS, që paraprakisht verifikon kapacitetet për kuotat e propozuara. Çdo gjë që lidhet me regjistrimin e studentëve, ecurinë përgjatë ndjekjes së studimeve, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, transferimin, vlerësimin e njohurive dhe procedura e diplomimit kryhen sipas legjislacionit në fuqi, akteve rregullatore dhe procedurave të miratuara të cilat janë publike. Institucioni

	parashikon dhe regjistrimin e studentëve të huaj sipas kritereve të përcaktuara në kuadrin ligjor. Evidenca: - Evidenca 188, Rregullore e sekretarisë; - Evidenca 134, Procedura e aplikimit dhe regjistrimit në programet e ciklit , I), I (SPA); - Evidenca 137, Praktikë për miratimin e kuotave cikli i parë dhe integruar; - Evidenca 138, Raporti MAS për verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet certifikimi i kuotave; - Evidenca 139, Procedura për miratimin e kritereve dhe kuotave të pranimi në programet ciklit të parë PICD dhe të ciklit të dytë në UMT; - Vizita në institucion, sekretaria mësimore.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve në programin MSc. në Fizioterapi, përparimit përgjatë këtij programi studimi, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme. Çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve dhe plotëson kriteret e pranimi në Universitet, në përputhje me ligjin nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe rregulloren e UMT ka mundësinë për tu pranuar në programin e studimeve të ciklit të dytë MSc. në Fizioterapi. Pranimi dhe regjistrimi i kandidatëve bazohet në legjislacionin në fuqi dhe akteve rregullatore, të aksesueshme nga publiku nëpërmjet faqes Web të institucionit dhe marrjes së informacionit nga sekretaria mësimore. Nëse një kandidat është shpallur fitues në programin MSc. në Fizioterapi paraqitet pranë sekretarisë mësimore ku dorëzon edhe dokumentat e nevojshme, të kërkuara si dhe kryen pagesën e tarifave së regjistrimit. I gjithë procesi bazohet në aktet nënligjore të nxjerra nga MAS. Pranimi dhe transferimi i studentëve në programin e studimit bëhet në përputhje me procedurat e transferimit të studentëve të UMT dhe legjislacionin në fuqi. Kërkesa e studentëve për transferimin e krediteve rishikohet nga një komision ad-hoc në nivel departamenti dhe aprovohet nga dekani. Kreditet e transferuara të studentëve hyjnë në fuqi me miratimin e Dekanatit. Programi i studimeve MSc. në Fizioterapi nuk ka

	<i>patur transferime. Kjo nga GVJ konsiderohet si praktikë e mirë pasi është reflektim i qëndrueshmërisë të cilësisë së mësimdhënies të institucionit, pasi studentët që ndjekin programin janë nga vetë radhët e institucionit. Ndërkohë që duhet të shërbej edhe si indikator reflektimi për të identifikuar arsyet dhe faktorët e mungesës së interesit nga studentët që nuk kanë ndjekur ciklin e parë të studimeve në FSHMT.</i> Evidenca: - Evidenca 132, Procedura dhe praktika e pikëzimit dhe renditjes së aplikantëve në programin e ciklit I dhe të integruar.pdf; - Evidenca 188, Rregullore e sekretarisë; - Evidenca 137, Praktikë për miratimin e kuotave cikli i parë dhe integruar; - Evidenca 138, Raporti MAS për verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet certifikimi i kuotave; - Evidenca 139, Procedura për miratimin e kriterëve dhe kuotave të pranimit në programet ciklit të parë PICD dhe të ciklit të dytë në UMT; - Vizita në institucion, takime me studentët dhe sekretaria mësimore.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Informimi i publikut dhe të interesuarve në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit MSc. në Fizioterapi kryhet përmes faqes Web të institucionit (https://fshmt.edu.al/), e cila përditësohet vazhdimisht jo vetëm me informacion që lidhet specifikisht me programin e studimit por edhe me të gjitha veprimtaritë e zhvilluara me karakter akademiko-shkencor, social, kulturor si dhe aktivitetet studentore. Në dispozicion të studentëve dhe kandidatëve të interesuar institucioni vendos edhe materiale informuese si broshura, fletëpalosje, të cilat përditësohen në mënyrë periodike në lidhje me ecurinë dhe zhvillimin e programit. Për të promovuar dhe informuar të gjithë të interesuarit rreth programeve të studimit, institucioni merr pjesë edhe në panaireset e organizuara në qytetet e Shqipërisë nga dhoma e tregtisë. Evidenca: - Evidenca 123, Shembull Broshure Informuese për studentët FSHMT;

	- <i>Vizita në institucion.</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Institucioni në përputhje me strategjitë kombëtare ndjek dhe zbaton politika lehtësuese për studentët që vijnë nga disa kategori të veçanta sociale, studentë me aftësi të kufizuara/veçanta; studentë romë ballkano-egjiptian, studentët me statusin e jetimit, fëmijë të policëve të rënë në detyrë, etj. Planifikimi i kuotave për kategoritë e cituara në këtë kriter kryhet përpara çdo viti akademik bazuar në historikun e kërkesave të viteve parardhëse dhe kriteret e përzgjedhjes janë në përputhje me Udhëzimin nr.17, datë 30.07.2019 të MAS. Evidenca: - <i>Evidenca 137,Praktikë për miratimin e kuotave cikli i parë dhe integruar;</i> - <i>Evidenca 138, Raporti MAS për verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet certifikimi i kuotave;</i> - <i>Evidenca 139, Procedura për miratimin e kriterëve dhe kuotave të pranimet në programet ciklit të parë PICD dhe të ciklit të dytë në UMT;</i> - <i>Vizita në institucion.</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	FSHMT harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera përmes kuotave të veçanta dhe në përputhje me udhëzimet e MAS. Përcaktimi dhe publikimi i kuotave për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera kryhet bazuar në historikun e kërkesave gjatë viteve paraardhëse. Evidenca: - <i>Evidenca 137, Praktikë për miratimin e kuotave cikli i parë dhe integruar;</i> - <i>Evidenca 138, Raporti MAS për verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet certifikimi i kuotave;</i> - <i>Evidenca 139, Procedura për miratimin e kriterëve dhe kuotave të pranimet në programet ciklit të parë PICD dhe të ciklit të dytë në UMT;</i> - <i>Vizita në institucion.</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimet në	FSHMT harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë studentëve në programin e studimit MSc. në Fizioterapi me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Këto politika konsistojnë

programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	ndër të tjera në ofrimin e bursave të studimit për studentët me mesataren më të lartë hyrëse në universitet, për studentët me aftësi të kufizuar, studentët me një prind, fëmijët e ish të dënuarve, fëmijë të policëve të rënë në detyrë apo për shtresa të tjera në nevojë. Lista e studentëve përfitues për bursë nga kjo kategori miratohet çdo vit akademik nga Bordi i Administrimit, ndërkohë që të gjithë studentët përfitues të ndihmës financiare dorëzojnë paraprakisht në zyrat e protokollit dokumentacionin e nevojshëm. Procedura e përfitimit të bursave kryhen sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatore. Evidenca: - Evidenca 89, Të dhëna për bursat e studentëve FSHMT (3 vite); - Vizita dhe takimet në institucion.			
Konkluzione	FSHMT-UMT harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin e studentëve në programin MSc. në Fizioterapi, përzgjedhjen e tyre në këtë program studimi bazuar në kritere të qarta dhe të barabarta në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të miratuar. Institucioni mundëson në saj të politikave që ndjek përparimin e studentëve të të gjitha shtresave, përfshirë dhe studentët në nevojë dhe të trojeve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit MSc. në Fizioterapi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe	Studentëve u vihet në dispozicion informacion i hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik nëpërmjet mënyrave të ndryshme. I gjithë informacioni i nevojshëm gjendet në rregulloren e programit, rregulloren e fakultetit si dhe në syllabuset e lëndëve të programit MSc. në Fizioterapi. Studentët informohen edhe nga lektorët e lëndës në orën e parë të çdo moduli mësimor, nëpërmjet prezantimit të syllabusit, për

kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	kriteret e vlerësimit, literaturën bazë dhe ndihmëse, detyrimet dhe përgjegjësitë që lidhen me programin e studimit. <i>Ky fakt u dëshmuar edhe nga takimet me studentët dhe stafin akademik.</i> Evidenca: - Evidenca 21, Rregullore për Programet në FSHMT; - Evidenca 92, Syllabuset e lëndëve Msc. Fizioterapi; - Vizita në institucion dhe takimet me studentët.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Zyra e Sekretarisë Mësimore udhëzon dhe u jep studentëve informacion në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme. Çdo student duhet të paraqesi pranë sekretarisë mësimore kërkesën për transferimin e krediteve nga institucioni që do transferohet si dhe njihet me kriteret dhe procedurat e transferimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për transferim. Çdo kërkesë transferimi kreditesh nga ana e studentëve rishikohet nga një komision ad-hoc në nivel departamenti, aprovohen nga Dekani i fakultetit dhe hyjnë në fuqi pas dhënies së miratimit nga Rektorati. Për diplomim, studentët e transferuar duhet të fitojnë të paktën 1/2 të totalit të krediteve të programit të studimit ku transferohen. Procedura kryhet në përputhje me kuadrin rregullator të miratuar të institucionit dhe në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë. Evidenca: - Evidenca 109, Analizë vjetore Sekretaria mësimore; - Evidenca 188, Rregullore e sekretarisë; - Evidenca 98/1, Tabela me statistikat e studentëve Msc. Fizioterapi (regjistrim, transferim, diplomim_2020-2023); - Evidenca 134, Procedura e aplikimit dhe regjistrimit në programet e ciklit , I), I (SPA) ; - Vizita në institucion - Sekretaria mësimore.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Rregulloret e programeve të studimit specifikojnë mënyrën dhe kriteret e vlerësimit me të cilën studentët njihen që në momentin që regjistrohen në programin e studimit. Syllabuset e çdo lënde kanë të specifikuar mënyrën e vlerësimit të studentëve, llojet e provimeve, shpërndarjen e ngarkesës në çdo provim, periudhën kohore, përmbajtjen e provimeve, komponentë shtesë të vlerësimit etj. Ky informacion u jepet nga lektorët e çdo lënde

	që në ditën e parë të fillimit të zhvillimit të modulit. Vlerësimi i dijeve bazohet në tre komponentë bazë: 1) Provimi i Ndërmjetëm (20-30% e notës përfundimtare), 2) Provimi Përfundimtar (30-40% e notës përfundimtare), dhe 3) Pjesëmarrje aktive e studentit në klasë (10% e notës përfundimtare). Komponentë të tjerë vlerësimi të aplikueshëm që përbëjnë 10-20% të notës përfundimtare përfshijnë kombinim të punëve laboratorike, detyra të kursit, raste studimore etj. Evidenca: - Evidenca 21, Rregullore për Programet në FSHMT; - Evidenca 92, Syllabuset e lëndëve Msc.Fizioterapi; - Vizita në institucion takimet me studentët dhe stafin akademik.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Studentët që ndjekin programin e studimit MSc. në Fizioterapi informohen në lidhje me kriteret e procedurat e diplomimit, përfshirë dhe kriteret e procedurat e punimit të diplomës përpara fillimit të çdo viti akademik. Institucioni ka hartuar një rregullore të posaçme për punimin e diplomës (Rregullorja e Projektit të Diplomimit). Ky dokument bashkë me rregulloret e tjera të tilla si Rregullorja e UMT, Rregullorja e Fakultetit, Rregullorja e Departamentit, Rregullorja e Programit të Studimit, përcaktojnë të gjitha parakushtet dhe procedurat për projektin e diplomimit. <i>Në programin e studimit MSc. në Fizioterapi shlyerja e detyrimeve finale kryhet me punim diplome.</i> Departamenti DDRSHIKIOGJ, përgjegjës për ofrimin e studimit MSc. në Fizioterapi informon studentët në lidhje me detyrimet dhe përgjegjësitë që ata kanë për tu diplomuar në këtë program studimi. Evidenca: - Evidenca 1, Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë; - Evidenca 2, Rregullore e Universiteti të Mjekësisë, Tirane; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamenti_FSHMT; - Evidenca 92, Syllabuset e lëndëve Msc. Fizioterapi; - Evidenca 21, Rregullore për Programet në FSHMT; - Vizita në institucion takimet me studentët dhe stafin akademik.

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Studentëve u ofrohet informacioni i nevojshëm për programin e studimit nga Zyra e Sekretarisë Mësimore, personeli akademik, administrativ jo vetëm në mjediset e institucionit por edhe gjatë organizimit të ditëve të hapura ku studentët e interesuar njihen me strukturën e institucionit dhe programet e studimit që institucioni ofron. Informacioni është i disponueshëm dhe në faqen zyrtare Web si dhe në rrjetet sociale të institucionit. Evidenca: - <i>Evidenca 123, Shembull Broshure Informuese për studentët FSHMT;</i> - <i>Vizita në institucion me përfaqësues të Drejtorisë së Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI.</i>			
Konkluzione	<i>FSHMT vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit MSc. në Fizioterapi, informacion të plotë e të hollësishëm mbi kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme, përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në program nëpërmjet temës së diplomës. Çdo student potencial për programin e studimeve MSc. në Fizioterapi ka mundësinë për marrjen e informacionit të nevojshëm dhe të detajuar mbi programin në sajë të aktiviteteve të organizuara të informimit dhe aksesit në faqen zyrtare Web të institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit MSc. në Fizioterapi nga Zyra e Sekretarisë Mësimore, informacioni i aksesueshëm nga të gjithë në faqen Web të institucionit http://umed.edu.al , takimet me stafin akademik të angazhuar në programin e studimit dhe vënien në dispozicion për të gjithë të interesuarit aksesimin e formatit hardcopy të dosjes së programit të studimit pranë zyrave institucionale të shërbimit të studentëve. Në

	javën e parë të vitit akademik titullari i secilës lëndë të programit të studimit u mundëson studentëve informacion të detajuar mbi strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit, sezonet e provimeve, mënyrën e vlerësimit etj. Evidenca: - Evidenca 123, Shembull brochure informuese për studentët e FSHMT; - Evidenca, Faqe Web http://umed.edu.al/ https://fshmt.edu.al/ - Vizita në institucion.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programit MSc. në Fizioterapi informacion dhe dokumentacion, udhëzues të posaçëm për modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese si në formatin hardcopy në sekretariatë mësimore, nga pedagogët e lëndëve sylabuset dhe online në faqen Web të institucionit. Javën e parë të studimeve, studentët informohen edhe nga zyrat e shërbimit të studentëve dhe takimet në departamentin ku ofrohet programi i studimit për planin mësimor, të dhëna për programin dhe çdo informacion tjetër i nevojshëm mbi programin. Evidenca: - Evidenca Faqe Ueb https://fshmt.edu.al/; - Vizita në institucion.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni informon studentët e programit MSc. në Fizioterapi mbi mundësitë e punësimit, si dhe mundëson mbështetjen institucionale për orientimin e tyre drejt dhe në tregun e punës. Zyra e Karrierës luan një rol shumë aktiv në këtë drejtim në planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve orientues gjatë gjithë vitit. Kjo zyrë mban kontakte me studentët dhe i informon ata rregullisht mbi mundësitë e tregut të punës në lidhje me praktikën, punët me kohë të pjesshme/të plotë dhe aktivitete të tjera që synojnë rritjen e potencialit të tyre dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës vendas e ndërkombëtar. Nëpërmjet Zyrës së Karrierës, institucioni merr pjesë çdo vit në Panairin e Punës, ku studentët kanë mundësinë të njihen me bashkëpunëtor dhe palë të interesuara institucione/kompani të cilat ofrojnë mundësi punësimi dhe praktike për studentët e të gjitha programeve të studimit. Praktika e dëshmimeve të Alumni, ku studentë të diplomuar në programin e studimit ndajnë historitë e tyre të suksesit, të integritetit në vendin e punës dhe avantazhet që programi i studimit ofron për punësim janë një aspekt tjetër i informimit të studentëve me ofertat dhe kërkesat reale të tregut të punës.

	Evidenca: - Evidenca 107, Manuali i karrierës së studentëve FSHMT; - Evidenca 108, Aktivitete të zyrës së karrierës FSHMT; - Vizita në institucion me përfaqësues të Zyrës së Karrierës.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Institucioni vendos në dispozicion të studentëve të programit MSc. në Fizioterapi informacion të gjerë dhe të përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Informacioni ofrohet nëpërmjet faqes zyrtare Web, prezantimit të planit mësimor nga stafi akademik në javën e parë të semestrit, informacion i detajuar për zyrat, sallat e leksioneve dhe labororet, infrastrukturën dhe logjistikën në funksion të programit të studimit në përgjithësi. Zyrat e shërbimit të studentëve në fillim të vit akademik dhe jo vetëm janë në dispozicion të studentëve dhe i informojnë ata në lidhje me studimet e tyre. Evidenca: - Evidenca 123, Shembull brochure informuese për studentët e FSHMT; - Evidenca, Faqe Web, http://umed.edu.al/https://fshmt.edu.al/; - Vizita në institucion.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Çdo student që ndjek programin e studimit MSc. në Fizioterapi ka akses online në sistemin e menaxhimit të informacionit Pitagora nëpërmjet sigurimit të aksesit me emër përdoruesi dhe kod me akses kudo dhe në çdo kohë. Nëpërmjet llogarisë së dedikuar në sistemin online Pitagora, studentët marrin informacionin dhe shërbime të nevojshme në lidhje me programin e studimit. Evidenca: - Evidenca 149, Përshkrimi i funksionaliteteve të sistemit PITAGORA; - Evidenca 40, Ndërfaqe sistemi PITAGORA; - Vizita në institucion.
Konkluzione	FSHMT vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për përmbajtjen e programit të studimit MSc. në Fizioterapi. Zyra e Sekretarisë Mësimore, takimet me stafin akademik të angazhuar në programin e studimit dhe vënia në dispozicion për të gjithë të interesuarit e formatit hardcopy të dosjes së programit të studimit pranë zyrave institucionale të shërbimit të studentëve janë disa nga mënyrat e dhënies së informacionit të

	gjithë të interesuarëve. Zyra e Karrierës dhe Alumni organizon aktivitete periodike në bashkëpunim edhe me studentët për dhënie e informacionit në lidhje me objektivat, strukturën, organizimin, rezultatet e pritshme të të nxënit, mundësitë e punësimit, infrastrukturën dhe logjistikën që programi i studimit ofron. Gjithashtu, informacioni është i aksesueshëm nga të gjithë edhe në faqen Ueb të institucionit http://umed.edu.al .			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	FSHMT disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve, e të diplomuarve, në programin e studimit MSc. në Fizioterapi. Këto statistika mbledhen dhe analizohen çdo vit nga Zyra e Karrierës dhe Alumni, Sekretaria Mësimore dhe Drejtoria e Kurrikulave në nivel universiteti. Statistikat përfshijnë statusin e punësimit të studentëve në programin e studimit, informacion mbi përputhshmërinë e punës me drejtimin e studentëve të diplomuar dhe emrat e kompanive/institucioneve ku ata janë punësuar. Ky informacion përpunohet çdo vit për shkak të komunikimit të vazhdueshëm që Zyra e Karrierës dhe Alumni mban me të diplomuarit. <i>Nga vizita në institucion, gjatë takimeve u evidentua se nuk ka një bazë të mirëfilltë të dhënash për Alumni. GVJ sugjeron gjetjen e mekanizmave për krijimin e kësaj baze të dhënash në bashkëpunim edhe me palët e interesit, rrjetet e profesionistëve me impakt në përmirësimin, rritjen dhe qëndrueshmërinë e programit të studimit.</i> Evidenca: - Evidenca 108, Aktivitete të zyrës së karrierës FSHMT; - Vizita në institucion me përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumni.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore	FSHMT disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit MSc. në Fizioterapi, deri në

për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Këto statistika vjetore sigurohen nga mënyra të ndryshme si nga sistemi i menaxhimit të informacionit, të dhënat statistikore të gjeneruara nga sekretaritë mësimore duke respektuar udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u konstatua së numri i studentëve për tre vitet akademike për programin e studimit MSc. në Fizioterapi është si më poshtë vijon:

Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali
2021-2022	21	0	21
2022-2023	30	0	30
2023-2024	24	0	24

Evidenca:

- Evidenca 32, Shërbimet për studentët_kërkesa_FSHMT;
- Evidenca 33, Shërbimet për studentët, FSHMT;
- Evidenca 109, Analizë vjetore Sekretaria mësimore;
- Vizita në institucion, sekretaria mësimore, aneks tabelat përmbledhese tabela 21.

Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe aksesit në arkivën elektronike është i dedikuar dhe administruar nga personeli përgjegjës IT në nivel rektorati dhe fakulteti. Të dhënat statistikore janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar, përkatësisht nga sekretaria mësimore që është dhe njësi përgjegjëse për hedhjen, verifikimin dhe ruajtjen e të dhënave statistikore të studentëve. Në përputhje me legjislacionin ligjor në fuqi dokumentacioni i studentëve ruhet në dy formate, kopje në letër dhe elektronik. Të dhënat e studentëve përditësohen në rastet kur kemi studentë që diplomohen apo transferohen. Sistemi i menaxhimit të informacionit shërben edhe si një bazë e gjerë të dhënash nga e

	cila mund të gjenerohen informacione që lidhen me hartim raportesh vjetore, statistika për studentët e regjistruar, diplomuar, performancën akademike etj. Evidenca: - Evidenca 41, Ndërfaqe_UMED google education; - Evidenca 42, Ndërfaqe Easyweb (për lëndën) ; - Evidenca 43, Ndërfaqe_Sistem elektronik i dedikuar për pikëzimin dhe renditjen e aplikanteve; - Evidenca 74, Shembull Vendim Rektorati Për implementimin e platformës online Easyweb LMS në UMT; - Evidenca 142, Pr.sc të shërbimeve të RASH.pdf; - Evidenca 143, Ndërfaqe web UMT.pdf; - Evidenca 147, Përshkrim i funksionaliteteve të platformës E-UMT; - Evidenca 148, Përshkrim funksionaliteteve të platformës Easyweb LMS; - Vizita në institucion, sekretaria mësimore.
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	FSHMT kryhen kontrollin periodik të përvitshëm të programit të studimit pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin e brendshëm të informacionit. Kontrolli periodik kryhet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB), pjesë e organigramës së institucionit. Kjo njësi vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit e të dokumentacionit që lidhet me studentët e me veprimtarinë e tyre përkatëse. NjAB ushtron kontrole periodike vjetore për auditimin e njësive përbërëse të institucionit për zbatimin e drejtë të ligjit apo akteve normative të dala nga organet kolegjiale apo drejtuese të institucionit. Grupet e ngritura të monitorimit vlerësojnë dhe dokumentojnë gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. Pjesë e rezultateve të auditimit bëhen publike nëpërmjet raportit vjetor të njësive bazë, kryesore dhe të universitetit. Evidenca: - Evidenca 3, Organigrama UMT.pdf; - Evidenca 79, Raport vjetor UMT 2020-2021; - Evidenca 79.1, Raport vjetor UMT 2021-2022; - Evidenca 80, Raport vjetor FSHMT 2020-2021;

	- Evidenca 81, Raport vjetor FSHMT 2021-2022; - Evidenca 82, Raport vjetor FSHMT 2022-2023; - Evidenca 50, Praktika e ndjekur për auditim nga njësi audituese e jashtme (UNICEF); - Evidenca 51, Praktika e ndjekur për auditim nga Njësia e Auditit të Brendshëm; - Vizita në institucion.
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Gjatë takimeve në institucion me përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumni, Zyrës së Sekretarisë mësimore dhe drejtuesin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit MSc. në Fizioterapi, u evidentua se, njësia bazë harton raporte analitike dhe periodike për profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, bazuar kryesisht në rezultatet e studentëve gjatë ndjekjes së studimeve dhe përthithjen e studentëve më të mirë në vend. Nga të dhënat rezultojnë se 97% e studentëve të programeve të studimit janë të punësuar në kompani të konsoliduar dhe të afirmuara në fushën e rehabilitimit fizik. Shkëmbimi efektiv i informacionit midis njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe zyrave përkatëse në institucion mundëson që nëpërmjet analizës së të dhënave të mbledhura nga kontrollet periodike të hartohen politika të njësisë bazë që synojnë përmirësimin e cilësisë së programit dhe integrimin e studentëve të diplomuar në këtë program studimi sa më shpejt me tregun e punës. Evidenca: - Evidenca 107, Manuali i karrierës së studentëve FSHMT; Evidenca 108, Aktivitete të zyrës së karrierës FSHMT; - Evidenca 185, Udhëzues për plotësimin e planit të mobilitetit për studentë; - Evidenca 20, Emaile zyrtare për stafin dhe studentet, UMED; - Vizita në institucion.
Konkluzione	FSHMT mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit MSc. në Fizioterapi, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Këto statistika mbledhen dhe analizohen çdo vit nga Sekretaria Mësimore, Drejtoria e Kurrikulave dhe Zyra e Karrierës dhe

	<i>Alumni, në nivel Universiteti. Auditimet periodike dhe statistikave mundësohen nga Njësia Bazë dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm, NjAB pjesë e organigramës së institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	FSHMT siguron përfshirjen dhe angazhimin e studentëve, përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. Studentët janë pjesë e Senatit Akademik të institucionit dhe janë të organizuar në Këshilla Studentor në nivel fakulteti dhe universiteti me rregulloret e tyre përkatëse të funksionimit dhe organizimit. Këshillat studentor janë aktiv dhe kryejnë aktivitete që lidhen me misionin dhe objektivat e krijimit të tyre. Këshillat studentor luajnë edhe rolin e tutoriatit studentor, ku studentët e viteve më të larta shërbejnë për studentët më të rinj si informues mbi mënyrën sesi funksionon jeta akademike në institucion dhe si transmetues i njohurive dhe përvojave personale në lidhje me programin e studimit. Evidenca: - Evidenca 1, Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë; - Evidenca 2, Rregullore e Universiteti të Mjekësisë, Tiranë; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 6, Rregullore Departamenti FSHMT; - Evidenca 126, Rregullore e zgjedhjeve të Këshillit Studentor në UMT; - Evidenca 124, Lista e aktiviteteve Këshilli Studentor UMT_FSHMT; - Evidenca 127, Statuti i Këshillit Studentor UMT; - Vizita në institucion, takimi me studentët.

Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Përfshirja e studentëve apo përfaqësuesve të tyre nga institucioni, në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, është reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. Përfaqësuesi i studentëve në Senatin Akademik i zgjedhur nga vetë ata në zgjedhjet e vitit 2020, krijimi i këshillave studentor në nivel fakulteti, senatorët në nivel grupi mësimor janë shembuj konkret të përfshirjes së studentëve në vendimmarrje nga ana e FSHMT. Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe diskutime aktive në organet kolegjiale ka rezultuar në marrjen e masave konkrete nga institucioni për adresim të problematikave të tyre, për shembull problemet e hasura gjatë periudhës së pandemisë, mbështetja për studentët e prekur nga tërmeti i Nëntorit 2019, asistencë shëndetësore në rast sëmundje etj. Studentët janë pjesë e vendimmarrjes, këshillimit dhe vlerësimit edhe në procesin akademik nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në komisione të veçanta si Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Këshilli i Etikës, anëtar të Grupit të Vlerësimit të Brendshëm në procesin e Akreditimit të programit MSc. në Fizioterapi. Evidenca: - Evidenca 1, Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë; - Evidenca 15, Aktivitete studente libri <i>abstrakteve konferenca e shkencave mjekësore</i>; - Evidenca 16, Info Session për Konkursin e Kërimit Shkencor dedikuar studentëve, FSHMT; - Evidenca 126, Rregullore e zgjedhjeve të Këshillit Studentor në UMT; - Evidenca 27, Pyetësi i studentëve në FSHMT 2023; - Evidenca 28, Rezultatet e pyetësorit të studentëve 2023; - Evidenca 61, Procedurë ankimi i studentit për vlerësimin; - Evidenca 62, Pyetësor mbi përdorimin e pajisjeve teknologjike nga studentët për mësimin online; - Evidenca 75, Vendim i përbashkët Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit për veprimtarinë e UMT; - Evidenca 171, Vendim Senati Akademik nr. 32 datë 17.03.2020 Peërbërja e Këshillit të Etikës.pdf; - Vizita në institucion, takimi me studentët.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe vizita në institucion me studentët dhe drejtuesin e njësisë bazë

studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.

përgjegjëse për programin e studimit MSc. në Fizioterapi, u konstatua se studentët janë pjesëmarrës aktiv në procese të rëndësishme të jetës institucionale dhe akademike, duke përfshirë procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimi. Kjo pjesëmarrje sigurohet nëpërmjet angazhimit të tyre në strukturat drejtuese të institucionit, komisionet ad-hoc dhe nëpërmjet angazhimit konkret të tyre në plotësimin e pyetësorëve në fund të çdo semestri, ku ata kanë mundësi të shprehin mendimet e tyre në lidhje me cilësinë e mësimdhënies, kurrikulën, logjistikën dhe infrastrukturën e programit të studimit. *Në tre vitet e fundit nuk ka pasur ndryshime të kurrikulës për programin e studimit MSc. në Fizioterapi. Gjatë takimit me studentët ata referuan se ishin të ndërgjegjshëm se sugjerimet e tyre merreshin parasysh. Shembulli i dhënë ishte mënyra e organizimit dhe shtimit të orëve praktike.*

Evidenca:

- Evidenca 2, Rregullore e Universiteti të Mjekësisë, Tiranë;
- Evidenca 5, Rregullore FSHMT;
- Evidenca 15, Aktivitete studente libri _abstrakteve konferenca e shkencave mjekësore;
- Evidenca 16, Info Session për Konkursin e Kërkimit Shkencor dedikuar studentëve FSHMT;
- Evidenca 27, Pyetësori i studentëve në FSHMT 2023;
- Evidenca 28, Rezultatet e pyetësorit të studentëve 2023;
- Evidenca 62, Pyetësor mbi përdorimin e pajisjeve teknologjike nga studentët për mësimin online;
- Evidenca 67, Shembull Pyetësor Vlerësim i studentëve për lëndët e programit të studimit formular;
- Evidenca 68, Shembull Pyetësor Vlerësim i studentëve për UMT formular;
- Evidenca 125, Përbërja e Këshillit Studentor UMT;
- Evidenca 126, Rregullore e zgjedhjeve të Këshillit Studentor në UMT;
- Evidenca 127, Statuti i Këshillit Studentor UMT;
- Evidenca 130, Politika dhe praktika për fitimin e bursave të studentëve dhe përjashtimi nga tarifa vjetore e studimit;
- Vizita në institucion, takimi me studentët.



Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentëve të programit MSc. në Fizioterapi u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e pedagogut përgjegjës. Procesi i ankimimit të studentëve për rezultatet mbështetet në aktet rregullatore të rregullores së fakultetit dhe të programit të studimeve. Në këto rregullore janë të përcaktuara qartë procedurat dhe afatet e ankimimit ndërkohë që studentët informohen që në momentin e parë të regjistrimit në programin e studimit MSc. në Fizioterapi. GVJ nga konsultimi i dokumentacionit evidentoi një mospërputhje në lidhje me afatet e publikimit të rezultateve të provimeve, midis Rregullores së Institucionit (neni 91, pika 10), afati i publikimit është 5 ditë (neni 30, pika 5a) dhe Rregullores së Njësisë Kryesore (neni 45, pika 10) afati i publikimit të rezultateve të provimeve është brenda 10 ditëve. <i>GVJ sugjeron korrigjimin e afateve të publikimit të rezultateve të provimeve respektivisht në Rregulloren e Institucionit dhe Rregulloren e Njësisë Kryesore për përputhje të tyre.</i> Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 31, Procedura e provimeve dhe kontrollit të dijeve; - Evidenca 60, Pyetësor mbi mundësinë e zhvillimit të provimeve online gjatë pandemisë COVID-19; - Evidenca 63, Praktika për monitorimin e sezonit të provimeve të verës; - Evidenca 64, Praktikë për monitorimin e sezonit të Vjeshtës FSHMT; - Evidenca 65, Procedurë për monitorimin dhe verifikimin e dokumentacionit të provimeve; - Evidenca 91, Plani mësimor Msc. Fizioterapi, 23-26; - Evidenca 92, Syllabuset e lëndëve; - Vizita në institucion, takimi me studentët, stafin akademik.
Konkluzione	<i>FSHMT përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese. Ata janë pjesë e Senatit Akademik të institucionit dhe janë të organizuar në Këshilla Studentor në</i>

	nivel fakulteti dhe universiteti me rregulloret e tyre përkatëse të funksionimit dhe organizimit. Studentët nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në komisione të veçanta si Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Këshilli i Etikës, anëtar të Grupit të Vlerësimit të Brendshëm në procesin e Akreditimit të programit MSc. në Fizioterapi dhe angazhimit konkret të tyre në plotësimin e pyetësorëve në fund të çdo semestri, kanë mundësi të shprehin mendimet e tyre në lidhje me cilësinë e mësimdhënies, kurrikulën, logjistikën dhe infrastrukturën e programit të studimit. Studentët kanë të drejtën për ankimim për rezultatet e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Ky proces mbështetet në aktet rregullatore të rregullores së fakultetit dhe të programit të studimeve bachelor në FSHMT. GVJ evidentoi mospërputhje në afatet e korrigjimit e publikimit të rezultateve të provimeve, respektivisht në Rregulloren e Institucionit dhe Rregulloren e Njësisë Kryesore dhe sugjeron korrigjim të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	FSHMT-UMT ka ngritur njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. Këto njësi përfshijnë Sekretarinë mësimore, Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, Zyrën e Karrierës dhe Alumni. Evidenca: - Evidenca 1, Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë; - Evidenca 2, Rregullore e Universiteti të Mjekësisë, Tiranë; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 3, Organigrama UMT.pdf; - Evidenca 21, Rregullore për Progamet në FSHMT; - Evidenca 178, Rregullore Për Administrimin Financiar Kontabilitetin dhe Kontrollin në UMT;

	- Evidenca 181, Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT.pdf; - Evidenca 108, Aktivitete të zyrës së karrierës FSHMT; - Evidenca 108, Rregullore e zyrës së karrierës FSHMT; - Vizita në Institucion.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Institucioni disponon një sistem të ngritur elektronik të menaxhimit të informacionit, të dedikuar për informimin, këshillimin, ndjekje e përparimit të studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit MSc. në Fizioterapi. Të gjithë studentët kanë akses në këtë sistem. Ndërkohë që zyra të caktuara si Sekretaria Mësimore, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Departamenti i Financë Kontabilitetit informojnë, mbështetin dhe ofrojnë shërbime për studentët gjatë gjithë ciklit të studimeve. Evidenca: - Evidenca 188, Rregullore e sekretarisë; - Evidenca 178, Rregullore Për Administrimin Financiar Kontabilitetin dhe Kontrollin në UMT; - Evidenca 181, Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT.pdf; - Evidenca 108, Aktivitete të zyrës së karrierës FSHMT; - Vizita në Institucion.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	FSHMT-UMT nëpërmjet zyrës së Karrierës dhe Alumni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës që kur ata janë kandidat për të ndjekur ciklin e studimeve MSc. në Fizioterapi dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së ciklit të studimeve. Kjo zyrë ofron informacion dhe këshillim të vazhduar si dhe organizon aktivitete periodike për këshillimin e karrierës dhe orientimin e studentëve në tregun e punës. Gjithashtu, zyra mban kontakte me Alumni, harton Guidën studentore, materiale udhëzuese për maturantët dhe harton raportin me të dhëna statistikore mbi numrin e studentëve aktual, të diplomuar në programin e studimit që ja përcjell edhe MAS. Evidenca: - Evidenca 107, Manuali i karrieres se studenteve FSHMT; - Evidenca 108, Aktivitete të zyrës së karrierës FSHMT; - Vizita në Institucion.

Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Karrierës dhe Alumni është njësia përgjegjëse që ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit MSc. në Fizioterapi. Nga takimi në institucion me përfaqësues të kësaj zyre u evidentua që kjo zyrë është shumë aktive dhe me ide e projekte të reja për të gjurmuar studentët pas diplomimit, për ti bërë ata pjesë aktive të aktiviteteve që institucioni organizon si dhe krijimin e një këndi promovues të dedikuar për Alumni. Të dhënat e mbledhura nga kjo zyrë përmbledhen në raporte periodike dhe u vihen në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. <i>GVJ sugjeron se institucioni duke qënë se i ka të gjithë mekanizmat, infrastrukturën, kapacitetet dhe bashkëpunime me partner të rëndësishëm, duhet të punojë për krijimin e një baze të dhënash të mirëfilltë për Alumni për të gjitha programet e studimit përfshirë dhe programin MSc. në Fizioterapi.</i> Evidenca: - Evidenca 108, Aktivitete të Zyrës së Karrierës FSHMT; - Vizita në Institucion, takimi me përfaqësues të Zyrës së Karrierës FSHMT.			
Konkluzione	FSHMT-UMT ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve përfshirë dhe studentët e programit MSc. në Fizioterapi në lidhje me programin e studimit dhe orientimin në tregun e punës. Menaxhimi i ankimeve e problematikave të studentëve është transparent dhe bazohet në akte rregullatore të institucionit. Njësitë përgjegjëse për orientimin dhe këshillimin e studentëve ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga të gjithë studentët. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
---	----------------	-----------------------	----------------------	-----------------------------------

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Në nivel institucional janë hartuar udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies si pjesë e Planit Strategjik të Zhvillimit 2021-2024, por edhe trajnimeve të ndryshme. NjsBC ka organizuar trajnime në lidhje me metodat e ndryshme inovative të mësimdhënies, si dhe mobilitetet e stafit në universitetet e huaja kanë kontribuar në rritjen e kapaciteteve për mësimdhënie cilësore në programet e studimit që institucioni ofron. Ndërkohë që drejtuesi i departamentit luan rol aktiv në garantimin e këtij procesi nëpërmjet organizimit të takimeve periodike që kanë në fokus nxitjen e përdorimit të metodave inovative në mësimdhënie. <i>Gjatë takimeve me stafin akademik një pjesë e tyre raportuan se do të donin të ishin më shumë të përfshirë në mobilitetete për mësimdhënien jashtë vendit si dhe u sugjerua përshtatja e programit të shkëmbimit të përvojave edhe me IAL publike dhe private brenda vendit.</i> Evidenca: - Evidenca 170, Plani Strategjik i Zhvillimit të UMT-së 2021-2024; - Evidenca 91, Plani mësimor Msc. Fizioterapi, 23-26; - Evidenca 92, Syllabuset e lëndëve; - Vizita në Institucion, takimi me stafin akademik dhe drejtuesit e departamenteve.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Institucioni ka ngritur strukturat përgjegjëse që zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit nëpërmjet pyetësorëve. Pjesë e këtyre strukturave janë NjsBC, Komisioni i përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, me përfaqësues nga të gjitha fakultetet dhe studentët. Vlerësimi nëpërmjet pyetësorëve kryhet dy herë në vit. Rezultatet e monitorimit u vihen në dispozicion Rektoratit, Njësive kryesore dhe Njësive bazë dhe instruktorëve të praktikës me qëllim

	evidentimin e nevojave dhe sugjerimeve të dhëna nga studentët për adresim të tyre. Evidenca: - Evidenca 181, Rregullore e Funksionimit NjSBC-UMT; - Evidenca 27, Pyetësi i studentëve në FSHMT 23; - Evidenca 28, Rezultatet e pyetësorit të studentëve 2023; - Evidenca 76, Plan veprimi 2021-2023 për Rritjen e Cilësisë së Arsimit të Lartë; - Evidenca 67, Shembull Pyetësor Vlerësim i studentëve për lëndët e programit të studimit formular; - Evidenca 68, Shembull Pyetësor Vlerësim i studentëve për UMT formular; - Evidenca 69, Përbërja e NjSBC-VSA nr.103, dt.20.10.2020; - Vizita dhe takime në institucion me përfaqësues të NjSBC, studentët, stafin akademik dhe drejtuesit e departamenteve.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Institucioni siguron përfshirjen aktive të studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve. Kjo garantohej nga zhvillimi i pyetësorëve të vazhdueshëm, anonim ku studentët vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies dhe kanë mundësi për dhënien e sugjerimeve për përmirësimin e këtij procesi. Gjithashtu, duke respektuar anonimin, me anë të peticioneve/ankimeve me natyrë akademike dhe administrative të zhvilluar online apo on site institucioni njihet me pakënaqësitë ose kërkesat e ndryshme të studentëve. Në Senat Akademik është ngritur dhe një komision i përhershëm i cili shqyrton dhe vendos për zgjidhje dhe orientimin e duhur të problematikave të ngritura. Evidenca: - Evidenca 181, Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT; - Evidenca 27, Pyetësi i studentëve në FSHMT 23; - Evidenca 28, Rezultatet e pyetësorit të studentëve 2023; - Evidenca 69, Përbërja e NjSBC-VSA nr.103, dt.20.10.2020;

	- <i>Vizita në Institucion dhe takimet me studentët dhe stafin akademik.</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Institucioni nëpërmjet NjSBC, strukturës përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie zhvillon procesin e vlerësimit të pyetësorëve dy herë në vit. Rezultatet u bëhen publike në formën e një raporti rektoratit, dekanit të fakultetit, departamentëve përkatëse që ofrojnë programet e studimit dhe instruktorëve përkatës me qëllim njohjen e tyre me situatën aktuale të mësimdhënies dhe evidentimin e sugjerimeve të bëra nga studentët për implementim. Rezultatet shërbejnë edhe për hartimin e performancës së stafit nga drejtuesi i departamentit kryesisht për vlerësimin e aspekteve që lidhen me sigurimin e cilësisë në mësimdhënie në programin e studimit. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit si dhe Njësia për Sigurimin e Cilësisë në faqen zyrtare web të UMT mundësojnë publikimin e raporteve përfundimtare të akreditimit të programeve të studimit. Evidenca: - <i>Evidenca 155, Shembull Vlerësimi i performancës së stafit administrativ;</i> - <i>Evidenca 156, Formular raporti për realizimin e veprimtarisë akademike;</i> - <i>Evidenca 79, Raport vjetor UMT 2020-2021;</i> - <i>Evidenca 79.1, Raport vjetor UMT 2021-2022;</i> - <i>Evidenca 80, Raport vjetor FSHMT 2020-2021;</i> - <i>Evidenca 81, Raport vjetor FSHMT 2021-2022;</i> - <i>Evidenca 82, Raport vjetor FSHMT 2022-2023;</i> - <i>Vizita në Institucion, takimet përfaqësues të NjSBC dhe drejtuesit e departamenteve.</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	FSHMT ka mekanizma të vlerësimit dhe rezultateve të marra që promovojnë shembuj të praktikave të mira nëpërmjet hartimit të dokumentave që vlerësojnë gjendjen aktuale të programit të studimit në lidhje me mësimdhënien por edhe mundësojnë dhënien e rekomandimeve nga rezultatet e marra. NjSBC harton raportin e rezultateve të pyetësorit të studentit, departamentet dhe fakulteti hartojnë analizën vjetore, ndërkohë që shembujt të praktikave të mira publikohen si përfaqësues dhe modele në faqen zyrtare të institucionit. Nxitja e praktikave të mira mundësohet edhe nga vlerësimi i performancës së stafit akademik

	si në aspektin e mësimdhënies dhe atë kërkimor - shkencor nëpërmjet tabelave përmbledhëse që janë pjesë e raporteve vjetore të njësive bazë dhe kryesore, të cilat janë publike. Staf i akademik promovohet në bazë të arritjeve akademike dhe kërkimore duke i mundësuar alokimin e fondeve për pjesëmarrje në konferenca dhe botim artikujsh, me impakt në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet integritit të kërkimit shkencor në mësimdhënie. <i>Stafi akademik, gjatë takimeve në institucion referoi se ishte mbështetur dhe rimbursuar financiarisht për pjesëmarrje në konferenca dhe për botimin e artikujve.</i> Evidenca: - Evidenca 79, Raport vjetor UMT 2020-2021; - Evidenca 79.1, Raport vjetor UMT 2021-2022; - Evidenca 80, Raport vjetor FSHMT 2020-2021; - Evidenca 81, Raport vjetor FSHMT 2021-2022; - Evidenca 82, Raport vjetor FSHMT 2022-2023; - Evidenca 83, Raport i aktivitetit i Departamentit 2020; - Evidenca 84, Raport i aktivitetit i Departamentit 2021; - Evidenca 85, Raport i aktivitetit i Departamentit 2022; - Evidenca 27, Pyetësi i studentëve në FSHMT 2023; - Evidenca 28, Rezultatet e pyetësorit të studentëve 2023; - Vizita në Institucion, takimi me stafin akademik.			
Konkluzione	FSHMT ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies për programin e studimit MSc. në Fizioterapi, nëpërmjet funksionimit të strukturave të caktuara. Institucioni harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit bazuar në evidenca të garantuara nga monitorimi, funksionimi dhe analiza e mekanizmave transparent të vlerësimit sic është shembulli i pyetësorëve të studentëve, që promovojnë shembuj të praktikave të mira, pjesëmarrjen aktive të studentëve në proces dhe nxitje të personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, Neni 103, Pika 1, GVJ konstaton se UMT, ku përfshihet dhe FSHMT ku ofrohet programi i studimit MSc. në Fizioterapi ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC). Përgjegjësitë për sigurimin cilësisë janë të sanksionuara në Statutin e institucionit dhe implementimi sigurohet nëpërmjet komisioneve në nivel institucional si Komisioni i administrimit të zgjedhjeve, Asambleja e personelit akademik, Komisionet e përhershme, Komisioni i apelimit dhe NjSBC në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Evidenca: - Evidenca 1, Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë; - Evidenca 2, Rregullore e Universiteti të Mjekësisë Tiranë; - Evidenca 3, Organigrama UMT.pdf; - Evidenca 100, Rregullore për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritetet, Organet Drejtuese, Komisionet.pdf; - Evidenca 171, Vendim Senati Akademik nr. 32 datë 17.03.2020 Përbërja e Këshillit të Etikës.pdf; - Evidenca 172, Rregullore e funksionimit të Këshillit të Etikës - UMT.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe gjatë vizitës në institucion, konstatoi se Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë drejtohet nga NjSBC e krijuar në 2017, e cila mbështetet nga strategji dhe rregulla institucionale që synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Plani Strategjik i zhvillimit të institucionit përcakton dhe parashikon përgjegjësinë institucionale për garantimin dhe përmirësimin e cilësisë ku studentët dhe ekspertët e jashtëm luajnë rol aktiv dhe të rëndësishëm. Përfaqësuesit e NjSBC në çdo njësi kryesore, përfshirë FSHMT janë personat përgjegjës për koordinimin dhe bashkërendimin e punës me NjSBC. Evidenca:

	- Evidenca 1, Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë; - Evidenca 2, Rregullore e Universitetit të Mjekësisë Tiranë; - Evidenca 181, Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT.pdf; - Evidenca 69, Përbërja e NjSBC-VSA nr.103, dt.20.10.2020; - Evidenca 100, Rregullore për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritetet, Organet Drejtuese, Komisionet.pdf; - Evidenca 170, Plani Strategjik i Zhvillimit të UMT-së 2021-2024. - Vizita në Institucion, takimi me përfaqësues të NjSBC.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Institucioni ka instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë që janë pjesë integrale e rregulloreve dhe strukturave përgjegjëse të institucionit. Deri në procesin aktual të akreditimit të programit të studimit MSc. Fizioterapi, i cili është i pari për këtë program, sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë është realizuar nga pyetësorët periodik të studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, Sondazhi Kombëtar i Studentëve 2022, vlerësimi i performancës akademike dhe kërkimore - shkencore të stafit akademik si dhe vetëvlerësimi dhe vlerësimi i jashtëm institucional. Evidenca: - Evidenca 79, Raport vjetor UMT 2020-2021; - Evidenca 79.1, Raport vjetor UMT 2021-2022; - Evidenca 80, Raport vjetor FSHMT 2020-2021; - Evidenca 81, Raport vjetor FSHMT 2021-2022; - Evidenca 82, Raport vjetor FSHMT 2022-2023; - Evidenca 83, Raport i aktivitetit i Departamentit 2020; - Evidenca 84, Raport i aktivitetit i Departamentit 2021; - Evidenca 85, Raport i aktivitetit i Departamentit 2022; - Evidenca 27: Pyetësi i studentëve në FSHMT 2023; - Evidenca 181, Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT.pdf; - Evidenca 67, Shembull Pyetësor Vlerësim i studentëve për lëndët e programit të studimit formular; - Evidenca 68, Shembull Pyetësor Vlerësim i studentëve për UMT formular; - Evidenca 169, Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Institucional UMT Maj 2022.

Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji dhe në Obstetrikë Gjinekologji, përgjegjës për programin e studimit MSc. në Fizioterapi përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim shkencor sic janë pyetësorët e studentëve, intervista, vlerësim i performancës akademike për përgatitjen në kohë të materialeve didaktike, përditësim të syllabuseve, literaturës bazë, respektim të orarit të mësimi, mënyrën e zhvillimit të leksioneve, orëve të laboratorit dhe orëve praktike. Stafi akademik vlerësohet edhe për arritjet shkencore duke përfshirë numrin e projekteve si drejtues apo anëtar, pjesëmarrjen aktive në konferenca dhe botim të artikujve shkencor. Tregues të qartë ka edhe për mbështetjen institucionale nga ana e stafit akademik. Çdo tregues i performancës diskutohet në departament si pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe mbi bazën e tyre orientoheshin edhe politikat për zhvillimin e programit të studimit. Stafi akademik i programit të studimit gjatë vizitës në institucion raportoi se kishte mbështetjen financiare të institucionit për veprimtarinë kërkimore shkencore. Evidenca: - Evidenca 14, Shembull formulari i performancës 2023; - Evidenca 155, Shembull Vlerësimi i performancës së stafit administrativ; - Vizita në institucion.			
Konkluzione	<i>FSHMT harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit MSc në Fizioterapi në kuadër të strukturave të NjSBC, koordinimit të brendshëm me departamentin dhe zbatim të politikave të qarta me tregues cilësor të matshëm për garantimin e brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimeve me përfaqësues të zyrave përgjegjëse të institucionit për hartimin, zbatimin dhe dokumentimin e proceseve formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të MSc. në Fizioterapi, konstatoi se programi i studimit ka një koordinator i cili është personi përgjegjës për bashkëpunimin, bashkërendimin dhe monitorimin e ecursisë së programit të studimit me departamentin. Gjithashtu, NjSBC monitoron dhe vlerëson periodikisht programin e studimit duke përdorur pyetësorët e studentëve. Edhe drejtuesit e departamenteve kryejnë monitorime periodike të procesit mësimor. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dhe monitorimeve dokumentohen dhe u bëhen të ditura Dekanit, Drejtuesit të departamentit, stafit akademik dhe ndihmës akademik dhe janë pjesë e raporteve vjetore të departamentit dhe të fakultetit. Në bazë të treguesve Drejtoria e Kurrikulave harton dhe organizon procesin e përditësimit të programeve të studimit sipas udhëzimeve të MAS rreth 20%. Ky proces ka si qëllim ruajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Evidenca: - Evidenca 79, Raport vjetor UMT 2020-2021; - Evidenca 79.1, Raport vjetor UMT 2021-2022; - Evidenca 80, Raport vjetor FSHMT 2020-2021; - Evidenca 81, Raport vjetor FSHMT 2021-2022; - Evidenca 82, Raport vjetor FSHMT 2022-2023; - Evidenca 83, Raport i aktivitetit i Departamentit 2020; - Evidenca 84, Raport i aktivitetit i Departamentit 2021; - Evidenca 85, Raport i aktivitetit i Departamentit 2022; - Evidenca 27, Pyetësori i studentëve në FSHMT 2023; - Evidenca 28, Rezultatet e pyetësorit të studentëve 2023; - Evidenca 169, Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Institucional UMT Maj 2022; - Evidenca 14, Shembull formulari i performancës 2023; - Evidenca 155, Shembull Vlerësimi i performancës së stafit administrativ; - Vizita në institucion, takimet me Dekanen, drejtuesit e departamenteve, përfaqësues të zyrave, stafin akademik dhe studentët.
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të	Raportet e vlerësimit që përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më




përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	të mira hartohen dhe koordinohen nga NjSBC. Rezultatet u vihen në dispozicion njësisë kryesore dhe bazë. Në bazë të treguesve adresohen mangësitë dhe evidentohen praktikatat më të mira të reflektuara në analizën vjetore të Dekanatit që është rezultat i analizës vjetore të hartuar nga çdo departament. Edhe Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji dhe në Obstetrikë Gjinekologji, përgjegjës për programin e studimit MSc. në Fizioterapi harton analizën vjetore në të cilën përfshin të gjithë treguesit si cilësor dhe sasior që kanë të bëjnë me anën akademike, kërkimore shkencore dhe administrative. Analiza vjetore institucionale diskutohet në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit të UMT. Gjatë mbledhjes diskutohet dhe evidentohen planet e masave për të adresuar problematikat e hasura për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. FSHMT ka protokollin e vet, i cili funksionon mbi bazën e kuadrit ligjor përkatës, të miratuar. Rregullorja e programet të studimit, ngarkesa mësimore e pedagogëve, marrëveshjet vjetore të stafit akademik, regjistra, dokumentacioni i provimeve, punime diplomash të studentëve, të dhëna të aktivitetit shkencor, raporte analize dhe çdo dokumentacion që gjykohej i rëndësishëm në dokumentimin dhe sigurimin e cilësisë së veprimtarisë akademike të FSHMT, protokollohet. Dosjet e stafit akademik ku janë të dokumentuara kualifikimet e tyre në vite, aktiviteti shkencor, vlerësimet periodike të performancës, të cilat ju vunë në dispozicion edhe GVJ gjatë vizitës institucionale, janë gjithashtu pjesë e arkivës së dokumentave të protokolluara. Evidenca: - Evidenca 1, Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë, neni 36; - Evidenca 76, Plan veprimi 2021-2023 për Rritjen e Cilësisë së Arsimit të Lartë; - Evidenca 77, Vendimi 69, dt.21.09.2017 për Akreditimin Instucional të UMT nga Bordi i Akreditimit Certifikata; - Evidenca 79, Raport vjetor UMT 2020-2021; - Evidenca 79.1, Raport vjetor UMT 2021-2022; - Evidenca 80, Raport vjetor FSHMT 2020-2021; - Evidenca 81, Raport vjetor FSHMT 2021-2022; - Evidenca 82, Raport vjetor FSHMT 2022-2023; - Evidenca 83, Raport i aktivitetit te Departamentit 2020;
---	---

	- Evidenca 84, Raport i aktivitetit i Departamentit 2021; - Evidenca 85, Raport i aktivitetit i Departamentit 2022; - Takimet gjatë vizitës institucionale.
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Institucioni në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit MSc. në Fizioterapi, përdor një larmishmëri metodash që drejtohen dhe koordinohen nga strukturat përgjegjëse në harmoni me njëra - tjetrën. NjSBC organizon pyetësorët për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit nga studentët, monitoron sondazhin kombëtar të studentëve të organizuar nga ASCAL, organizon seminare akademike etj. Politikat mbështetëse dhe adresimi i mangësive të evidentuara që lidhen me cilësinë e mësimdhënies, organizimin e praktikave mësimore apo problematika të tjera akademike dhe administrative që lidhen me programin e studimit drejtohen dhe koordinohen nga Zv.Dekanët për anën mësimore, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, drejtuesit e departamenteve, titullarët dhe lektorët e lëndëve me përditësimin e kurrikulave periodikisht deri në masën 20% të diktuar nga rezultatet e pyetësorit të studentëve dhe nevojat e tregut të punës, gjithmonë duke respektuar transparencën dhe kuadrin ligjor në fuqi. Evidenca: - Evidenca 27, Pyetësori i studenteve në FSHMT 2023; - Evidenca 67, Shembull Pyetësor Vlerësim i studentëve për lëndët e programit të studimit formular; - Evidenca 68, Shembull Pyetësor Vlerësim i studentëve për UMT formular; - Evidenca 69, Përbërja e NjSBC-VSA nr.103, dt.20.10.2020; - Evidenca 76, Plan veprimi 2021-2023 për Rritjen e Cilësisë së Arsimit të Lartë; - Evidenca 181, Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT.pdf; - Vizita në institucion, takimet me Dekanen, drejtuesit e departamenteve, përfaqësues të zyrave, stafin akademik dhe studentët.
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të	Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit MSc. në Fizioterapi përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi. Përveç pyetësorit të studentëve të organizuar nga NjSBC, studentët që diplomohen

studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	ose për arsye të ndryshme ndërpresin studimet plotësojnë një anketë dalëse në lidhje me programin e studimit. Zyra e Karrierës dhe Alumnit mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar të cilët janë të ftuar në aktivitete apo konferenca shkencore që FSHMT organizon. Nga takimet me zyrën e Alumnit u konstatua që ka një bazë të dhënash për studentët e diplomuar, por ka vështirësi në gjurmimin e tyre pas diplomimit edhe për shkak të mungesës së një bashkëpunimi harmonik me UISSH, i cili ka një bazë të konsoliduar të dhënash në lidhje me këtë drejtim. Tërheqja e programit nga studentët e diplomuar është një mënyrë e tërthortë për gjurmimin e punësimit të tyre pas diplomimit. Studentët kanë qënë pjesë e Sondazhit kombëtar të organizuar nga ASCAL 2022, që shërbeu si mekanizëm për matjen e kënaqësisë së studentëve në lidhje me arsimin e lartë, përfshirë dhe programin e studimit MSc. në Fizioterapi. Rezultatet e çdo vlerësimi u bëhen të njohura të gjitha strukturave, drejtuesve të të gjitha niveleve, stafit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe studentëve dhe shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program si dhe rritjen e bashkëpunimit midis palëve me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Zyra e Karrierës dhe Alumnit nga takimi me përfaqësuesit e saj gjatë vizitës institucionale raportoi se kishte një projekt ide për të krijuar këndin e Alumnit me studentë të diplomuar dhe të suksesshëm në profesionin e tyre. <i>GVJ sugjeron që institucioni të hartoj mekanizma të qartë që mundësojnë bashkëpunim efektiv me UISSH, i cili, sic u raportua gjatë takimeve në institucion, ka një bazë të konsoliduar të dhënash për profesionistët e shkencave mjekësore përfshirë dhe profesionistët e Fizioterapisë për të gjitha niveleve.</i> Evidenca: - Evidenca 120, Të dhëna për Alumni nga Urdhërat profesionale; - Evidenca 121, Urdhër i Përbashkët nr. 63, datë 10.06.2021 Për Administrimin e akteve Administrative Shkresave; - Evidenca 27, Pyetësori i studentëve në FSHMT 2023; - Evidenca 67, Shembull Pyetësor Vlerësim i studentëve për lëndët e programit të studimit formular;
--	--

	- Evidenca 68, Shembull Pyetësor Vlerësim i studentëve për UMT formular; - Evidenca 108, Aktivitete të zyrës së karrierës FSHMT; - Evidenca 108, Rregullore e zyrës së karrierës FSHMT; - Vizita në institucion, takimet me përfaqësues të NjSBC, Zyrës së Karrierës dhe Alumnit dhe studentët.			
Konkluzione	UMT-FSHMT ka në strukturën e vetë njësi të posaçme që sigurojnë monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të programit të studimit MSc. në Fizioterapi. Për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit, institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe mësimnxënies, stabilitetin e programit të studimit dhe të qenit konkurrues në tregun e punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë në FSHMT parashikohen dhe garantohen nëpërmjet zbatimit të Manualit të Sigurimit të Brendshëm dhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe gjithëpërfshirje të të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit MSc. në Fizioterapi. Çdo strukturë institucionale përgjegjëse është aktivisht e përfshirë në sigurimin e brendshëm të cilësisë si NjSBC, departamentet, fakulteti dhe rektorati. Këto struktura rregullojnë veprimtaritë e tyre si dhe planifikojnë organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për realizimin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë nëpërmjet rregulloreve përkatëse, statutin e UMT dhe legjislacionin në fuqi. Evidenca: - Evidenca 1, Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë;

	- Evidenca 2, Rregullore e Universitetit të Mjekësisë Tiranë; - Evidenca 6, Rregullore Departamenti FSHMT; - Evidenca 5, Rregullore FSHMT; - Evidenca 21, Rregullore për Programet në FSHMT; - Vizita në Institucion.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	FSHMT përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Këto përgjegjësi dhe detyra në FSHMT, janë të përcaktuara qartë dhe të detajuara në rregulloren e institucionit dhe gjejnë zbatim me përgjegjësi nga çdo njësi, strukturë individ, si staf apo student i angazhuar dhe me rol aktiv në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit MSc. në Fizioterapi. Disa nga detyrat konkrete të evidentuara ishin organizimi dhe zhvillimi i pyetësorit të studentëve, vlerësimi i performancës së stafit akademik të angazhuar në programin e studimit, sigurimi i bazës së të dhënave për mësimdhënien, analiza periodike të veprimtarisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, evidentimi dhe hartimi i planit të masave për adresimin e problematikave të evidentuara në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe ecurinë e programit të studimit MSc. në Fizioterapi. Evidenca: - Evidenca 2, Rregullore e Universitetit të Mjekësisë Tiranë; - Evidenca 79, Raport vjetor UMT 2020-2021; - Evidenca 79.1, Raport vjetor UMT 2021-2022; - Evidenca 169, Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Institucional UMT, Maj 2022; - Vizita në Institucion.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e	Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit MSc. në Fizioterapi garantohet përfshirja e të gjithë aktorëve aktiv të programit të studimit. Procesi është transparent dhe për çdo procedurë para se të zhvillohet informohet paraprakisht. Rezultatet e vlerësimit u bëhen të ditura të gjithë drejtuesve të departamenteve të cilat janë edhe iniciatorët dhe përgjegjësit për sigurimin e cilësisë së programit të studimit duke zhvilluar mbledhje dhe takime me stafin akademik, ndihmësakademik, administrativ, koordinatorin e programit dhe studentët. Pjesë e

administrative dhe studentëve të programit të studimit.	rezultateve janë të përfshira edhe në raportet vjetore të departamentit, fakultetit dhe institucionit. Studentët raportuan se janë pjesë aktive e sigurimit të cilësisë nëpërmjet përfshirjes së tyre në pyetësor, akreditimin institucional dhe të programeve. Evidenca: - Evidenca 79, Raport vjetor UMT 2020-2021; - Evidenca 79.1, Raport vjetor UMT 2021-2022; - Evidenca 80, Raport vjetor FSHMT 2020-2021; - Evidenca 81, Raport vjetor FSHMT 2021-2022; - Evidenca 82, Raport vjetor FSHMT 2022-2023; - Evidenca 83, Raport i aktivitetit i Departamentit 2020; - Evidenca 84, Raport i aktivitetit i Departamentit 2021; - Evidenca 85, Raport i aktivitetit i Departamentit 2022; - Vizita në Institucion, takimi me studentët.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Proceset ciklike të vlerësimit të cilësisë si dhe përfshirja e aktorëve të brendshëm në proces kryhet në zbatim të Kodit të Etikës të miratuar në UMT në përputhje me Ligjin 80-2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe rregulloret e funksionimit të miratuara për çdo strukturë të përfshirë në proces. Përfshirja është transparente, anonime dhe respekton integritetin dhe lirinë akademike të stafit dhe statusin e studentit. Evidenca: - Evidenca 1, Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë; - Evidenca 71, Përbërja e Këshillit të Etikës; - Evidenca 72, Kodi i Etikës UMT; - Evidenca 99, Procedurë për zhvillimin e mbledhjeve të Këshillit të Etikës; - Evidenca 100, Rregullore për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritetet, Organet Drejtuese, Komisionet.pdf; - Evidenca 171, Vendim Senati Akademik nr. 32 datë 17.03.2020 Përbërja e Këshillit të Etikës.pdf; - Evidenca 172, Rregullore e funksionimit të Këshillit të Etikës - UMT; - Evidenca 181, Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT.pdf; - Evidenca 126, Rregullore e zgjedhjeve të Këshillit Studentor në UMT;

	- Evidenca 179, Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e KPPA në UMT; - Vizita në Institucion dhe takimet.
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Pas takimeve të ndryshme në institucion dhe takimit me përfaqësues të zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, GVJ konstatoi se pjesë e rëndësishme e procesit të vlerësimit të brendshëm, përveç studentëve që ndjekin aktualisht programin e studimit janë edhe vlerësimet e të ish të diplomuarve, ku një pjesë e tyre ishin të angazhuar edhe si staf akademik i jashtëm në programin e studimit me profil Fizioterapi. Zyra e Alumni zhvillonte aktivitete me ish studentë duke i bërë pjesë aktive të vlerësimit, gjurmonte zhvillimin e tyre profesional dhe siguronte pjesëmarrjen aktive në aktivitetet shkencore të organizuara nga institucioni. Takimet me ekspertë të jashtëm në kuadër të vlerësimit institucional, takimeve me përfaqësues të ministrisë së linjës si dhe tryezat e rrumbullakta me profesionistë kanë shërbyer për dhënien e vazhdueshme të sugjerimeve, sigurimin e qëndrueshmërisë së programit dhe të qenit konkures në tregun e punës. Evidenca: - Evidenca 108, Aktivitete të zyrës së karrierës FSHMT (statistika); - Evidenca 138, Raporti MAS për verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet certifikimi i kuotave; - Evidenca 169, Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Institucional UMT, Maj 2022; - Evidenca 50, Praktika e ndjekur për auditim nga njësi audituese e jashtme (UNICEF); - Evidenca 51, Praktika e ndjekur për auditim nga Njësia e Auditit të Brendshëm; - Takimi me përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumni gjatë vizitës institucionale.
Konkluzione	FSHMT-UMT nëpërmjet zbatimit të Manualit të Sigurimit të Brendshëm dhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe strukturën përkatëse, NjSBC siguron gjithëpërfishirje të të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë të programit të studimit MSc. në Fizioterapi. Njësitë akademike, personeli akademik e studentët nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve janë pjesë aktive në proceset e SBC-së të programit të studimit MSc. në Fizioterapi.

	<i>Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, nëpërmjet aktiviteteve që organizon, përvec studentëve që ndjekin aktualisht programin e studimit në proceset e vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë përfshin edhe studentët e diplomuar, ku një pjesë e tyre janë të angazhuar edhe si staf akademik i jashtëm në programin e studimit. NjSBC informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre nëpërmjet vënies në dispozicion të këtyre rezultateve dhe takimeve të vazhdueshme me ekspertë të jashtëm. Rezultatet dhe masat e marra në funksion të tyre janë pjesë e analizave vjetore të çdo niveli.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit MSc. në Fizioterapi janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe plotësisht transparente dhe publike për të gjithë të interesuarit. Rezultatet e pyetësorit të studentit pasi analizohen nga NjSBC u vihen në dispozicion drejtuesve të të gjitha niveleve dhe zyrave përkatëse, të cilët organizojnë takime me stafin në varësi për ti diskutuar këto rezultate, evidentuar problematikat dhe adresimin e tyre. Rezultatet e vlerësimit adresohen në mënyra të ndryshme si pjesë e analizës vjetore të njëjësive bazë, kryesore dhe institucionale, si pjesë e vlerësimit të performancës vjetore të stafit dhe orientuese dhe përcaktuese për ndryshime në kurrikulën mësimore. Çdo veprimtari është e pasqyruar publikisht në faqen zyrtare të institucionit www.umed.edu.al Evidenca: - Evidenca 175, Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në UMT; - Evidenca 176, Rregullore për Hetimin Administrativ të Sinjalizimit dhe Mbrojtjen e Konfidencialitetit në UMT;

	- Evidenca 181, Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT.pdf; - Konsultimi i faqes Web UMT; - Vizita në institucion dhe takimet.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Institucioni i publikon rezultatet e vlerësimit të programit në respekt të lirisë dhe etikës akademike dhe legjislacionit përkatës në fuqi. Rezultatet janë publike dhe të aksesueshme në faqen Web të FSHMT, www.fshmt.edu.al. Respektimi i Kodit Etik të miratuar nga UMT dhe legjislacioni për ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale në fuqi janë udhërrëfytes të hapave të ndryshme të procesit si komunimi i raporteve të monitorimit strukturave dhe autoriteteve përkatëse, komunikimi i rezultateve studentëve, komunikimi i raporteve të vlerësimit të stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Analiza vjetore e institucionit, ku bëjnë pjesë dhe analizat vjetore të departamenteve përgjegjëse për programet e studimit bëhen publike dhe janë të aksesueshme për të gjithë të interesuarit. Evidenca: - Evidenca 79, Raport vjetor UMT 2020-2021; - Evidenca 79.1, Raport vjetor UMT 2021-2022; - Evidenca 80, Raport vjetor FSHMT 2020-2021; - Evidenca 81, Raport vjetor FSHMT 2021-2022; - Evidenca 82, Raport vjetor FSHMT 2022-2023; - Evidenca 169, Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Institucional UMT, Maj 2022; - Konsultimi i faqes Web FSHMT; - Vizita në Institucion dhe takimet.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Rezultatet e çdo vlerësimi që synon përmirësimin e cilësisë së programit të studimit MSc. në Fizioterapi dhe jo vetëm shoqërohen me një plan masash që ka si qëllim të adresoj zgjidhjen e mangësive dhe dobësive të evidentuara. Planet e masave hartohen në nivele të ndryshme duke filluar nga departamenti, fakulteti, zyrat përkatëse përgjegjëse për cilësinë dhe ecurinë e programit të studimit dhe reflektohen në analizën vjetore institucionale si dhe në përmbushjen e rekomandimeve të dhëna në kuadër të proceseve periodike të akreditimit institucional. Evidenca: - Evidenca 80, Raport vjetor FSHMT 2020-2021;

	- Evidenca 81, Raport vjetor FSHMT 2021-2022; - Evidenca 82, Raporti vjetor FSHMT 2022-2023; - Vizita në Institucion dhe takimet.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni vlerëson dhe garanton efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive për monitorimin e cilësisë me qëllim ruajtjen dhe përmirësimin e programit të studimit MSc. në Fizioterapi, shërbimeve dhe performancës së personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrative të angazhuar në programin e studimit. Njësia përgjegjëse e NjSBC, është ajo që siguron efektivitetin e këtij procesi nëpërmjet vlerësimeve periodike, takimeve me stafin e angazhuar në programin e studimit, studentët ku mbledh të dhëna që shërbejnë për hartimin e raporteve vjetore të vlerësimit të brendshëm të cilësisë të cilat pasi u vihen në dispozicion të gjitha njësive përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dërgohen edhe në MAS. Evidenca: - Evidenca 108, Aktivitete të zyrës së karrierës FSHMT (statistika); - Evidenca 124, Lista e aktiviteteve Këshilli Studentor UMT, FSHMT; - Evidenca 154, Analizë për aktivitetin kërkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik të UMT.pdf; - Vizita në Institucion dhe takimet me përfaqësues të NjSBC.
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit MSc. në Fizioterapi. Këto veprimtari periodike kryhen në nivel strukturash, njësie bazë dhe kryesore ku realizohet informimi dhe raportimi i gjetjeve tek drejtuesit ose organet përkatëse. Shembujt përfshijnë takimet e organizuara nga departamenti me staf akademik dhe studentë, takime dhe trajnime të organizuara nga NjSBC, Zyra e Karrierës dhe Alumni etj. Sistemi i menaxhimit të informacionit është një nga mbështetësit kryesor të këtyre veprimtarive pasi mundëson raportimin në kohë reale të çdo veprimtarie të kryer në këtë kuadër.

	Evidenca: - Evidenca 108, Aktivitete të zyrës së karrierës FSHMT (statistika); - Evidenca 124, Lista e aktiviteteve Këshilli Studentor UMT, FSHMT; - Evidenca 154, Analizë për aktivitetin kërkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik të UMT.pdf; - Vizita në Institucion dhe takimet.			
Konkluzione	<i>Institucioni ka hedhur baza të forta të cilat i konsolidon vazhdimisht për hartimin dhe zbatimin e politikave, proceseve dhe veprimtarive transparente, efektive dhe publike për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit MSc. në Fizioterapi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Shkencor në “Fizioterapi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Mjekësisë Tiranë”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Numër i lartë i studentëve në këtë program studimi;
2. Rritja e numrit të stafit ndihmës akademik në vitet e fundit;
3. Organizimi rregullisht i konferencave, workshop-eve etj;
4. Zhvillimi rregullisht i orientimit të studentëve nga stafi akademik mbi çështjet më të rëndësishme si dhe ku të fokusohen për provimin respektiv;
5. Mbikqyrja e praktikave nga personel i ambjenteve klinike;
6. Mundësia për të aksesuar online dhe pa pagesë në baza të dhënash mjekësore të indeksuara;
7. Mungesa e ndryshimeve në kurrikulën e programit Master i Shkencave në Fizioterapi në 3 vitet e fundit është tregues i qëndrueshmërisë së këtij programi studimi;
8. Marrja parasysh e sugjerimeve të studentëve në lidhje me organizimin e programit. Shembull i kësaj praktike të mirë ishte mënyra e organizimit dhe shtimit të orëve praktike në program;
9. Mungesa e transferimeve të studimeve nga studentë që ndjekin MSc. në Fizioterapi në institucione të tjera është reflektim i qëndrueshmërisë të cilësisë së mësimdhënies dhe programit të studimit;
10. Mbështetja dhe rimbursimi financiarisht i stafit akademik për pjesëmarrje në konferenca dhe botimin e artikujve.

Pika të dobëta

1. GJV konsideron të rëndësishëm që të rritet numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit me qendra rehabilitimi duke patur në fokus studentët e Fizioterapisë (**Standardi I.3, Kriteri 2; I.3 Kriteri 3**);
2. Mungesa e hartimit rregullisht të raporteve analitike mbi rezultatet e marrëveshjeve të bashkëpunimit (**Standardi I.3 Kriteri 4**);
3. Mungesa e mobiliteteve të studentëve në IAL jashtë Shqipërisë (**Standardi II.4 Kriteri 3; Standardi II.4 Kriteri 4**);
4. Mungesa e një baze të dhënash të mirëfilltë e Alumni dhe mungesa e përfshirjes së tyre në përmirësimin/përditësimin e programit të studimit (**Standardi II.5 Kriteri 2, V.4, Kriteri 1, Standardi V.6, kriteri 4**);
5. Mungesa e një plani specifik në bazë të rezultateve të pyetësorit të studentëve (**Standardi III.1 Kriteri 5**);
6. Ngarkesa e orëve mësimore nuk mbulohet nga stafi akademik PAE në masën e kërkuar nga kadri ligjor në fuqi (**Standardi IV.1, Kriteri 2**).



Rekomandime

1. Rritje e numërit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me qendra rehabilitimi;
2. Hartimi i raporteve analitike mbi rezultatet e marrëveshjeve të bashkëpunimit;
3. Rritja e numrit të mobiliteteve të studentëve;
4. GJV propozon përfshirjen e detyrave të koordinatorit të programit të studimit në Rregulloren e Njesisë Bazë;
5. Përditësim të literaturës bazë me burime informacioni të 5 viteve të fundit;
6. Përfshirja e një lënde/moduli në Bioinformatikë (Informatikë Shëndetësore);
7. Rritja e orëve laboratorike.
8. Korrigjim i mospërputhjes në lidhje me afatet e publikimit të rezultateve të provimeve, midis Rregullores së Institucionit (neni 91, pika 10), afati i publikimit është 5 ditë (neni 30, pika 5a) dhe Rregullores së Njesisë Kryesore (neni 45, pika 10) afati i publikimit të rezultateve të provimeve është brenda 10 ditëve.
9. Krijimi i një baze të mirëfilltë të dhënash për Alumni.
10. Hartimi i mekanizmave të qartë që mundësojnë bashkëpunim efektiv me UISH dhe bashkëpunëtorë të tjerë të jashtëm që disponojnë bazë të konsoliduar të dhënash për profesionistët e shkencave mjekësore përfshirë dhe profesionistët e Fizioterapisë për të gjitha niveleve.
11. Institucioni të marri masa në adresimin e Standardit IV.1, Kriteri 2 sipas kuadrit ligjor në fuqi;
12. GJV sugjeron që Institucioni të dokumentoi rregullisht takimet që zhvillon me Urdhërin e Infermierit;
13. GJV sugjeron që Institucioni të dokumentoi rregullisht ndryshimet që ndërmerr në programin mësimor.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences / Master of in "Physiotherapy" provided by the Higher Education Institution "University of Medicine Tirana"

Strengths and affirmations

1. High number of students in this study program;
2. Increase of the number of academic support staff in recent years;
3. Regular organization of conferences, workshops, etc.;
4. Regular organization of student counselling and orientation by the academic staff on the most important issues and where to focus for the respective exam;
5. Supervision of practices by staff of clinical facilities;
6. The possibility to access online and free of charge indexed medical databases;
7. The lack of changes in the curriculum of the Master of Science in Physiotherapy program in the last 3 years is an indicator of the stability of this study program;




8. Taking into account the suggestions of students regarding the organization of the program. An example of this good practice was the way of organizing and adding practical hours to the program;
9. Lack of transfer of studies from students pursuing MSc. in Physiotherapy in other institutions is a reflection of the sustainability of the quality of teaching and the study program;
10. Financial support and reimbursement of academic staff for participation in conferences and publication of articles.

Weaknesses

1. Low number of cooperation agreements with rehabilitation centers focusing on Physiotherapy students (I2 Criterion 2; I2 Criterion 3);
2. Lack of regularly drawing up analytical reports on the results of memorandum of understandings agreements (I2 Criterion 4);
3. Lack of mobility of students in HEIs outside Albania (II4 Criterion 3; II4 Criterion 4);
4. Lack of a proper database of Alumni and the lack of their involvement in improving/updating the study program (II.5 Criterion 2, V.6, Criterion 4);in improving/updating the study program (II5 Criterion 2);
5. Lack of specific implementation plan based on the results of students' questionnaire (III.1 Criterion 5);
6. The PAE academic staff does not cover the required number of teaching hours under the current legislative framework (Standard IV.1, Criterion 2).

Recommendation

1. Increasing the number of cooperation agreements with rehabilitation centers;
2. Drawing up analytical reports on the results of cooperation agreements;
3. Increasing the number of students mobility;
4. EET proposes the inclusion of the duties of the coordinator of the study program in the Regulation of the Department;
5. Update of the basic literature with information sources of the last 5 years;
6. Inclusion of Health Informatics as subject/module;
7. Increase of the labs hours for this study program;
8. Correction of the inconsistency regarding the deadlines for the publication of exam results: between the Regulation of the Institution (article 91, point 10), the publication deadline is 5 days (article 30, point 5a), and the Regulation of the Main Unit (article 45, point 10), the deadline for publishing exam results is within 10 days;
9. Creating a proper database for Alumni;




10. Designing clear mechanisms that enable effective collaboration with UISH and other external partners that have a consolidated data base for medical science professionals, including physiotherapy professionals for all levels;
11. The institution should take measures to address Standard IV.1, Criterion 2, according to the legal framework in force;
12. EET suggests that the Institution regularly document the meetings that conducts with the Nurse's Association;
13. EET suggests that the Institution regularly document the changes it undertakes in the curriculum.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X